



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Raport Auditimi Performance

“Procesi i birësimit të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim”



Tiranë 2024

PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE	4
2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
2.1 Konteksti i Problemit Social	4
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës	5
3. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....	6
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim	6
3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim.....	7
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	8
3.4 Pesha në buxhet.....	10
3.5 Feedback-u i subjekteve në fazën e terrenit	11
4. DETAJET E AUDITIMIT.....	12
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve	12
4.2 Objektivat e auditimit.....	13
4.3 Pyetjet e auditimit.....	13
4.4 Fushëveprimi i auditimit	13
5. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT	14
5.1 A është i plotë dhe i përditësuar kuadri ligjor dhe rregullator që mbulon procesin e birësimit?.....	14
5.2 Si ka funksionuar procesi i birësimit vendas dhe ndërvendas në vendin tonë?	21
5.2.1 Mbi rastin e të miturës LH(EG), birësuar nga LH dhe rikthyer përsëri në institucionin rezidencial Shtëpia e Foshnjës 0 – 5, Shkodër.....	35
6. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE.....	511
7. GRUPI I PUNËS	65
8. ANEKSET	65

Lista e Shkurtimeve

KLSH	Kontroli i Larte i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
NJQV	Njësi të Qeverisjes Vendore
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
3E	Ekonomiciteti, Efienca, Efektiviteti
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
KSH	Këshilli Drejtues i KSHB - së
ST	Sekretariati Teknik i KSHB - së
MD	Ministria e Drejtësisë
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
IPSH	Institucion Përkujdesit Shoqëror për Fëmijë
AP	Avokati i Popullit
KKBDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve
KA	Kriter auditimi

1.PËRMBLEDHJE

KLSH vendosi të auditojë procesin e birësimit të fëmijëve në vendin tonë nisur nga fakti se, në përputhje edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, garantimi i të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, dhe i të drejtave të fëmijëve të braktisur në veçanti, është një prioritet thelbësor për zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme dhe solide.

Në vendin tonë procedura e birësimit shoqërohet me një praktikë administrative dhe gjyqësore përmes së cilës fëmijës, i cili është shpallur i braktisur dhe është privuar nga mjedisi familjar, i sigurohet një jetë e re.

Autoriteti i vetëm qendror në Shqipëri, në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit, vendas dhe ndërvendas është Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB), i cili është krijuar në vitin 1993. Prej krijimit të tij, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka realizuar 1857 birësime vendase dhe ndërvendase.

Birësimi i prodhon efektet e tij nga data që vendimi i gjykatës merr formë të prerë dhe është **i parevokueshëm**, duke e kaluar kujdestarinë ligjore të fëmijës tek prindërit birësues.

Nëpërmjet këtij auditimi u analizua në mënyrë objektive dhe të paanshme veprimtaria e Ministrisë së Drejtësisë, Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe Shërbimit Social Shtetëror sipas roleve dhe përgjegjësi të gjithsecilit përgjatë këtij procesi, për të vlerësuar nëse baza ligjore aktualisht në fuqi, politikat e parashikuara dhe praktikrat e ndjekura në vendin tonë, funksionojnë të gjitha në unison për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përgjatë procesit delikat të birësimit dhe sistemimin e tyre në familjen birësuese.

Në përfundim të auditimit u evidentua se baza ligjore që rregullon birësimet në vendin tonë nuk është e plotë dhe nuk reflekton në shkallën më të lartë praktikrat më të mira ndërkombëtare sidomos në drejtim të vendosjes së një kufiri maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve; përcaktimit të kriterit të qëndrueshmërisë dhe sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar; si dhe përcaktimit të kriterëve ekonomike sa më të sakta për aplikantët birësues.

Gjithashtu, u evidentuan mangësi dhe problematika në lidhje me procesin e birësimit në vetvete, sidomos në drejtim të: ngritjes së strukturave të Komitetit sipas përcaktimeve të ligjit; raportimit, monitorimit të veprimtarisë së IPSH – ve dhe vet KSHB – së; procesit të njohjes, miratimit, licencimit dhe mbikëqyrjes të agjencive ndërmjetësuese të huaja; si edhe mbikëqyrjes nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së këtij procesi.

Për këto arsye, Komiteti Shqiptar i Birësimeve së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, duhet të inkurajojnë një qasje të qëndrueshme në mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Këto institucione duhet të plotësojnë legjislacionin në përputhje me praktikrat më të mira ndërkombëtare. Ato duhet të nxisin: bashkëpunimin në fushën e birësimit ndërvendas; vlerësimin dhe sigurimin e kushteve të duhura për mirëritjen e fëmijës; monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit të birësimit si dhe identifikimin e çdo sfide ndaj sigurimit të mirëqenies dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve të braktisur.

2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

2.1 Konteksti i Problemit Social

Vlera e birësimit qëndron në fuqinë e dashurisë dhe qëndrueshmërinë e shpirtit njerëzor. Simbolizon shpresën, shanset e dyta dhe mundësinë për të kapërcyer vështirësitë. Birësimi u ofron fëmijëve dhuratën e një familjeje të dashur dhe u ofron prindërve birësues mundësinë që të kenë një ndikim pozitiv në jetën e një fëmije.

Në shumë shoqëri, birësimi ishte shpesh joformal, i bazuar në norma dhe tradita kulturore. Megjithatë, praktikrat moderne të birësimit kanë futur korniza ligjore dhe rregullore të rrepta


për të mbrojtur të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve të përfshirë. Një nga aspektet më kritike të birësimit është ndikimi i thellë që ka në jetën e fëmijëve të birësuar. Për shumë fëmijë që rriten në kujdesin e institucioneve, birësimi ofron një shans të dytë, shansin e një familje. Praktikrat, motivet dhe ligjshmëritë rreth birësimit kanë evoluar ndjeshëm gjatë viteve.

Në vendin tonë në përputhje me legjislacionin në fuqi procesi i birësimit ka për mision garantimin, mirëqenien dhe të drejtat e të gjitha palëve për të siguruar mirëqenien e fëmijëve të birësuar. Prosesi delikat i birësimit duhet të ketë në fokus të parë sigurinë dhe mirëqenien e fëmijës që do të kalojë në këtë proces dhe të garantojë që familja birësuese të jetë e sigurt dhe e përshtatshme për rolin e prindërimit.

Aspektet ligjore të birësimit përfshijnë përfundimin e të drejtave të prindërve të lindjes dhe vendosjen e të drejtave të reja ligjore prindërore për prindërit birësues. Prosesi i birësimit ndiqet nëpërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve i cili u krijua në vitin 1993 me hyrjen në fuqi të ligjit nr.7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në kodin e familjes”. Më pas është miratuar ligji nr. 9695, në datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar.

Sipas të dhënave vitet e fundit ka patur një rritje të kërkesave nga familjet adoptuese të interesuara për birësim, brenda dhe jashtë vendit, ku gjatë katër viteve e fundit 2018 - 2022 në total janë realizuar 68 birësime nga të cilat 24 birësime ndërvendase nëpërmjet agjencive agjencitë birësuese të dhe 44 birësime vendase.

Grafikisht birësimet e realizuara nga institucionet ndërvendase dhe vendase për vitet 2019-2022 paraqiten si me poshtë:



Për sa më lart, duke marrë në konsideratë faktin se procesi i birësimit duhet të garantojë interesin më të lartë të fëmijëve të deklaruar të braktisur për të siguruar familje të përshtatshme dhe të denja në mënyrë që të krijohen kushte për mirërritjen dhe edukimin e tyre, ky projekt auditues merr një rëndësi të veçantë.

2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI

dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficiensa dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023 - 2022, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, si dhe në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, KLSH ka ndërmarrë këtë auditim performance duke e konsideruar procesin e birësimit si të një rëndësie të veçantë për një shoqëri e cila vlerëson maksimalisht të drejtat e fëmijëve dhe mbron interesat e tyre, në veçanti në drejtim të garantimit të së drejtës së tyre për të jetuar një jetë të pasur e të plotë pranë gjirit të familjes. KLSH, nëpërmjet këtij auditimi, synon të paraqesë një pamje të qartë të mënyrës se si funksion procesi i birësimit të fëmijëve në vendin tonë dhe çfarë mekanizmash janë krijuar për të garantuar të drejtën e tyre për mirërritje dhe edukim.

3. SUBJEKTET NËN AUDITIM

3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

➤ Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjisllacionit shqiptar në tërësi.

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Ministria e Drejtësisë ka për qëllim të kërkojë respektimin e Kushtetutës, të ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe të kontribuojë në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik dhe të integritetit evropian të Republikës së Shqipërisë.

➤ Komiteti Shqiptar i Birësimeve

Komiteti Shqiptar i Birësimeve (KSHB) u krijua në vitin 1993 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në kodin e familjes”. Më pas është miratuar Ligji nr.9695, në datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është Autoriteti Qendror i vetëm në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit vendas dhe ndërvendas.

KSHB në veprimtarinë e tij ka synuar të garantojë interesin më të lartë të fëmijëve të deklaruar të braktisur për të siguruar familje të përshtatshme dhe të denja në mënyrë që të krijohen kushte për mirërritjen dhe edukimin e tyre.

KSHB funksionon si organ kolegjal në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe vepron në përputhje me dispozitat ligjore që janë përcaktuar saktësisht në një sërë konventash, ligjesh dhe derivatesh të tjera që rrjedhin në mbështetje të këtyre të fundit.

➤ Shërbimi Social Shtetëror

Shërbimi Social Shtetëror është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjëse për zbatimin e politikave të kujdesit ndaj fëmijëve.

Nga statistikat e qendrave rezidenciale rezulton se pjesa më e madhe e fëmijëve të braktisur vijnë nga familje me probleme social – ekonomike. Shërbimi Social Shtetëror ka prioritet të punës së vetë nxitjen e shërbimeve alternative të kujdesit ndaj fëmijëve të braktisur, nëpërmjet birësimit, kujdestarisë, dhe shërbimeve në komunitet.

➤ Institucionet Rezidenciale për Fëmijë

Edhe pse është zgjeruar dhe rritur roli plotësues i OJF-ve në ofrimin e shërbimeve sociale, shteti mbetet faktori kryesor për shërbimet për familjet dhe fëmijët në nevojë. Sistemi aktual i mbrojtjes sociale ofron mbështetje financiare për familjet me probleme ekonomike (Programi i Ndihmës Ekonomike), trajtim rezidencial për fëmijët e braktisur dhe me probleme sociale dhe lehtësira për fëmijët me statusin e jetimit.

Aktualisht rrjeti i Institucioneve Rezidenciale Publike të Përkujdesit për Fëmijët përbëhet nga 9 institucione publike dhe 18 qendra rezidenciale jopublike.


Institucionet rezidenciale publike të përkujdesit për fëmijë janë:

Shtëpi fëmije nga 0 - 3 vjeç Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë, Vlorë

Shtëpi fëmije nga 3 - 6 vjeç Shkodër

Shtëpi fëmije nga 6 - 15 vjeç Tiranë, Shkodër, Sarandë.

Grafikisht ndërvarësia e institucioneve në procesin e birësimit paraqitet si me poshtë:



3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore kryesore që rregullon aktivitetin e subjektit lidhur me çështjen nën auditim që do të jetë burimi i kriterëve të auditimit.

Kriteret politike

- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”;

Kriteret teknike

- Ligji nr. 8624 datë 15/06/2000 mbi Aderimin e Shqipërisë në Konventën e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimin për birësimet jashtë vendit”;
- Ligji nr. 9062 datë 08/05/2003, “Kodi i Familjes”;
- Ligji nr. 9695 date 19/03/2007 “ Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10358, datë 16.12.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimeve”;
- Ligji nr. 9443, datë 16.11.2005 “Për aderimin e RSH në Konventën për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”;
- Ligji nr. 9359, datë 24.05.2005 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për marrëdhëniet me fëmijët”;
- Ligji nr. 9446 datë 24.11.2005 “Për aderimin e RSH në Konventën për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”;
- Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligji nr. 9544, datë 29.05.2006 ‘Për ratifikimin e marrëveshjes mes Këshillit të Ministrave të RSH Qeverisë së Republikës Greke për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimë të trafikimit”;
- Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;
- VKM nr. 399, datë 01.06.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”.
- Rregullore e Brendshme e Ministrisë së Drejtësisë;
- Rregullore e Brendshme e Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

Kriteret e monitorimit dhe raportimit

- Urdhrat për monitorimin e Komitetit Shqiptar të Birësimeve.
- Raporte vjetore monitorimi;
- Raporte të Avokatit të Popullit apo nga organizata ndërkombëtare;

Kriteret e tjera/Praktikat më të mira

- Raporte Periodike të Shqipërisë në kuadër të zbatimit Konventës mbi të drejtat e fëmijës;
- Doktoraturë me temë “Birësimi i të miturve nën dritën e zhvillimeve të reja në Shqipëri dhe Evropë”, Tiranë, Mars 2017;

3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ministria e Drejtësisë është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave kombëtare sa i takon shërbimeve të përkujdesit shoqëror si dhe institucioni epror i Komitetit. Në këtë kontekst MD ka gjeneruar produkte siç është Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018 - 2021, udhëzime, statistika, trajnime të stafit, raporte monitorimi si dhe aktivitete që adresojnë fokusin tonë të auditimit.

Komiteti Kombëtar i Birësimit

Komiteti funksionon në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, dhe përbëhet nga:

- a) këshilli drejtues; b) kryetari; c) Sekretariati Ekzekutiv.

Këshilli drejtues është organi më i lartë vendimmarrës i Komitetit dhe përbëhet nga kryetari, si dhe nga një përfaqësues të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil i Ministrisë së Drejtësisë, i ministrisë që mbulon fushën e shëndetësisë, i ministrisë që mbulon fushën e arsimit dhe shkencës, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i ministrisë që mbulon fushën e rendit publik, i ministrisë që mbulon fushën e financave, i ministrisë që mbulon fushën e çështjeve sociale, një pedagog i së drejtës familjare nga universitetet publike dhe një përfaqësues i shoqatës së jetimëve. Kryetari i Komitetit

drejton këshillin drejtues dhe sekretariatit ekzekutiv. Sekretariati Ekzekutiv i Komitetit përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme dhe personeli i shërbimit, të cilët ndihmojnë këshillin drejtues në ushtrimin e funksioneve të veta. Veprimtaria e sekretariatit përcaktohet në ligj dhe në rregulloren e brendshme të Komitetit. Struktura dhe organika e Komitetit miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Rregullorja e brendshme e Komitetit miratohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e këshillit drejtues të Komitetit.

Këshilli Drejtues i Komitetit ka këto detyra:

- Vendos për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues.
- Jep pëlqimin, me shkrim dhe në mënyrë kolegjiale, për birësimin e fëmijës nga aplikantët birësues, nisur nga interesi më i lartë i fëmijës.
- Merr masat e nevojshme për të shmangur dështimin e birësimeve, përfitimet e padrejta, si dhe çdo lloj veprimtarie, që synon trafikimin e fëmijëve.
- Cakton kohëzgjatjen, mënyrën dhe vendin ku do të realizohet periudha e provës për përshtatshmërinë e birësuesve me të birësuarin.
- Miraton projekt buxhetin e Komitetit dhe propozon strukturën organike të tij.
- Miraton programet e punës së Komitetit dhe politikat përkatëse për përmirësimin e procedurave të birësimit.
- Analizon, në fund të çdo viti, veprimtarinë financiare dhe administrative të Komitetit.
- Propozon për miratim, me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Financave, tarifat për shërbimet e kryera për birësim.
- Përbush detyrimet që rrjedhin nga konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara për të drejtat e fëmijëve në birësim.
- Bën propozime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e birësimit, në interes të fëmijës.
- Vlerëson për çdo rast përfundimet për bashkimin birësues - i birësuar, që ka miratuar dhe mbikëqyr nëse birësimi i përgjigjet interesit më të lartë të fëmijës.
- U kërkon agjencive, vendase dhe të huaja, informacion për gjendjen e fëmijës së birësuar, në afate të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar me to.
- Nxiti bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve qendrore të vendeve të tjera, si dhe hartimin e marrëveshjeve dypalëshe me agjencitë e huaja ndërmjetëse.
- Miraton veprimtarinë e agjencive të huaja, që punojnë në fushën e birësimit në Shqipëri.
- Informohet për veprimtarinë e agjencive të licencuara, pas kontroleve të ushtruara nga strukturat e Komitetit dhe, kur vëren se ato kanë kryer shkelje të detyrimeve ligjore, propozon masa administrative deri në heqjen e licencës.

Shërbimi Social Shtetëror e shtrin aktivitetin e tij në nivel qendror dhe rajonal. Sa i takon shërbimeve të përkujdesit shoqëror kryen, ndër të tjera, monitorimin e zbatimit të standardeve për shërbimin e përkujdesjes alternative për fëmijët pa kujdes prindëror, çdo tre muaj, përfshirë proceset e punës së punonjësit social të njësisë vendore dhe monitoron fëmijët e vendosur në familje kujdestare, në qarkun përkatës.

Ndërsa, sipas standardeve, shërbimet që ofrohen në IPSH janë të tipit:

- Shërbime psiko - sociale (këshillim, punë grupi, terapi, aktivitete kulturore, sportive, integruese, formuese, argëtuese, etj.);
- Shërbim shëndetësor: (kontrolle mjekësore, vaksinim, dieta etj.);
- Shërbim mbështetës: (përkujdesje, ushqim, veshmbathje etj.);
- Shërbim edukues: (arsimim, kurse kualifikuese, mësim);
- Shërbime alternative.

3.4 Pesha në buxhet

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është institucion buxhetor i cili financohet nëpërmjet programit buxhetor “Shërbimet për çështjet e birësimeve” të alokuar nga Ministria e Drejtësisë. Në vite, krahasuar me programet e tjera buxhetore ky program ka vlerën më të ulët të financimit buxhetor e cila përbën mesatarisht 0.14% të totalit të alokuar për aparatën e Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të tjera të varësisë.

Tabela nr. 1 Buxheti fillestar i Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të varësisë në 000/lekë

Ministria e Drejtësisë	2019	2020	2021	2022
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	910,844	805,300	573,800	690,540
Ndihma Juridike	76,000	76,000	75,000	84,000
Publikimet Zyrtare	63,560	59,400	66,000	59,500
Mjekësia Ligjore	92,000	87,000	81,000	93,000
Sistemi i Burgjeve	5,793,174	5,733,290	5,818,900	6,269,900
Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor	173,100	154,100	173,000	155,560
Shërbimet për çështjet e birësimeve	14,700	16,500	15,200	15,800
Shërbimi i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	4,893,680	3,763,000	2,250,000	3,755,000
Shërbimi i Provës	184,700	151,800	155,800	156,832
TOTAL	12,201,758	10,846,390	9,208,700	11,280,132
Në % krahasuar me totalin e MD	0.12%	0.15%	0.17%	0.14%

Burimi: KSHB/Përpunuar nga KLSH

Më konkretisht, buxheti i këtij institucioni (pas shtesave dhe pakësimeve) për periudhën 2019 - 2022 është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 2 Programi Buxhetor Shërbimet për çështjet e birësimeve 2019 - 2022

Viti	Programi Buxhetor - Shërbimet për çështjet e birësimeve	Realizimi në %
2019		
Plan	11,000,000	71%
Fakt	7,828,335	
2020		
Plan	11,070,000	91%
Fakt	10,111,617	
2021		
Plan	10,750,000	89%
Fakt	9,590,045	
2022		
Plan	13,165,000	83%
Fakt	10,986,826	

Burimi: KSHB/Përpunuar nga KLSH

Në vite përqindja e realizimit të buxhetit kundrejt planit të rishikuar varion nga 71% (përqindja me e ulët e realizimit në vitin 2019) në 91% (përqindja më e lartë e realizimit në vitin 2020). Në kuadër të kompetencave të veta ligjore për kryerjen me sukses të procesit të birësimeve, institucioni arkëton tarifa për procedurat e birësimit të cilat derdhen automatikisht për llogari të institucionit në thesar. Për periudhën objekt auditimi institucioni ka gjeneruar të ardhura totale në vlerën 5,455,270 lekë sipas tabelës së mëposhtme.

Tabela nr. 3 Të ardhurat nga tarifat për birësim në lekë

Të ardhurat	Vlera e derdhur ne buxhetin e shtetit
Të ardhurat për vitin 2019	1,494,150
Të ardhurat për vitin 2020	964,820
Të ardhurat për vitin 2021	794,890
Të ardhurat për vitin 2022	1,064,003
Të ardhurat për 9-mujorin 2023	1,137,407
Total 2019 – 9 mujori 2023	5,455,270

Burimi: KSHB/Përpunuar nga KLSH

3.5 Feedback-u i subjekteve në fazën e terrenit


Komiteti Shqiptar i Birësimit gjatë fazës së terrenit është treguar i gatshëm dhe i hapur ndaj grupit të auditimit duke vendosur në dispozicion dokumentet e kërkuara sipas afateve të përcaktuara nga grupi i auditimit. Përgjithësisht komunikimi ka qenë korrekt dhe bashkëpunues.

Ministria e Drejtësisë nuk ka arritur të përmbush plotësisht të gjitha kërkesat për informacion e dokumentacion të grupit të auditimit. MD ka patur vështirësi në identifikimin e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e KSHB-së, si dhe në gjetjen e dokumentacionit të veprimtarisë së komisionit të miratimit të agjencive të huaja ndërmjetësuese dhe raportimeve të KSHB-së te Ministri. Kjo situatë ka bërë që dokumentacioni dhe informacionet e dorëzuara të mos jenë të plota dhe të vëna në dispozicion në afatin e kërkuar.

4. DETAJET E AUDITIMIT

4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Analiza SWOT



Në vijim, grupi i auditimit bëri një ndarje intuitive të risqeve të veprimtarisë duke i kategorizuar ata në strategjikë, ligjor, operacional dhe teknikë.

Tabela e Klasifikimit të risqeve: Dobësitë dhe Kërcënimet


KATEGORIZIMI I RISKUT	NIVELI I RISKUT		
	I ULET	MESATA R	I LARTË
Strategjik			
Komiteti Shqiptar i Birësimeve nuk ka një strategji institucionale;		✓	
Ministria e Drejtësisë ka ndërveprim të kufizuar me Komitetin Shqiptar të Birësimeve			✓
Teknik			
Mungon një metodologji që udhëheq procesin e birësimit;			✓
Zbardhja e vendimeve të gjykatave vonon procesin		✓	
Operacional			
Procesi i birësimit nuk ka qenë asnjëherë objekt auditimi			✓
Komiteti Shqiptar i Birësimeve nuk e kryhen vet monitorimin pas birësimit për birësimet ndërvendase			✓
Ligjor			

Legjislacioni që rregullon procesin nuk është shterues			✓
Procesi i licencimit dhe mbarëvajtja e marrëdhënieve me agjencitë ndërvendase për birësimin nuk jep garanci mbi to			✓

4.2 Objektivat e auditimit

Auditimi me temë “Procesi i birësimin të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim”, ka si objektiv kryesor analizimin e procesit të birësimin të fëmijëve në vendin tonë me një fokus të veçantë në garantimin e të drejtave të tyre në gjirin e familjes birësuese përgjatë këtij procesi kaq delikat. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv nëse baza ligjore aktualisht në fuqi, politikat e parashikuara dhe praktikata e ndjekura në vendin tonë funksionojnë të gjitha unison me synimin e vetëm të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve përgjatë procesit të birësimin.

4.3 Pyetjet e auditimit



4.4 Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i Performancës me temë “Procesi i birësimin të fëmijëve dhe garantimi i të drejtave të tyre për mirërritje dhe edukim” ka në fokus procesin e birësimin të fëmijëve të deklaruar të braktisur dhe mënyrën se si garantohen të drejtat e tyre gjatë këtij procesi. Për këtë arsye në trajtimin e kësaj tematike grupi i auditimit ka përfshirë si subjekte auditimi:

- Ministrinë e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit epror që monitoron dhe mbikëqyr veprimtarinë e Komitetit Shqiptar të Birësimin, si dhe që licencon agjencitë ndërmjetësuese të huaja për kryerjen e birësimeve ndërvendas. Gjithashtu ky institucion është i rëndësishëm pasi, nëpërmjet një përfaqësuesi të emëruar në Këshillin Drejtues të Birësimeve ka edhe fuqi vendimmarrëse për dhënie e vendimeve të përshtatshmërisë për birësim të çifteve, si dhe vendimeve për birësim të fëmijëve.

- Komitetin Shqiptar të Birësimeve, në cilësinë e institucionit të ngarkuar nga ligji për birësimin për kryerjen e procesit të birësimin, identifikimin e fëmijëve që i plotësojnë kushtet për birësim, monitorimin e institucioneve rezidenciale të përkujdesit për fëmijë publike dhe private, monitorimin pas birësimin etj.

- Shërbimin Social Shtetëror, në cilësinë e institucionit epror, që mbikëqyr dhe monitoron veprimtarinë e institucioneve rezidenciale publike dhe private të përkujdesit shoqëror për fëmijë, si dhe vetë institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror për fëmijë.

Gjithashtu, auditimi do të vlerësojë nëse strukturat përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë midis tyre.

Periodha e auditimit e përzgjedhur për trajtimin e kësaj teme përfshin vitet 2019 – 9 muhori 2023, pa përjashtuar këtu edhe përfshirjen e periudhave kohore të mëparshme që mund të shpjegojnë çështje, fenomene dhe dukuri të cilat reflektohen në situatën aktuale.

5. SHITJELLIMI I PYETJEVE TË AUDITIMIT

Pyetja kryesore: A kanë garantuar institucionet përgjegjëse interesin më të lartë të fëmijës gjatë procesit të birësimit?

MESAZHI I AUDITIMIT

Institucionet përgjegjëse për birësimin në Shqipëri nuk kanë garantuar zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore në fuqi, si parakusht për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës përgjatë procesit të birësimit vendas dhe ndërvendas, duke cenuar procesin e duke mos reflektuar në shkallën më të lartë parimet themelore të sanksionuara në Konventën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin Ndërvendas.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, duhet të inkurajojnë një qasje të qëndrueshme në mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Këto institucione duhet të koordinojnë veprimtarinë e tyre dhe të plotësojnë legjislacionin në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ato duhet të nxisin: bashkëpunimin në fushën e birësimit ndërvendas; vlerësimin dhe sigurimin e kushteve të duhura për mirërritjen e fëmijës; monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit të birësimit si dhe identifikimin e çdo sfide ndaj sigurimit të mirëqenies dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve të braktisur.

5.1 A është i plotë dhe i përditësuar kuadri ligjor dhe rregullator që mbulon procesin e birësimit?

Legjislacioni shqiptar e shikon birësimin si një mundësi për jetë familjare të përhershme në familjen birësuese, si për fëmijën të cilit i mungon ose i është privuar mjedisi familjar, ashtu edhe në rastin e fëmijës jo të privuar nga ky mjedis. Në vendin tonë procedura e birësimit shoqërohet me një praktikë administrative dhe gjyqësore përmes së cilës fëmijës, i cili është shpallur i braktisur dhe është privuar nga mjedisi familjar, i sigurohet një jetë e re.

Instituti i birësimeve është rregulluar nga Kodi i Familjes që prej vitit 1982. Në Shkurt të vitit 1992, Shqipëria ratifikoi Konventën e OKB “Për të drejtat e fëmijës” e cila hyri në fuqi në Mars të vitit 1992. Në bazë të kësaj Konvente u hartua Ligi nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në kodin e familjes”, i cili u miratua nga Kuvendi më datë 17.12.1992.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve u krijua në vitin 1993 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 7650, datë 17.12.1992 “Për birësimet e të miturve nga shtetas të huaj dhe për disa ndryshime në kodin e familjes”. Më pas është miratuar Ligji nr. 9695, në datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, i cili ka shfuqizuar ligjin e mëparshëm.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është i vetmi Autoritet Qendror në Shqipëri në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në fushën e birësimit, vendas ashtu edhe ndërvendas.

Ai shqyrton dhe vendos për përshtatshmërinë e aplikantit birësues dhe jep pëlqimin për realizimin e çdo birësimi. Gjithashtu, mbikëqyr periodikisht të gjitha rastet e birësimeve dhe, në rastet e birësimeve ndërvendase, bashkëpunon me autoritetet qendrore të vendeve të tjera, ku është kryer birësimi.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe vepron në përputhje me dispozitat ligjore që janë përcaktuar në një sërë konventash, ligjesh dhe derivatesh të tjera që rrjedhin në mbështetje të këtyre të fundit.

Në Komitetin Shqiptar të Birësimeve kryen dy lloj procedurash birësimi, birësim vendas dhe birësim ndërvendas¹. Birësimet ndërvendase parashikohen të kryhen në dy mënyra:

- nëpërmjet agjencive ndërmjetësuese të huaja të licencuara nga Ministria e Drejtësisë, ose
- me autoritete qendrore të birësimit.

Çdo person i cili është i interesuar të birësojë duhet t'i drejtohet me kërkesë² Komitetit Shqiptar të Birësimit. Ky organ mbledh dhe vlerëson kërkesat për birësim të bëra nga shtetas të huaj dhe vendas, jep informacionet e nevojshme lidhur me plotësimin e dokumentacioneve, bashkëpunon me autoritetet publike dhe private të vendit dhe të huaja për të siguruar mbrojtjen e të miturve. Në kërkesën për birësim, personi duhet të parashtojë edhe motivet për të cilat dëshiron të birësojë. Shtetasit shqiptarë, që dëshirojnë të birësojnë fëmijë shqiptarë, i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit. Shtetasit shqiptarë, që jetojnë jashtë Republikës së Shqipërisë, mund gjithashtu t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të njihet në vendin ku ata jetojnë. Ata mund të birësojnë vetëm fëmijë, emrat e të cilëve janë në listat³ e Komitetit. Shtetasit e huaj mund t'i drejtohen Komitetit vetëm nëpërmjet autoriteteve qendrore kompetente ose agjencive ndërmjetësuese të vendit të tyre, të njohura si të tilla nga Komiteti. Shtetasit e huaj, që jetojnë prej dy vjetësh në Republikën e Shqipërisë, mund t'i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, vetëm nëse legjislacioni i tyre kombëtar e lejon birësimin. Procesi i birësimit përfundon me vendim gjykate të formës së prerë, i cili është i përvokueshëm, që do të thotë se me marrjen e këtij vendimi nuk ka më kthim pas (**i pa rikthyeshëm**), nga ku statusi ligjor i fëmijës kalon nga ai i prindërve biologjik, tek prindërit birësues. Në këto kushte, të dhënat në certifikatën e lindjes së fëmijës, ndryshojnë.

Prej krijimit të tij, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka realizuar birësimeve vendase dhe birësime ndërvendase, me një total prej **1857** birësime (anekset bashkëlidhur).

Nga shqyrtimi i kuadrit ligjor në fushën e birësimit konstatohet se:

Kuadri ligjor në fuqi në vendin tonë nuk ka vendosur një kufi maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve.

Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë⁴ dhe ligji për birësimin⁵ parashikojnë disa kriterë, nga plotësimi i të cilave, aplikantët birësues konsiderohen të përshtatshëm ose jo për të birësuar.

Që një person të legjitimohet për të birësuar një fëmijë në RSH, përveç kriterëve tjera, për kriterin moshe është vendosur diferenca prej 18 vitesh me të birësuarin dhe 15 vitesh nëse birësohet fëmija i bashkëshortit/bashkëshortes.⁶ Ky është i vetmi kriter i përcaktuar në dispozitat e legjislacionit në fuqi për sa i përket moshës së aplikantëve birësues. Vërehet se legjislatori ka parashikuar diferencën minimale moshore të lejuar, por mungon parashikimi për një diferencë maksimale të lejueshme, siç e kanë legjislacionet e disa vendeve evropiane. Nëse shqyrtojmë rastin e legjislacionit italian, diferenca moshore ndërmjet birësuesit dhe të birësuarit, ashtu si në ligjin shqiptar për birësimin, duhet të jetë minimalisht 18 vite, por diferenca maksimale e lejueshme duhet të jetë deri në 45 vite për njërin bashkëshort dhe 55 për

¹ Përcaktimi i birësimit ndërvendas është procesi i birësimit të fëmijëve nga familjet në një shtet tjetër të ndryshëm nga shteti i lindjes.

² Neni 18, Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007, i ndryshuar "Dokumentacioni i aplikantit birësues".

³ Neni 20, Ligji nr. 9695, datë 19.3.2007, i ndryshuar: "Në listat e Komitetit regjistrohen ata fëmijë shqiptarë, për të cilët: a) është deklaruar braktisja me një vendim gjyqësor të formës së prerë; b) është dhënë pëlqimi nga prindërit biologjikë; c) është dhënë pëlqimi nga gjykata për fëmijët që ndodhen në përkujdesje, sipas paragrafit të tretë të nenit 246 të Kodit të Familjes."

⁴ Ligji nr. 9062, datë 8.5.2003 "Kodi i Familjes", i ndryshuar.

⁵ Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit".

⁶ Neni 241 Kodi i Familjes.

tjetrin.⁷ Legjislatori italian ka parashikuar vendosjen e një kufiri tavan, me qëllimin për të formuar familjen birësuese në imazhin dhe ngjashmërinë e familjes natyrale.

Mosparashikimi i moshës maksimale të lejuar, ka sjellë si pasojë që aplikantët birësues të kërkojnë të birësojnë vetëm fëmijë të moshave 0 - 4 vjeç dhe të refuzojnë grup moshat e tjera. Diferenca e moshës ndërmjet prindit birësues dhe të birësuarit duhet të jetë ajo e një marrëdhënieje biologjike prind - fëmijë. Krijimi i një marrëdhënie birësimi me një diferencë të madhe në moshë, nuk e arrin qëllimin që ka instituti i birësimit për krijimin e marrëdhënies prind - fëmijë bazuar në interesin më të lartë të tij. Diferenca e madhe e moshës së prindit birësues në krahasim me fëmijën, do të sillte problematika më të mëdha në mirëritje. Kjo diferencë mund të krijojë një hendek në marrëdhëniet emocionale për plotësimin e nevojave të fëmijës me sfidat që ai kalon gjatë jetës. Për këtë arsye, me qëllim që një familje birësuese të jetë sa më e shëndetshme si dhe më e përafërt me modelin e familjes biologjike, duhet vendosja e një moshe limit midis birësuesve dhe fëmijës së birësuar. Ky fakt merr një rëndësi të veçantë pasi fëmijët e grup moshave 0 - 4 vjeç janë ata me % më të lartë të kërkesave dhe realizimeve të birësimeve. Për grup moshat e tjera, 5 - 9 dhe mbi 10 vjeç, interesi është më i ulët, për rrjedhojë fëmijë të këtyre grup moshave birësohen më pak.

TË DHËNA TË FËMIJËVE TË BIRËSUAR GJATË VITIT										
Viti 2019										
Grupmosha	Deri 1 vjeç		1-4 vjeç		5-9 vjeç		Mbi 10 vjeç		Totali	
Nr. i fëmijëve	10		9		4		3		26	
Gjinia	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Numri i fëmijëve	5	5	2	7	1	3	2	1	10	16
Kombësia	Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare (1 fëmijë mashkull lindur në Gjakovë, Kosovë)		Shqiptare		Shqiptare	
Viti 2020										
Grupmosha	Deri 1 vjeç		1-4 vjeç		5-9 vjeç		Mbi 10 vjeç		Totali	
Nr. i fëmijëve	4		14		3		5		26	
Gjinia	F	M	F	M	F	F	M	F	M	F
Numri i fëmijëve	2	2	6	8	0	2	2	6	8	0
Kombësia	Shqiptar e		Shqiptar e		Shqiptare		Shqiptare (1 fëmijë femër lindur në Rio, Greqi)		Shqiptare	
Viti 2021										
Grupmosha	Deri 1 vjeç		1-4 vjeç		5-9 vjeç		Mbi 10 vjeç		Totali	
Nr. i fëmijëve	9		7		3		-		19	
Gjinia	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Numri i fëmijëve	5	4	3	4	1	2	-	-	9	10
Kombësia	Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare	
Viti 2022										
Grupmosha	Deri 1 vjeç		1-4 vjeç		5-9 vjeç		Mbi 10 vjeç		Totali	
Nr. i fëmijëve	8		15		8		4		35	
Gjinia	F	M	F	M	F	F	M	F	M	F
Numri i fëmijëve	3	5	7	8	4	4	4	-	18	17

⁷ Neni 6 Ligjit 149/2001

Kombësia	Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare	
Viti 2023										
Grupmosha	Deri 1 vjeç		1-4 vjeç		5-9 vjeç		Mbi 10 vjeç		Totali	
Nr. i fëmijëve	7		7		5		3		22	
Gjinia	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Numri i fëmijëve	1	6	4	3	4	1	2	1	11	11
Kombësia	Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare		Shqiptare	

Burimi: KS HB/përpunoi Grupi i Auditimit

Kuadri ligjor në fuqi nuk përmban përcaktime sa i përket qëndrueshmërisë, sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar.

Në lidhje me statusin e gjendjes civile të aplikantëve birësues, Kodi i Familjes përcakton se i mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë.⁸ Nga interpretimi literal dhe logjik i normave të Kodit, legjitimohen për të birësuar personat beqarë, bashkëshortët së bashku dhe bashkëshorti/ja i njërit prind biologjik.⁹

Për sa më lart, parë në këndvështrim krahasimor me legjisllacione të tjera evropiane, nëse marrim sërish për referencë legjisllacionin italian apo atë gjerman¹⁰, ku përveç sa ka parashikuar kodi ynë i familjes, ekzistojnë dhe përcaktime ligjore sa i përket qëndrueshmërisë, sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar.

Konkretisht, në legjisllacionin italian, aplikantët birësues (çift) duhet të jenë prej 3 vitesh të martuar, pa shkëputje, as de facto ose të bashkëjetojnë në një marrëdhënie të qëndrueshme prej 3 vitesh. Periudha trevjeçare mund të merret edhe një bashkim i viteve të bashkëjetesës dhe martesës së bashku. Kërkesa e qëndrueshmërisë së marrëdhënies, mund të konsiderohet e përmbushur edhe kur bashkëshortët kanë jetuar së bashku në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme para martesës për një periudhë trevjeçare, në rast se gjykata për të mitur konstaton vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e bashkëjetesës, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret.¹¹ Parashikimi i një kriteri ligjor të tillë përbën një garanci të shtuar në realizimin e interesit më të lartë të fëmijës, si dhe shmang arbitraritetin në vendimmarrje duke i përcaktuar këshillit drejtues kriteret të qarta dhe të sakta. Në instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe legjisllacionet kombëtare të vendeve të BE-së, në mënyrë eksplicite proklamohet interesi më i lartë i fëmijës, si kushti më kryesor dhe i domosdoshëm për të ardhmen e tij. Sipas legjisllacionit shqiptar në fuqi, përballë situatës së fëmijëve të shpallur të braktisur synohet gjetja e një familje birësuese dhe mbrojtja e interesit më të lartë të tyre, ku kjo e dyta duhet të prevaloj mbi të parën. Për sa më lart, një çift aplikantësh birësues të martuar prej 3 vitesh, pa shkëputje de facto, paraqet një qëndrueshmëri dhe konsolidim të marrëdhënies, e cila premtion të krijojë kushte optimale për mirëqenien, mirërritjen dhe edukimin e një fëmije.

Kuadri ligjor në fuqi nuk përmban përcaktime sa i përket kriterit ekonomik për aplikantët birësues të martuar

Bazuar në praktikën e mira për sa i përket gjendjes ekonomike dhe financiare është vërejtur se ligjet që rregullojnë procesin e birësimit nuk parashikojnë në mënyrë eksplicite kriteret ekonomike dhe financiare por, ato i referohen kuadrit më të gjerë të vendeve të tyre që përcakton minimumin jetik. Në kushtet kur në vendin tonë, minimumi jetik është ende i papërcaktuar, përshtatshmëria ekonomiko financiare e aplikantëve birësues gjykohet pa patur

⁸ Neni 242 Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë

⁹ Neni 241, paraf. 2 dhe Neni 242 Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë

¹⁰ Legjisllacioni gjerman, në rastin e birësimit nga një çift i martuar, kërkon që partneriteti martesor të jetë i qëndrueshëm.

¹¹ Neni 6 Ligjit 149/2001.

një kriter referencë, duke mbetur kështu në diskrecionin e anëtareve të Këshillit Drejtues. Në lidhje me këtë kriter, legjislatori duhet të përcaktojë një nivel dysHEME të ardhurash të cilat mund të konsiderohen të mjaftueshme për mirëritjen e fëmijës dhe në mbrojtje të interesit të tij më të lartë. Në legjislacionet e tjera (*italian dhe gjerman*)¹² vendoset një theks i veçantë për kushtet e jetesës dhe ato ekonomike të aplikantëve birësues. Përgjithësisht aplikantët duhet të sigurojnë për fëmijët e birësuar një hapësirë të mjaftueshme ku fëmija të ndihet rehat në ambientet e reja të banimit dhe të mund të ketë dhomën e tij. Kërkesa këto të mjaftueshme për të marrë përshtatshmërinë për të birësuar. Duhet shtuar këtu edhe faktin se në gjykimin mbi përshtatshmërinë shtohen edhe rrethanat profesionale të aplikantëve të cilat presupozojnë se jetesa e fëmijës është e sigurar, përfshirë këtu edhe kohën e mjaftueshme dhe përkushtimin e nevojshëm për rritjen e fëmijës.

Në këtë kontekst, ligji shqiptar për të verifikuar kushtet e përshtatshme të jetesës së aplikantëve birësues kërkon që ata të paraqesin dokumentacion të pronësisë së banesës dhe të dhëna për kushtet e banimit.¹³ Ky dokumentacion duhet të shqyrtohet nga Këshilli Drejtues për dhënien e përshtatshmërisë së aplikantëve birësues. Pra, ndryshe nga legjislacionet e huaja, legjislacioni ynë presupozon verifikimin e kushteve të jetesës vetëm nëpërmjet prezantimit të një dokumenti pronësie, duke përjashtuar nga procesi aplikantët e mundshëm birësues në rast se ata nuk kanë një vërtetim të tillë. Pra, nuk merren në konsideratë nga legjislacioni ynë çështje të tjera si për shembull, hapësirat e mjaftueshme (*qoftë edhe në m²*) që duhet të ketë ambienti i banimit i aplikantëve birësues për të birësuar, një, dy apo më shumë fëmijë. Po kështu, mungojnë udhëzime të qarta për të dhënat e kushteve të banimit të cilat konsiderohen të përshtatshme për të birësuar duke garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Në praktikën e ndjekur në vite vlerësimi i këtyre kriterëve bazohet në gjykimin e anëtarëve të KD, të cilët në praktikë përpiqen që të reflektojnë një balancë të elementëve cituar më sipër.

Që nga viti 2020 është hartuar një projekt ligj i cili propozon ndryshime të ndryshme të ligjit aktual për birësimin, por që nuk prek asnjë nga aspektet e cituara më sipër. Kryesisht propozon ndryshime të karakterit organizativ të KSHB-së.

Ligji për birësimet nuk parashikon mandat për Anëtarët e Këshillit Drejtues.

Këshilli Drejtues¹⁴ është organi më i lartë vendimmarrës i Komitetit dhe përbëhet nga kryetari, si dhe nga një përfaqësues të nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil i Ministrisë së Drejtësisë, i ministrisë që mbulon fushën e shëndetësisë, i ministrisë që mbulon fushën e arsimit dhe shkencës, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i ministrisë që mbulon fushën e rendit publik, i ministrisë që mbulon fushën e financave, i ministrisë që mbulon fushën e çështjeve sociale, një pedagog i së drejtës familjare nga universitetet publike dhe një përfaqësues i shoqatës së jetimëve. Këshilli drejtues funksionon si organ kolegjal, në bazë të legjislacionit shqiptar. Kryetari i Komitetit është anëtar i KD dhe e drejton atë.

Gjatë viteve objekt auditimi anëtarët e Këshillit Drejtues nuk kanë pësuar ndryshime të shpeshta, por vërehet se në ligjin për birësimin nuk parashikohet mandat për anëtarët e KD. Parashikimi i një mandati të caktuar ndihmon në shmangien e familjarizimit të anëtarëve të KD me njëri tjetrin, si edhe me aplikantët në listë pritje, fakt i cili mund të ndikojë në objektivitetin

¹² <https://www.minoriefamiglia.org/images/allegati/legge-184.pdf>
<https://www.parlamento.it/parlam/leggi/011491.htm#:~:text=II%20diritto%20del%20minore%20a,princ%C3%A4Cpi%20fondamentali%20dell'ordinamento%C2%BB>
https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/englisch_bgb.html#p6701
https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_famfg/englisch_famfg.html#p0995

¹³ Neni 18 pika 8, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimin dhe Komitetin Shqiptar të Birësimin’, i ndryshuar.

¹⁴ Neni 5 Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimin dhe Komitetin Shqiptar të Birësimin’, i ndryshuar.

e tyre në vendimmarrje. Nga ana tjetër, nëse anëtarëve të KD –së u përcaktohet mandati me ligj, pas emërimit të tyre fillestar nga ministria përfaqësuese, këta nuk janë më të zëvendësueshëm për kohëzgjatjen e mandatit. Ky parashikim do të shërbente si garanci e qëndrueshmërisë së anëtarit dhe pavarësisë së tij nga ndikimet e jashtme.

Aplikantët shqiptar rezident jashtë vendit nuk trajtohen gjithmonë në përputhje me ligjin për birësimet.

Një tjetër problematikë e cila ka rezultuar gjatë këtij auditimi ka të bëjë me parashikimet e ligjit.¹⁵ për birësimet sa i takon shtetasve shqiptarë rezident jashtë vendit. Në nenin 14, pika 4 të ligjit parashikohet se, shtetasit shqiptarë rezident jashtë vendit dhe që duan të birësojnë mund ti drejtohen direkt Komitetit për të kryer këtë proces, me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të sjellë pasoja juridike në vendin e tyre të rezidencës.¹⁶ KSHB, në këtë drejtim, nuk ka zbatuar ligjin gjithmonë në mënyrë uniforme, duke detyruar shtetasit shqiptarë të aplikojnë përmes agjencive ndërmjetësuese të huaja ku, ata detyrohen të paguajnë tarifa shumë të larta krahasuar me tarifën që duhet të paguajnë në rast se aplikojnë direkt në Komitet. Më konkretisht nga verifikimet e kryera gjatë auditimit si dhe nga intervistat në vend ka rezultuar se në rastet kur kërkesa për birësim është pranuar nga KSHB dhe është dhënë edhe vendimi i përshtatshmërisë së çiftit, nuk është vijuar më tej me propozimin e një fëmije për shkak të pamundësisë për të monitoruar procesin pas birësues.¹⁷ Ndërsa në rastet e tjera aplikantët birësues shqiptarë rezident jashtë vendit janë orientuar menjëherë drejt agjencive ndërmjetësuese të huaja. Kjo situatë është shqyrtuar edhe gjatë hetimit administrativ të bërë nga MD. Arsyeimi i pamundësisë së KSHB-së për të monitoruar procesin pas birësues nuk qëndron pasi në rastin e birësimeve ndërvendase të kryera me Agjenci Ndërmjetësuese, po i njëjti proces kryet pa mbikëqyrje nga KSHB sepse ky institucion mjaftohet vetëm me raportet periodike pas birësues që agjencitë dërgojnë në KSHB. Në të dyja rastet nuk ka monitorim të drejtpërdrejt nga KSHB. Për më tepër që kuptimi i paragrafit të sipërcituar qartësisht orienton KSHB-në në drejtim të verifikimit nëse vendi i rezidencës së shtetasit shqiptar do të njoh vendimin gjyqësor shqiptar për birësimin. Kryerja e procesit pas birësues nuk është kusht ligjor për mospranimin e kërkesës apo mos propozimin e një fëmije, pasi ligji parashikon që KSHB të nënshkruajë marrëveshje me autoritetet qendrore dhe agjencitë ndërmjetësuese. Në këtë kontekst, mund të parashikohen mënyrat sesi mund të kryhet monitorimi pas birësues, nëpërmjet ndërmjetësimit të institucioneve të vendeve rezidente të shtetasve shqiptarë.

Parashikimet e VKM - së për heqjen e licencës së agjencive ndërmjetësuese të huaja shkojnë përtej dispozitave të ligjit për birësimet.

Në ligjin për procedurat e birësimit parashikohen rastet kur agjencive i hiqet licencimi në fushën e birësimeve në vendin tonë, ku ndër të tjera thuhet se këto subjekte nuk mund të ushtrojnë më veprimtarinë në këtë fushë nëse kanë kryer vepër penale. Nga ana tjetër, VKM në pikën 8, germa c parashikon që veprimtaria e agjencive mbaron kur Komisioni revokon licencën për arsye se ka një dënim të formës së prerë për vepër penale me dashje. Në këtë drejtim vërehet se VKM e sipërcituar është thelluar në analizimin e elementit të anës subjektive të veprës penale, duke përjashtuar kështu veprat penale që mund të ndodhin nga pakujdesia apo neglizhenca. Kjo dispozitë bie ndesh me nenin e sipërcituar të ligjit, pasi kufizon fushë

¹⁵ Kreu III, Përgatitja e Dokumentacionit Birësues, neni 14, pika 4, ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, i ndryshuar

¹⁶ Shtetasit shqiptarë, rezidentë jashtë Republikës së Shqipërisë, mund t’i drejtohen drejtpërdrejt Komitetit, me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të sjellë pasoja juridike në vendin e tyre të rezidencës. Ky rregull zbatohet edhe kur shtetasi shqiptar ka lidhur martesë me një shtetas të huaj apo person pa shtetësi

¹⁷ Hetim administrativ ushtruar në zbatim të urdhrit të MD nr. 552 datë 06.12.2019 ‘Për kryerjen e hetimit administrativ pranë komitetit Shqiptar të Birësimit’.

zbatimin e ligjit sa i takon heqjes së licencës në rastin e kryerjes së një veprë penale. Analizimi i elementeve të veprës penale është kompetencë ekskluzive e pushtetit gjyqësor gjatë procesit penal. Nga ana tjetër, legjislatori ka parashikuar se vetëm njohja dhe miratimi i agjencive ndërmjetësuese të huaja duhet rregulluar me vendim të këshillit të Ministrave, ndërkohë që plotësimi i kushteve për heqjen e licencës është detajuar në ligj.

Gjetje dhe Rekomandime

1. Gjetje nga auditimi: Aktualisht, legjislacioni në fuqi në fushën e birësimeve nuk parashikon kriteret të qarta dhe të plota sa i takon: kufirit maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve; qëndrueshmërisë e sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar; kriterit ekonomik për aplikantët birësues. Konkretisht, në Kodin e Familjes nuk parashikohet moshë kufi ku aplikantëve birësues u lejohet të paraqesin kërkesën për birësim. Në ligjin për birësimet nuk ka përcaktime ku të flitet për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e lidhjes martesore në kohë siç parashikohet në legjislacione të tjera (si p.sh. në *Itali çifti duhet të jetë i martuar të paktën 3 vjet dhe jetesa e përbashkët të mos ketë patur shkëputje*). Po kështu, duke krahasuar situatën e vendit tonë me praktika më të mira, përshtatshmëria ekonomiko financiare e aplikantëve birësues gjykohet pa patur një kriter të saktë reference.

2. Gjetje nga auditimi: Ligji për birësimet nuk parashikon mandat për Anëtarët e Këshillit Drejtues. Nga auditimi ka rezultuar se anëtarët e Këshillit Drejtues kanë ndryshuar shumë pak në vite. Parashikimi i një mandati të caktuar ndihmon në shmangien e familjarizimit të anëtarëve të KD me njëri tjetrin, si edhe me aplikantët në listë pritje, fakt i cili mund të ndikojë në objektivitetin e tyre në vendimmarrje.

3. Gjetje nga auditimi: Parashikimet e VKM - së nr. 399, datë 01.06.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja”, sa i takon heqjes e licencës së agjencive ndërmjetësuese të huaja, shkojnë përtej dispozitave të ligjit për birësimet. Në të thuhet se agjencive u hiqet licenca nëse kanë kryer veprë penale me dashje, duke përfshirë kështu veprat penale që mund të ndodhin nga pakujdesia apo neglizhenca, e duke rënë ndesh me ligjin për birësimet.

4. Gjetje nga auditimi: Në ligjin për birësimet parashikohet se, shtetasit shqiptarë rezident jashtë vendit dhe që duan të birësojnë mund të drejtohen direkt Komitetit për të kryer këtë proces, me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të sjellë pasoja juridike në vendin e tyre të rezidencës. KSHB, në këtë drejtim, nuk ka zbatuar ligjin gjithmonë në mënyrë uniforme, duke detyruar shtetasit shqiptarë të aplikojnë përmes agjencive ndërmjetësuese të huaja ku, ata detyrohen të paguajnë tarifa shumë të larta krahasuar me tarifën që duhet të paguajnë në rast se aplikojnë direkt në Komitet.

Konkluzione:

1. Mungesa e kriterëve të qarta e të sakta orientuese në funksion të vendimmarrjes së Këshillit Drejtues, i lehtëson këtë fundit barrën për të gjykuar dhe vendosur mbi përshtatshmërinë dhe pëlqimin për birësim pa i dhënë këtij instrumentet ligjor për një vendimmarrje në interesin ekskluziv të fëmijës. Gjithashtu, edhe mos parashikimi i një mandati për anëtarët e këtij organi mbart risk për objektivitetin e vendimmarrjes së tyre.

2. Mos zbatimi i dispozitës ligjore, sa i takon shtetasve shqiptarë rezident jashtë vendit, ka sjellë një trajtim të diferencuar ndaj tyre, duke i mohuar të drejtën për të aplikuar e përfundimisht mundësinë për të birësuar një fëmijë shqiptar.

1. 1-3 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Birësimeve, të ngrejë një grup punë për të përditësuar ligjin për birësimet dhe të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore në fushën e birësimeve, bazuar edhe në praktika të tjera më të mira ndërkombëtare, veçanërisht në drejtim të përcaktimit të kufirit maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve; qëndrueshmërisë e sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar; kriterit ekonomik për aplikantët birësues, etj.

Brenda vitit 2024

2.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve të marrë masa për të bashkëpunuar me autoritete qendrore përgjegjëse për birësimin dhe agjenci ndërmjetësuëse të huaja me qëllim zbatimin e ligjit, sa i takon birësimeve nga shtetas shqiptar rezident jashtë vendit, dhe parandalimin e dështimit të birësimin.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.2 Si ka funksionuar procesi i birësimin vendas dhe ndërvendas në vendin tonë?

Procesi i birësimin në vendin tonë rregullohet nga Kodi i Familjes¹⁸ dhe ligji për birësimet¹⁹. Ky ligj përcakton procedurat e birësimin, si dhe organizimin, funksionimin e detyrat e Komitetit Shqiptar të Birësimin (më tej KSHB).

Sipas ligjit²⁰, KSHB është i përbërë nga këshilli drejtues, kryetari, si dhe Sekretariati Ekzekutiv. Struktura dhe organika e Komitetit miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Këshilli Drejtues (më tej KD) është organi më i lartë vendimmarrës në KSHB i cili përbëhet nga Kryetari i Komitetit si dhe nga një përfaqësues i nivelit të mesëm ose të lartë drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil i Ministrisë së Drejtësisë, i ministrisë që mbulon fushën e shëndetësisë, i ministrisë që mbulon fushën e arsimit dhe shkencës, i Ministrisë së Punëve të Jashtme, i ministrisë që mbulon fushën e rendit publik, i ministrisë që mbulon fushën e financave, i ministrisë që mbulon fushën e çështjeve sociale, një pedagog i së drejtës familjare nga universitetet publike dhe një përfaqësues i shoqatës së jetimëve.²¹ Kryetari i Komitetit drejton Këshillin Drejtues dhe Sekretariatit Ekzekutiv. Sekretariati Ekzekutiv i Komitetit është struktura tjetër brenda tij, e cila përbëhet nga specialistë të fushave të ndryshme dhe personeli i shërbimit, të cilët ndihmojnë këshillin drejtues në ushtrimin e funksioneve të veta. Kjo strukturë funksionon në zbatim të ligjit për birësimet dhe rregullores së brendshme të institucionit²².

Sekretariati Ekzekutiv i Komitetit nuk është ngritur.

Gjatë këtij auditimi ka rezultuar se Sekretariati Ekzekutiv i Komitetit nuk është ngritur sikurse përcaktohet nga ligji për birësimet. Në urdhrin e kryeministrit²³ me anë të së cilit është miratuar struktura dhe organika e KSHB – së, nuk rezulton Sekretariati Ekzekutiv si pjesë përbërëse e tij, gjë kjo e cila sjell pasoja të tjera të rëndësishme duke nisur edhe nga fakti se kjo strukturë ka detyra specifike përgjatë gjithë procesit të birësimin në KSHB.

¹⁸ Titulli IV, Nenet 240 – 262, Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar.

¹⁹ Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimin dhe Komitetin Shqiptar të Birësimin’, i ndryshuar.

²⁰ Neni 5, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimin dhe Komitetin Shqiptar të Birësimin’, i ndryshuar.

²¹ Neni 5, pika 4, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimin dhe Komitetin Shqiptar të Birësimin’, i ndryshuar.

²² Rregullore e Brendshme e Komitetit Shqiptar të Birësimeve miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 4763/1, datë 08.06.2009 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar.

²³ Urdhër i Kryeministrit nr.134, datë 23,11,2021 “Për Miratimin e Organikës së Komitetit Shqiptar të Birësimeve”.

Më konkretisht, Sekretariati Ekzekutiv, ndër të tjera, ka për detyrë të:

- hartojë dhe administrojë listat e fëmijëve që mund të birësohen brenda ose jashtë vendit;
- bashkëpunojë me institucionet e përkujdesit social për fëmijët, publike dhe private, brenda vendit, për të siguruar mbrojtjen e interesave të fëmijëve që janë në këto institucione;
- shqyrtojë, verifikojë dhe vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga aplikantët birësues dhe dokumentacionin e fëmijës për t'u birësuar;
- sigurojë informacion të hollësishëm për prejardhjen e fëmijës, përfshirë prejardhjen kombëtare, fetare, kulturore dhe gjuhësore;
- realizojë intervista me aplikantët birësues dhe përgatit studimin për ta;
- organizojë këshillime, seminare dhe veprimtari të tjera në fushën e birësimit;
- t'i kërkojë sektorit të shërbimit social pranë njësive të qeverisjes vendore dhe agjencive ndërmjetësuese të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar;
- realizojë intervista për marrjen e mendimit/pëlqimit të fëmijës për birësimin;
- ushtrojë kontrole në institucionet e përkujdesjes publike dhe private për fëmijët që plotësojnë kushtet për t'u birësuar dhe verifikojë raportet periodike, të paraqitura prej tyre në Komitet për gjendjen e fëmijëve;
- si dhe të mbikëqyr veprimtarinë e agjencive ndërmjetësuese për përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare të tyre.

Në praktikën e punës aktuale në KSHB, rezulton se të gjitha këto detyra kryhen nga stafi aktual i KSHB – së, i cili sipas strukturës së miratuar përbëhet aktualisht nga 9 punonjës nga të cilët 1 Kryetari, 1 specialist - jurist, 1 specialist - punonjës social, 2 specialist – psikologë, 2 specialistë – shkenca sociale, 1 specialist – buxhet/financë, dhe 1 specialist arkiv/protokollit. Në praktikën e punës së ndjekur në Komitet citohet shpesh në procesverbale mbledhesh apo minuta takimesh të Këshillit Drejtues emërtimi “Sekretariat Teknik”, pavarësisht faktit se kjo strukturë nuk ekziston as në ligj e as në rregulloren e brendshme të Komitetit. Zakonisht, sekretariatit teknik i delegohen detyra praktike për mbarëvajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues, si shembull mbajtjen e protokollit të mbledhjes, minutat e takimeve, hartimin e axhendës së mbledhjeve etj., detyra këto që sipas ligjit për birësimet janë pjesë e detyrave që Kryetari i Komitetit, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Drejtues, mund t'i delegojë punonjësve të KSHB – së. Përdorimi i një terminologjie të ngjashme krijon konfuzion mbi mënyrën e organizimit të këtij institucioni.

Nisur nga sa më lart, detyrat specifike që ligji për birësimet dhe rregullorja e brendshme e KSHB – së ia ngarkon Sekretariatit Ekzekutiv të tij kryen, sipas rastit, nga punonjësit e KSHB – së. Më konkretisht, nga intervistat e zhvilluara me stafin aktual në KSHB, ka rezultuar se detyrat që duhet të kryheshin nga Sekretariati Ekzekutiv ndahen midis juristit, punonjësve social dhe psikologëve. Në këto kushte veprimtaria e Komitetit rezulton në disa aspekte e cunguar, pasi disa nga detyrat që i janë ngarkuar këtij Sekretariati nga ligji nuk kryhen, sikurse është në rastin e detyrës për t'u kërkuar sektorëve të shërbimit social pranë njësive të vetëqeverisjes vendore të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar. Gjatë auditimit u evidentua mungesë bashkëveprimi midis KSHB – së dhe njësive të vetëqeverisjes vendore (sektorit të shërbimit social pranë tyre) në drejtim të marrjes së informacioneve për gjendjen e fëmijëve të birësuar, aspekt ky shumë i rëndësishëm për ti dhënë kontekst dhe informacione shtesë procesit pas birësues dhe ecurisë totale të tij.

Si rezultat i mos krijimit të Sekretariati Ekzekutiv, janë evidentuar mangësi edhe në drejtim të ushtrimit të kontroleve në institucionet e përkujdesjes publike dhe private për fëmijët që plotësojnë kushtet për t'u birësuar, si dhe verifikimit të raporteve periodike, të paraqitura prej tyre në Komitet për gjendjen e fëmijëve. Po kështu problematika janë evidentuar edhe në drejtim të mbikëqyrjes së veprimtarisë së agjencive ndërmjetësuese për përbërjen, funksionimin dhe gjendjen financiare të tyre.

Më konkretisht, sa i takon marrëdhëniet me institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë dhe kontrollet mbi to, është evidentuar mungesë bashkëpunimi e ndërsjellët në drejtim të përmbushjes efektive të detyrimeve që ligji vendos mbi palët e përfshira në procesin e raportimit dhe kontrollit.

Në vendin tonë aktualisht ka 32 institucione rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë, nga të cilat 10 janë publike dhe 22 jo publike.

Sipas ligjit për birësimet²⁴, Komiteti bashkëpunon me institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë publike dhe private (më tej IPSH), të cilat i dërgojë atij informacione periodike 3 mujore për fëmijët që kanë në institucione, afatet dhe arsyet e qëndrimit të tyre aty.

IPSH – të publike dhe jo publike nuk kanë respektuar gjithmonë detyrimin për raportim 3 mujor (4 raportime në vit).

Nga të dhënat e vendosur në dispozicion nga Komiteti ka rezultuar se IPSH – të nuk kanë zbatuar gjithmonë detyrimin ligjor për raportim 3 mujor.

Nr	Institucioni	2019	2020	2021	2022	2023
1	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Tiranë	2	8	6	9	9
2	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Durrës	11	7	9	11	11
3	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Shkodër	-	2	1	4	1
4	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Vlorë	2	3	4	5	8
5	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Korçë	10	2	1	5	10
6	Shtëpia e Fëmijës 6 – 15 Tiranë	2	2	2	1	2
7	Shtëpia e Fëmijës 6 – 15 Shkodër	-	-	-	1 (vjetor)	2
8	Shtëpia e Fëmijës 6 – 15 Sarandë	1	2	1	3	5
9	Shtëpia e Fëmijës 16 – 18 Shkodër	-	-	-	-	-
10	Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror 6 – 18, Shkodër	-	-	-	-	-

Burimi: KSHB.

Nga sa më sipër evidentohet se disa IPSH publike nuk raportojnë në KSHB, si në rastin e Shtëpisë së Fëmijës (16 – 18) Shkodër, apo në rastin e Strehëzës për fëmijë pa kujdes prindëror (6 – 18), Shkodër, e cila është në varësi të Bashkisë Shkodër, ndërsa disa të tjera raportojnë, por jo në sipas frekuencës së kërkuar nga baza ligjore në fuqi, si për shembull Shtëpia e Fëmijës (6 – 15) Sarandë, Shtëpia e Fëmijës (6 – 15) Tiranë etj.

Nr.	Institucioni	2019	2020	2021	2022	2023
1	SOS Fshatrat e Fëmijëve, Tiranë	-	1	-	-	-
2	Betania, Bubq	-	1	-	-	-
3	Orët Fatlume (Shtëpia Antonia), Elbasan	-	1	4	4	4
4	Orët Fatlume, Elbasan	-	1	4	4	4
5	Projekti Shpresë për Botën Marikaj	-	-	1	-	-
6	Misionaret e Bamirësisë, Elbasan	2	2	2	6	6
7	Vatër e Ngrohtë Gjirokastër	-	2	1	7	8
8	Shtëpia Ortodokse e Shpresës, Shën Vlash, Durrës	-	2	3	3	3
9	Shtëpia e Fëmijës “Fillimet e Reja”, Tiranë	-	2	-	1	-
10	Bijat e Dashurisë Mollas, Elbasan	-	-	-	-	-
11	Komiteti Papa Giovanni XXIII, Shkodër	-	-	-	-	-
12	Qendra Kennedy, Korçë	2	2	3	-	-
13	Qendra Ravasko, Shkodër	-	1	-	-	-
14	Qendra Pishtarmbajtësi, Ersek	-	1	-	-	-

²⁴ Neni 8, pika 1, germa c (ii), Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar.

15	Qendra Rozalba, Motrat Veneri, Gjadër, Lezhë	-	1	-	-	-
16	Krahët e Shqiponjës, Tiranë	-	-	-	-	-
17	Qendra Kenedi Maliq	-	3	-	-	-
18	Qendra "E Lumja Marie Tuc", Lezhë	-	-	-	-	-
19	Karlo Akutis, Shënkoll	-	-	-	-	-
20	Qendra Betesda	-	5	4	(mbyllur)	
21	Qendra Arka, Shkodër	-	-	-	-	-
22	Tjetër Vizion, Elbasan	-	-	-	-	-

Burimi: KSHB.

Respektimi i kërkesës për raportim periodik tremujor është më i vakët në rastin e IPSH – ve jo publike, ku edhe vërehet se 7 prej tyre nuk kanë raportuar asnjëherë në KSHB për periudhën 2019 – 2023. Vetëm një IPSH ka raportuar për të gjithë periudhën (Misionaret e Bamirësisë, Elbasan), por jo çdo tre mujor sikurse kërkohet, ndërsa IPSH – të e tjera nuk kanë raportuar për të gjithë periudhën e marrë në konsideratë.

Nga ana e tij, Komiteti i është drejtuar zyrtarisht të gjitha IPSH – ve²⁵, përfshirë edhe Shërbimin Social Shtetëror në cilësinë e institucionit monitorues së tyre sa i takon zbatim të standardeve të funksionimit të IPSH – ve, duke u tërhequr vëmendjen, ndër të tjera, mbi rregullshmërinë e raportimeve të tyre në këtë drejtim.

Pavarësisht kësaj, ka rezultuar se, gjatë një kontrolli të kryer në disa IPSH publike dhe jo publike në Shkodër, specialistët e KSHB janë bërë me dije nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social për ekzistencën e një IPSH – je në varësi të Bashkisë Shkodër, e cila trajtonte fëmijë pa kujdes prindëror e që quhet “Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror 6 – 18, Shkodër”²⁶, për të cilën KSHB nuk kishte dijeni më parë. Kjo situatë evidenton mungesën e bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm që duhet të ekzistojë midis KSHB – së dhe, në rastin specifik, drejtorive rajonale të shërbimit social në rrethe, lidhur me prezencën e IPSH – ve publike apo jo publike në territorin që ato mbulojnë, pa përfshirë këtu edhe bashkëpunime e shkëmbime informacioni edhe me Bashkitë e vendit, të cilat në kuadër të financimeve të përfituara nga Fondi Social mund të ngrenë IPSH që kanë si objekt veprimtarie pikërisht trajtimin e fëmijëve pa kujdes prindëror.

Nga shqyrtimi i raportimeve të IPSH – ve publike dhe jo publike për periudhën e audituar, ka rezultuar se këto nuk raportojnë sipas një formati të unifikuar, kjo edhe pse nuk ka një format të miratuar nga KSHB për të përmbushur detyrimin e raportimit çdo tre muaj nga IPSH – të.

Kontrollet në IPSH – të publike dhe jo publike janë zhvilluar pa planifikim dhe pa metodologji të miratuar, Komiteti ka kontrolluar vetëm 2 nga 18 IPSH jo publike

Ligji për birësimet parashikon që Komiteti, nëpërmjet Sekretariatit Ekzekutiv, të kryejë kontrolle të vazhdueshme në IPSH – të publike dhe jo publike, për të njohur gjendjen e fëmijëve që plotësojnë kushtet për t’u birësuar.²⁷

Nr.	Institucione	Statusi ²⁸	2019	2020	2021	2022	2023
1	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Tiranë	P	1	4	1		
2	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Durrës	P		1	1		
3	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Shkodër	P		1	1	1	1
4	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Vlorë	P	2	1	2	2	

²⁵ Shkresa nr. 290, prot., date 22.06.2020 “Kërkesë mbi zbatimin e procedurave të birësimit lidhur me evidencat mujore”.

²⁶ Relacion mbi vizitat e realizuara në Institucionet e Përkujdesit Social për Fëmijë, Publike dhe Private në Shkodër”, nr. 543/1, prot., date 20.10.2023.

²⁷ Neni 8, pika 2, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar.

²⁸ Statusi: P = Publike; JP = Jo Publike.

5	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Korçë	P	1	1	2		
6	Shtëpia e Fëmijës 6 – 15 Tiranë	P	1	1	1		1
7	Shtëpia e Fëmijës 6 – 15 Shkodër	P		1	1	1	1
8	Shtëpia e Fëmijës 6 – 15 Sarandë	P	2	1	1	1	
9	Shtëpia e Fëmijës 16 – 18 Shkodër	P		1	1	1	
10	Strehëza për fëmijë pa kujdes prindëror 6 – 18, Shkodër	P					
11	Vatër e Ngrohtë Gjirokastër	JP	1	1	1	1	
12	Komuniteti Papa Giovanni XXIII, Shkodër	JP					1
13	Qendra Kennedy, Korçë	JP	1				

Burimi: KSHB.

Nga tabela më sipër, vërehet se Komiteti ka kryer kontrole në të 10 IPSH – të publike dhe vetëm në 2 IPSH jo publike. Pra, Komiteti nuk ka kryer kontrole në 18 IPSH të tjera jo publike. Sipas Rregullores së Brendshme të Komitetit²⁹, kontrolli në këto institucione kryet me urdhër të Kryetarit të Komitetit, në të cilin përcaktohet, ndër të tjera, objekti i kontrollit, personat që autorizohen për kryerjen e kontrollit, afatet dhe datën e dorëzimit të raportit përfundimtar. Nga evidencat e shqyrtuara në KSHB vërehet se, ky institucion nuk planifikon çdo fillim viti aktivitetin e vet kontrollues të IPSH – ve, duke mos bërë një shpërndarje optimale të burimeve njerëzore e financiare në dispozicion të tij. Planifikimi i aktivitetit kontrollues të IPSH – ve nga Komiteti është i cunguar, pasi në mungesë të Sekretariatit Ekzekutiv nuk kryhet as procesi i verifikimit të raporteve periodike, të paraqitura nga IPSH - të në Komitet, i cili është parakusht për një planifikim të saktë e racional të aktivitetit kontrollues. Mungesa e planifikimit vjetor të kontroleve në IPSH, nuk ka lejuar që ky institucion të kontrollojë me frekuencë të rregullt çdo IPSH publike dhe jo publike, duke mos patur kështu nën vëzhgim të vazhdueshëm situatën e fëmijëve të cilët kanë interesim të vakët apo nuk kanë aspak interesim nga familja biologjike. Kjo situatë u vërejt edhe gjatë një verifikimi të kryer pranë Shtëpisë së Foshnjës “H dhe R” nga ku u evidentua se, regjistri i interesimit plotësohet rregullisht për pjesën e takimeve fizike, por kishte mangësi në pasqyrim sa i takon interesimeve virtuale³⁰ nga familjet biologjike. Sipas stafit të këtij institucioni, interesimet virtuale mbaheshin me procesverbale të veçanta, por nuk pasqyroheshin në regjistër. Gjithashtu në këtë proces, nuk kishte kritere të qartë për të diferencuar interesimin thelbësor nga ai sipërfaqësor nga ana e familjes biologjike, duke mbajtur peng fëmijët në institucione në kushtet kur edhe një telefonatë e vetme mjafton për mos nisjen e procesit të deklarimit të braktisjes nga IPSH.

Nga rishikimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion sa i takon mënyrës dhe hapave të ndjekur për kryerjen e kontrollit mbi IPSH – të publike dhe private u evidentua se mungon në KSHB një metodologji e saktë e miratuar që të udhëheq këtë proces nga fillimi deri në fund. Në veçanti, evidentohet se pavarësisht prezencës së urdhrat të Kryetarit të Komitetit, në të cilin përcaktohet, objekti i kontrollit, personat që autorizohen për kryerjen e kontrollit, afatet dhe datën e dorëzimit të raportit përfundimtar, nga KSHB nuk hartohen gjithmonë raporte përfundimtare, por relacione mbi vizitat e kryera bazuar në procesverbalet e mbajtura në momentin e kryerjes së kontrollit. Mungesa e një metodologjie të saktë e të miratuar nuk i jep procesit tonin dhe rëndësinë e duhur, si dhe nuk lejon një gjurmim të saktë të çështjeve dhe problematikave që evidentohen gjatë kontroleve të kryera nga KSHB. Në veçanti, nga kontrollet e kryera në vitin 2023 mund të veçojmë rastin e kontroleve të kryera në IPSH – të

²⁹ Urdhër nr. 4763/1, date 08.06.2009 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar, neni 15, Kontrolli në Institucionet e Përkujdesit të Fëmijëve

³⁰ Interesimet virtuale kryesisht konsistojnë në telefonata të kryera nga anëtarë të familjes biologjike apo të afërm të tjerë me lidhje gjaku të interesuar për mbarëvajtjen e fëmijës.

publike dhe jo publike në Shkodër, nga ku rezultoi se KSHB cilëson produktin e këtyre kontrolleve “Relacione mbi vizitat e realizuara”³¹.

Procesi i vlerësimit psiko – social të aplikantëve birësues nuk është gjithëpërfshirës.

Aplikantët birësues që dorëzojnë kërkesat për të nisur procesin e birësimit në KSHB i nënshtrohen një procesi verifikimi të përshtatshmërisë së tyre për të qenë prindër birësues. Ky proces ndjek rregullat dhe procedurat e përcaktuara në ligjin për birësimet dhe rregulloren e brendshme të KSHB – së. Sipas rregullave, aplikantët birësues dorëzojnë kërkesën e tyre për të nisur procesin pranë Sekretariatit Ekzekutiv në KSHB, i cili informon, këshillon dhe pranon kërkesën së bashku me dokumentacionin përkatës që aplikantët duhet të dorëzojnë në institucion për të nisur këtë proces. Në vijim të kësaj faze, Sekretariati Ekzekutiv duhet të nisë procesin e vlerësimit të aplikantëve birësues, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit (nëse dokumentacioni është në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullores së brendshme të KSHB – së) e të vijojë me seanca këshillimi e vlerësimi psiko - social të aplikantëve birësues.

Në veçanti procesi i vlerësimit psiko – social ka një rëndësi thelbësore për dhënien e përshtatshmërisë për të birësuar, pasi gjatë këtij procesi analizohen nga punonjësi social dhe psikologu arsyet që motivojnë aplikantët birësues për të nisur këtë proces. Gjithashtu, gjatë këtij procesi vlerësohet në tërësi edhe qëndrueshmëria psiko – sociale e individëve, për të evidentuar që në këtë fazë nëse aplikantët birësues kanë problematika të pa zgjidhura të shëndetit mendor, apo edhe për të verifikuar përkushtimin e tyre ndaj këtij projekti për jetën. Në drejtim të zbulimit të problematikave të padeklaruara (nëpërmjet dokumentacioni të dorëzuar në KSHB) të shëndetit mendor që mund të kenë aplikantët birësues, nuk ka në KSHB udhëzime metodologjike të fushës së psikologjisë apo asaj sociale për të udhëhequr specialistët e fushës gjatë procesit të vlerësimit psikologjik dhe social.

Konkretisht, vlerësimi psiko – social, kryet në KSHB edhe nëpërmjet intervistimit të aplikantëve nga stafi përkatës (punonjës social dhe psikolog) sipas dy formateve të miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit: Aneksi A i cili përmban pyetësonin social të intervistës për vlerësimin e aplikantëve birësues; Aneksi B i cili përmban pyetësonin psikologjik të aplikantëve birësues çift.

Në këto dy anekse parashikohet intervistimi vetëm për aplikantët birësues çift e jo për ato beqar, gjë kjo e cila nuk është në përputhje me parashikimet e kodit të familjes ku thuhet se një fëmijë nuk mund të birësohet nga më shumë se dy persona³², dhe ligjit për birësimet. Gjithashtu, këto anekse nuk kanë të atashuara udhëzime të qarta për mënyrën se si pritet që psikologu apo punonjësi social të kryejë intervistën vlerësuese, si për shembull nëse intervistimi duhet të bëhet për çiftin njëkohësisht apo duhet të bëhet për secilin prej tyre veç e veç. Disa nga praktikatat më të mira të konsultuara në këtë drejtim³³, sugjerojnë që intervistimi i aplikantëve birësues nga ana e specialistëve përkatës mund të kryhet në shumë forma. Aplikantët duhet të intervistohen si çift për të ekzaminuar nga afër përkushtimin, atashimin dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënies martesore për qëllimet e procesit të birësimit, si dhe po kështu duhet të intervistohen edhe veçmas për të kryer edhe një vlerësim më thelbësor individual të secilit aplikant të shkëputur nga çifti. Megjithatë, në praktikën e ndjekur në KSHB për vlerësimet psiko – sociale përmbledhen perceptimet, përjetimet dhe përgjigjet e secilit prej aplikantëve

³¹ Relacion mbi vizitat e realizuara në Institucionet e Përkujdesit Social për Fëmijë, Publike dhe Private në Shkodër”, nr. 543/1, prot., date 20.10.2023.

³² Pra, lejohet birësimi nga individë beqar dhe çifte. Neni 242, Kodi i Familjes “I mituri nuk mund të birësohet nga shumë persona, përveç rastit kur ata janë bashkëshortë. (...)”.

³³ Nisur nga modele të ndryshme të vendeve të tjera procesi i intervistimit sugjerohet të jete individual psikolog - aplikant, qofshin aplikantët çift apo beqarë e në rastin e çifteve psikologu do të zhvillojë dhe takime të alternuara në çift dhe vetëm për vetëm.

<https://cms.barnardos.org.uk/sites/default/files/2021-11/Adopter%20Assessment%20Report%20-%20Preview.pdf>

birësues çift, gjë kjo e cila sugjeron që i kushtohet rëndësi edhe individit gjatë këtij procesi vlerësimi. Nga ana tjetër, nëse i referohemi praktikave më të mira në këtë fushë, evidentohet se vlerësimi i aplikantëve birësues si individ duhet të kryhet në një mënyrë më të thelluar dhe duke ndjekur formate e udhëzime specifike për këtë qëllim.

Nëse thellohem në analizën e përmbajtjes së anekseve, vërejmë se pyetjet që duhet të udhëheqin intervistën, për të eksploruar arsyet që kanë shtyrë aplikantët birësues drejt projektit të birësimit, kanë të bëjnë vetëm me fenomenin e sterilitetit. Pra, që në fillim të vlerësimit përjashtohen arsye të tjera që mund të shtyjnë individët për të nisur këtë proces.

Në praktikën aktuale të ndjekur në KSHB, është evidentuar se disa nga seancat e këshillimit që aplikantët birësues duhet të kryejnë për tu njohur me procesin e birësimit, kryhen njëkohësisht për shumë aplikant birësues e jo veç e veç sipas specifikave të secilit aplikant. Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk ka udhëzime të qarta për mënyrën e zhvillimit të seancave të këshillimit.

Rregullorja e Brendshme e KSHB – së nuk parashikon pjesëmarrjen aktive të psikologut dhe punonjësit social të tij në periudhën e provës kur kryhet atashimi prind – fëmijë.

Pasi aplikantët birësues kalojnë fazën e parë të vlerësimit dhe marrin vendimin e përshtatshmërisë për të birësuar nga Këshilli Drejtues i KSHB – së, sipas rregullave bëhen pjesë e listës së aplikantëve birësues e janë në pritje për të birësuar një fëmijë. Është detyrë e Sekretariatit Ekzekutiv të vlerësojë nëse aplikantët birësues janë prindër të përshtatshëm për ndonjë nga fëmijët në listën e fëmijëve për tu birësuar. Në vijim të këtij vlerësimi nga ana e Sekretariatit, aplikantët birësues njoftohen se ata plotësojnë kushtet për tu bërë prindër të ndonjërit nga fëmijët në listat e KSHB – së. Ata mund të pranojnë apo të refuzojnë propozimin e bërë nga Sekretariati Ekzekutiv. Nëse aplikantët pranojnë, atëherë vijohet me propozimin nga ana e Sekretariatit Ekzekutiv, pranë Këshillit Drejtues të KSHB – së. Më pas, pasi analizon dosjen e aplikantëve birësues, fëmijës dhe relacionin e hartuar nga Sekretariati Ekzekutiv, Këshilli Drejtues merr vendim për pëlqimin e birësimit të fëmijës nga prindërit aplikant. Në këtë vendim përcaktohet edhe kohëzgjatja e periudhës së provës që duhet të bëjnë prindërit birësues për të vendosur marrëdhënien e atashimit me fëmijën.

Menjëherë pas kësaj faze aplikantët birësues pajisen me një autorizim që lejon hyrjen e tyre në institucionin rezidencial ku ndodhet i akomoduar fëmija që do të birësohet, për të nisur periudhën e provës.³⁴

Periudha e provës është shumë e rëndësishme për përfundimin me sukses të procesit të birësimit, pasi ende në këtë fazë nuk është e qartë nëse do të arrihet atashimi i duhur midis fëmijës dhe aplikantëve birësues. Nëse gjatë këtij procesi nuk arrihet të realizohet atashimi, atëherë, struktura përkatëse për çështjet sociale në KSHB, i propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave të nevojshme për shmangien e dështimit të birësimit. Në rast se atashimi arrihet, atëherë, kjo strukturë, harton një raport për përshtatshmërinë e aplikantit birësues me fëmijën. Ky raport paraqitet në gjykatë së bashku me vendimin e dhënies së pëlqimit për birësim lëshuar nga Këshilli Drejtues, e kështu nis faza e fundit e procesit që kulmon me vendimin për birësim nga gjykata kompetente.

Kuptohet qartësisht se përfshirja dhe angazhimi i strukturës përkatëse për çështjet sociale në KSHB, është thelbësor për realizimin me sukses të periudhës së provës. Megjithatë, vërehet se në rregulloren e brendshme të KSHB – së mundojnë dispozita të qarta të cilat të specifikojnë nivelin e përfshirjes së psikologut dhe punonjësit social të KSHB – së gjatë periudhës së provës si dhe nivelin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me stafin psiko – social të

³⁴ Neni 8, pikat 4, 5 dhe 6, Urdhër i Ministrit të Drejtësisë nr. 4763/1, datë 08.06.2009 “Për miratimin e Rregullores së Brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar.

IPSH – së ku është i akomoduar fëmija. Nga intervistat e realizuara në KSHB, evidentohet se psikologu dhe/ose punonjësi social në KSHB jo gjithmonë janë prezent gjatë kryerjes së periudhës së provës. Gjithashtu, edhe për vet mbarëvajtjen e punës dhe daljen e një rezultati sa më të saktë për arritjen apo jo të atashimit midis aplikantëve dhe fëmijëve, nuk planifikohen nga KSHB një numër minimal vizitash që duhet të kryhen me prezencën e detyrueshme të këtyre figurave profesionale. Nga ana tjetër, rezulton se komunikimet me stafin psiko – social të IPSH – ve janë kryesisht informale, nëpërmjet telefonit e jo nëpërmjet rrugëve zyrtare, për ato vizita të aplikantëve gjatë të cilave nuk janë prezent specialistët e KSHB – së.

Në rregulloren e brendshme nuk parashikohet që specialistët e KSHB – së të kryejnë intervista apo takime të tjera të programuara (shitesë) me aplikantët birësues, apo edhe me fëmijët pavarësisht moshës së tyre, me qëllim marrjen e sa më shumë informacioneve për ecurinë e këtij momenti. Po kështu, në këtë drejtim vërehet se nuk ka udhëzime dhe praktika të sakta për mënyrën se si duhet bërë periudha e përshtatshmërisë për grup mosha të tjera me të mëdha ndryshe nga grup mosha 0 - 5, sidomos kur jemi në prezencë të fëmijëve me problematika të shëndetit mendor apo fizik, të cilët nuk mund të shprehin qartësisht pëlqimin e tyre për birësim.

Mbledhjet e Këshilli Drejtues në KSHB nuk diskutojnë në detaj plotësimin e kriterëve të përshtatshmërisë për birësim dhe dhënies së pëlqimit për birësim.

Gjatë këtij auditimi është evidentuar se Këshilli Drejtues i KSHB – së ka patur aktivitet intensiv përgjatë gjithë periudhës 2019 – 2023. Më konkretisht, ky këshill është mbledhur 12 herë në vitin 2019, 10 herë në vitin 2020, 11 herë në vitin 2021, 11 herë në vitin 2022 dhe 11 në vitin 2023. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura gjatë viteve, evidentohet se diskutimet e kryera në këtë këshill në shumicën e rasteve nuk janë të detajuara në drejtim të analizimit të kriterëve që duhet të plotësojnë kandidatët për të marrë përshtatshmërinë. Asnjëherë nuk bëhet analizë sipas çdo kriteri, por më shumë komentohet ngjashmëria e fëmijës me prindërit birësues. Gjatë procesit të dhënies së pëlqimit për birësim në asnjë rast nuk diskutohen në detaj situatat e ndryshme të fëmijëve dhe çifteve, si dhe nuk zgjerohet diskutimi mbi arsyet përse aplikantët birësues janë të përshtatshëm për një fëmijë të caktuar, bazuar në relacionet e përgatitura nga struktura përgjegjëse për çështjet sociale në KSHB.

Po kështu kanë rezultuar disa raste kur është dhënë përshtatshmëria për aplikantët birësues e në vijim po në të njëjtën mbledhje është marrë edhe vendimi për dhënie pëlqimi për birësim. Në disa raste të tjera, në një mbledhje jepet përshtatshmëria për aplikantët birësues e në mbledhjen në vijim (me diferencë një muaj midis mbledhjeve) është dhënë pëlqimi për birësim. Nuk ka gjurmë të tjera që fëmijët e birësuar t'i jenë propozuar aplikantëve të tjerë prezent në listat e KSHB – së.³⁵

Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve nuk ka nënshkruar marrëveshje me Autoritetet Qendrore dhe me agjencitë ndërmjetësuese të huaja.

Në rastin e birësimeve ndërvendase, ligji për birësimet specifikon se, Kryetari i KSHB – së nënshkruan marrëveshje me institucione analoge jashtë vendit, me agjenci vendase³⁶ dhe të huaja, që ndërmjetësojnë në fushën e birësimit³⁷. Nga shqyrtimi i praktikave të ndjekura në KSHB në vite nuk kanë rezultuar marrëveshje të nënshkruara me autoritetet qendrore me të cilat KSHB bashkëpunon, si për shembull në rastin e Autoritetit Qendror Francez, Grek, dhe atij të Maqedonisë së Veriut, me të cilët KSHB ka pasur bashkëpunim vitet e fundit. Vetë

³⁵ Procesverbal nr. 495/3, datë 27.07.2020, Rasti i një çifti aplikant birësues që kanë marrë ri përshtatshmërinë gjatë kësaj mbledhjeje dhe po gjatë kësaj mbledhjeje është marrë edhe vendimi për dhënie pëlqimi për birësim vendas. Procesverbal nr. 317/1, datë 25.07.2019, i jepet përshtatshmëria për birësim çiftit të aplikantëve birësues, ndërsa me procesverbalin nr. 354/1, datë 29.08.2019 u jepet pëlqimi për birësim i një fëmije (diferencë një muaj).

³⁶ Në vendin tone nuk ka agjenci ndërmjetësuese vendase në fushën e birësimit.

³⁷ Neni 11, germa d, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar”.

Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin Ndërvendas³⁸, në tërësinë e saj thekson pikërisht detyrimin për bashkëpunim midis autoriteteve qendrore dhe enteve të autorizuar për të kryer funksionin e ndërmjetësimit në fushën e birësimit. Pikërisht në zbatim të kësaj konvente, ligji për birësimet në vendin tonë, parashikon që bashkëpunimi midis autoriteteve dhe enteve të autorizuar prej tyre, duhet të kryhet nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve përkatëse me KSHB – në, që është dhe autoriteti i vetëm në vendin tonë për tu marrë me çështjet e birësimit.

Megjithatë, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, ka rezultuar se KSHB ka nënshkruar disa marrëveshje me agjenci ndërmjetësuese të huaja si më poshtë:

- Marrëveshje ndërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe Shoqatës Italiane “Amici dei Bambini (AiBI)”, nënshkruar më datë 08.09.2009;
- Marrëveshje ndërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe Komunitetit Sant’ Egidio (Itali)³⁹.

Gjatë auditimit rezultoi se praktika e nënshkrimit të marrëveshjeve me agjencitë ndërmjetësuese të huaja ndiqej në KSHB para se të miratohej vendimi i Këshillit të Ministrave për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja⁴⁰, i cili në vijim u ngarkua me kryerjen e procesit të njohjes e miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja mbështetur në ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet⁴¹ dhe ligjit për birësimin. Në vijim të miratimit të këtij vendimi, nuk rezultojnë të jenë nënshkruar më marrëveshje midis agjencive ndërmjetësuese të huaja me KSHB – në.

Me hyrjen në fuqi të vendimit për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja (më tej KMANH) në vitin 2011, u plotësua kuadri nënligjor që duhet të rregullonte procesin e njohjes dhe miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja në vendin tonë.⁴²

Më konkretisht, nga shqyrtimi i kombinuar i akteve në fuqi⁴³ në këtë fushë, rezulton se lejimi i ushtrimit të funksionit të ndërmjetësimit në fushën e birësimit duhet të plotësojë dy parakushte. **Së pari**, agjencia ndërmjetësuese duhet të licencohet në përputhje me legjislacionin për licencat në vendin tonë.⁴⁴ Procesi i licencimit të agjenci e ndërmjetësuese kryet nga Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja.⁴⁵

Së dyti, pasi përfundon procesi i njohjes dhe licencimit të agjencisë ndërmjetësuese në vendin tonë, KSHB duhet të nënshkruajë marrëveshje me agjencitë e licencuara me qëllim që:

- ato të ndjekin vetëm qëllime jofitimprurëse, sipas kushteve të përcaktuara nga Komiteti⁴⁶;
- të nxitet bashkëpunimi me to;

38 Neni 7, Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin Ndërvendas.

39 Dokumenti i vendosur në dispozicion nga KSHB nuk kishte datë e firmë.

40 VKM nr. 399, datë 01.06.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të huaja”.

41 Ligj nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

42 Neni 33, Agjencitë ndërmjetësuese në fushën e birësimit: “2. Agjencitë ndërmjetësuese të huaja njihen dhe miratohen nga komisioni i miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për një afat 5-vjeçar për ushtrimin e veprimtarisë në këtë fushë, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Përbërja dhe rregullat e funksionimit të komisionit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. (...)”

43 Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin në lidhje me Birësimin Ndërvendas; Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar”; Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 399, datë 01.06.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”.

44 Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

45 Neni 33, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 399, datë 01.06.2011 “Për përbërjen dhe rregullat e funksionimit të Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”

46 Neni 33, paragrafi 3, germa a), Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar.

- të përcaktohen rregullat dhe mënyra e miratimit të veprimtarisë së tyre në vendin tonë, si dhe kushtet që duhet të zbatohen në prodhimin e informacioneve pas birësimit;
- të përcaktohet mënyra se si KSHB do të informohet mbi veprimtarinë e tyre në vendin tonë;
- të përcaktohet mënyra, afatet dhe metodologjia me anë të së cilës KSHB do të ushtrojë kontrole në këto subjekte, për të verifikuar nëse ato kanë kryer shkelje të detyrimeve ligjore;
- të përcaktohet lloji i masave administrative që KSHB mund të propozojë në rast se konstaton shkelje të detyrimeve ligjore nga ana e tyre.⁴⁷

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga KSHB, për periudhën 2019 - 2023 janë kryer në total **40** birësime ndërvendase, nga të cilat **32** birësime ndërvendase me ndërmjetësim të agjencive dhe **8** me autoritete qendrore si më poshtë:

Viti	Nr. Birësimesh me Agjenci	Nr. Birësimesh nga Autoritetet Qendrore
2019	5	1
2020	5	3
2021	7	1
2022	8	3
2023	8	0
Total	32	8

Burimi: KSHB.

Pas hyrjes në fuqi të VKM – së nr. 399 në vitin 2011, e duke filluar nga viti 2013⁴⁸, KSHB ka punuar me agjencitë ndërmjetësuese të licencuara: B; N; A; (S.P.A.I.); Comunita' Sant'Egidio; AiBi.

Për periudhën 2019 – 2023, nga **32** birësimet ndërvendase me agjenci ndërmjetësuese, 12 janë kryer me ndërmjetësimin e agjencisë N, 6 me ndërmjetësim të agjencisë A, 5 me ndërmjetësim të S.P.A.I, 5 me ndërmjetësim të agjencisë S' E dhe 4 me ndërmjetësim të agjencisë AiBi përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabelë

Nr	Emërtimi i Agjencisë	Nr. Birësimesh
1	N	12
2	A	6
3	(S.P.A.I.)	5
4	C S'E	5
5	(AiBi)	4
Total		32

Burimi: KSHB.

Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja nuk është mbledhur në Ministrinë e Drejtësisë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Kryerja e procesit të njohjes, miratimit dhe licencimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja në vendin tonë kryhet nga Komisioni ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë sipas përcaktimeve të VKM nr. 399 (cituar më sipër). Pra, ai mblidhet, me kërkesë të Kryetarit të tij, sa herë informohet nga Sekretari, për paraqitjen pranë MD – së të maksimumi 5 kërkesave të reja për licencim në fushën e birësimit, brenda 10 ditëve nga ardhja e kërkesës.

⁴⁷ Neni 9, “Detyrat e këshillit drejtues të Komitetit”, Ligji nr.. 9695, datë 19.03.2009 ‘Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit’, i ndryshuar.

⁴⁸ Në këtë vit janë kryer licencimet e para të agjencive ndërmjetësuese të huaja në vendin tonë.

Sikurse është shpjeguar shkurtimisht më sipër⁴⁹, Komisioni është mbledhur për herë të parë më datë 01.10.2012⁵⁰ e në vitin 2013 janë licencuar agjencitë e para për një periudhë 5 vjeçare sipas kërkesave të VKM – së, të cilat kanë qenë: B; N; AW; S.P.A.I.; C’ S’E; AiBi.

Nr.	Emërtimi i Agjencisë	Periudha e vlefshmërisë	Numri i Vendimit të KMANH
1	Nightlight	5 vjet	nr. 8, datë 19.02.2014
2	AdoptionWorx	5 vjet	nr. 6, datë 08.09.2014
3	Servizio Polifunzionale per l’Adozione Internazionale (S.P.A.I.)	5 vjet	nr. 1, datë 22.05.2013
4	Sant’Egidio	5 vjet	nr. 3, datë 21.10.2013
5	Amici dei Bambini (AiBi)	5 vjet	nr. 1, datë 22.05.2013
6	Bethany	5 vjet	Nuk gjendet në dosje

Burimi: KSHB.

Pra, më konkretisht, në përfundim të procesit të njohjes, miratimit dhe licencimit këto agjenci kanë ushtruar aktivitetin e tyre të ndërmjetësimit në fushën e birësimit në periudhat si më poshtë:

- NA licencuar me Vendimin nr. 8, datë 19.02.2014, ku licençohet për një periudhë 5 vjeçare nga data 08.09.2014 – 08.09.2019.
- A licencuar me Vendim nr. 6, datë 08.09.2014, ku licençohet për një periudhë 5 vjeçare nga data 08.09.2014 – 08.09.2019.
- SPAI licencuar me Vendim nr. 1, datë 22.05.2013, ku licençohet për një periudhë 5 vjeçare nga data 22.05.2013 – 22.05.2018.
- (AIBI) licencuar me Vendimin nr. 1 datë 22.05.2013 ku licençohet për një periudhë 5 vjeçare nga data 22.05.2013 – 22.05.2018.
- Sh S – B në lidhje me këtë subjekt në dosje nuk është administruar vendimi dhe as licenca e vjetër me anë të së cilës ka ushtruar veprimtarinë në Shqipëri.
- C’ S’E licencuar me Vendim nr. 3, datë 21.10.2013, ku licençohet për një periudhë 5 vjeçare nga data 21.10.2013 – 21.10.2018.

Në përfundim të periudhës 5 vjeçare të vlefshmërisë së licencimit, këto agjenci kanë paraqitur kërkesat e tyre pranë KSHB – së⁵¹ për t’iu nënshtruar përsëri kësaj procedure në datat si më poshtë:

1. A W ka paraqitur kërkesën në datën 26.05.2020
2. SPAI ka paraqitur kërkesën në datën 02.06.2020
3. CS E ka paraqitur kërkesën në datën 21.02.2020
4. AIBI ka paraqitur kërkesën në datën 28.06.2018.
5. Ni ka paraqitur kërkesën në datën 01.06.2021
6. Be ka paraqitur kërkesën në datën 20.06.2019

Sikurse vërehet nga më sipër të gjitha agjencitë e kanë paraqitur kërkesën e tyre për licencim mesatarisht mbas një viti nga përfundimi i saj, me përjashtim të agjencisë Ai.Bi e cila e ka paraqitur pas një muaji.

Edhe pse kërkesat për licencim të agjencive ndërmjetësuese të huaja datojnë nga viti 2018, Komisioni nuk është mbledhur deri më datë 31.12.2020⁵². Nga ana e tij, KSHB i është drejtuar

⁴⁹ Ref. shënim në fund të faqes me nr. 26.

⁵⁰ Procesverbal i mbledhjes nr. 1, prot., datë 01.10.2012.

⁵¹ VKM nr. 399, datë 01.06.2011, Kreu III, paragrafi 3. Dorëzimi i formularit dhe dokumentacionit është bërë pranë KSHB – së, ndërkohë që VKM – ja përcakton se ky formular duhet të dorëzohet pranë Komisionit.

⁵² Procesverbal i mbledhjes nr. 8059/2, prot., datë 31.12.2020. Në këtë datë ky Komision është mbledhur në bazë të urdhrat të Ministrit të Drejtësisë nr. 435, datë 29.12.2020 “Për përbërjen dhe funksionimin e Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja”.

zyrtarisht disa herë gjatë vitit 2019 MD – së për mbledhjen e Komisionit dhe nisjen e procedurave të licencimit të agjencive ndërmjetësuese.⁵³

Komisioni është mbledhur përsëri edhe 2 herë të tjera në vitin 2021 më datë 19.02.2021⁵⁴ dhe 05.10.2021⁵⁵. Gjatë këtyre mbledhjeve është diskutuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga agjencitë ndërmjetësuese si dhe është miratuar licencimi për 5 nga 6 agjencive cituar si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i Agjencisë	Statusi Miratuar/Refuzuar	Numri i licencës së re
1	N	Miratuar me Vendimin. nr. 24, datë 07.10.2021	Nuk gjendet në dosjet depozituar në KSHB
2	AW	Miratuar me Vendimin. nr. 7, datë 26.02.2021	Nuk gjendet në dosjet depozituar në KSHB
3	(S.P.A.I.)	Miratuar me Vendimin. nr. 8, datë 26.02.2021	Nuk gjendet në dosjet depozituar në KSHB
4	S E	Miratuar me Vendimin. nr. 9, datë 26.02.2021	Nuk gjendet në dosjet depozituar në KSHB
5	(AiBi)	Miratuar me Vendimin. nr. 10, datë 26.02.2021	Nuk gjendet në dosjet depozituar në KSHB
6	Be	Refuzuar me Vendimin. nr. 11, datë 26.02.2021	

Burimi: KSHB.

Në dosjet e agjencive të administruara në KSHB, nuk ishin licencat e reja të agjencive ndërmjetësuese të huaja, por u vendosen në dispozicion nga Komisioni vetëm licencat e agjencive: A; S. P. A. I.; C S E e jo të agjencive të tjera. Megjithatë, nëse krahasojmë informacionet e paraqitura në to, me licencat e vjetra, vërejmë se është përdorur i njëjti format, por nuk janë prezent të njëjtët elementë, sidomos në licencat e reja ku nuk paraqitet numri që i jepet atyre në regjistër. Nga ana tjetër, nuk kemi informacion për miratimin e formatit të përdorur.

Nga një verifikim i kryer në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit për të evidentuar nëse licencat e lëshuara nga Komisioni janë publikuar në QKB në seksionin “Licenca të lëshuara jashtë QKB – së”, ka rezultuar se nuk janë bërë publikimet përkatëse për licencat e lëshuara në vitin 2021⁵⁶. Komisioni ka pasur korrespondencë me Qendrën Kombëtare të Biznesit për këtë qëllim, nga ku evidentohet se për licencat e lëshuara jashtë QKB – së, institucionet përkatëse kanë akses të drejtpërdrejtë në regjistrin e QKB – së për të bërë publikimet.⁵⁷ Për këto arsye, QKB i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë për të vijuar me përcaktimin e saktë të subjekteve që ka licencuar dhe publikimin e licencave të tyre. Nga ana e Komisionit dhe MD – së nuk janë ndërmarrë hapa të tjerë për të vijuar me publikimin e tyre.

KSHB ka vijuar të kryejë procedura birësimi me agjencitë ndërmjetësuese të huaja edhe pas përfundimit të vlefshmërisë së licencave të tyre.

Sipas ligjit për birësimet, veprimtaria e agjencisë birësuese mbaron kur mbaron afati për të cilin është dhënë licenca. Në praktikë, veprimtaria e këtyre agjencive në vendin tonë nuk ka ndalur në periudhën 2018/19 – e deri në 26.02.2021/07.10.2021, kur për këto agjenci është marrë

⁵³ Shkresat nr. 433, datë 08.09.2019, nr. 511, datë 08.11.2019, nr. 547, datë 25.11.2019.

⁵⁴ Procesverbali i mbledhjes nr. 1053, prot., datë 19.02.2021.

⁵⁵ Procesverbali i mbledhjes nr. 3446/3, prot., datë 05.10.2021.

⁵⁶ Rezultojnë pjesërisht të publikuara disa të dhëna për licencat që u ka mbaruar afati: 1. SPAI, publikuar licenca e vitit 2013, por nuk është hedhur në sistem kopje e saj; 2. AiBi, publikuar licenca e vitit 2013, por nuk është hedhur në sistem kopje e saj; 3. Comunita’ Sant’Egidio, publikuar licenca e vitit 2013, por nuk është hedhur në sistem kopje e saj.

⁵⁷ Shkresa e Qendrës Kombëtare të Biznesit drejtuar Ministrisë së Drejtësisë nr. 3568/1, prot., datë 07.05.2021 “Kthim Përgjigje”.

vendimi për t'u licencuar. KSHB ka vijuar të mbajë marrëdhënie normale me to edhe gjatë kësaj periudhe.

Nga sa më sipër kuptohet se kanë ushtruar veprimtari në vendin tonë pa licencë agjencitë si më poshtë:

- NA nga data 08.09.2019 në datën 07.10.2021, me ndërmjetësimin e së cilës është birësuar 1 fëmijë;
- A nga data 08.09.2019 në datën 26.02.2021, me ndërmjetësimin e së cilës janë birësuar 5 fëmijë;
- SPAI nga data 22.05.2018 në datën 26.02.2021, me ndërmjetësimin e së cilës është birësuar 1 fëmijë;
- (AIBI) nga data 22.05.2018 në datën 26.02.2021, me ndërmjetësimin e së cilës është birësuar 1 fëmijë;
- CSE nga data 21.10.2018 në datën 26.02.2021, me ndërmjetësimin e së cilës është birësuar 1 fëmijë.
- Sh S – B në lidhje me këtë subjekt në dosje nuk është administruar vendimi dhe as licenca e vjetër me anë të së cilës ka ushtruar veprimtarinë në Shqipëri.

KSHB nuk ka mbikëqyrur veprimtarinë e agjencive ndërmjetësuese të huaja në vendin tonë.

Sipas ligjit për birësimet, veprimtaria e agjencive ndërmjetësuese të huaja mbikëqyret nga Sekretariati Ekzekutiv i KSHB – së sa i takon përbërjes, funksionimit dhe gjendjes së tyre financiare.⁵⁸ Në përditshmërinë e punës së kryer në KSHB, ka rezultuar se ky institucion nuk ka ushtruar asnjëherë mbikëqyrje të veprimtarisë së këtyre agjencive në vendin tonë.

Më konkretisht, komunikimi midis KSHB – së dhe agjencive ndërmjetësuese mbahet nëpërmjet përfaqësuesit të tyre ligjor në Shqipëri. Marrëdhënia dypalëshe shtjellohet në takime formale dhe informale në zyrat e KSHB. Takimet organizohen sa herë që KSHB ka raste të fëmijëve të refuzuar nga çiftet shqiptare për arsye të përkatësisë etnike (rome/egjiptiane) apo për probleme shëndetësore të evidentuara në kartelën shëndetësore të fëmijës. Në këto raste KSHB kërkon ndihmë këtyre agjencive për birësim jashtë vendit nga aplikantët birësues që agjencitë kanë në listat e tyre. Në rastet kur nuk ka asnjë aplikant birësues shqiptar të interesuar për fëmijën, agjencitë e shpallin rastin në faqen e tyre zyrtare online (duke ruajtur anonimat) dhe aplikantët birësues të interesuar shprehin interesin e më tej vazhdojnë procedurat.⁵⁹

Mbikëqyrja që duhet të ushtrojë KSHB ndaj këtyre subjekteve është shumë e rëndësishme pasi, i vetmi institucion që ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me to është pikërisht KSHB. Çka do të thotë që, në vijim të ushtrimit të funksionit mbikëqyrës nga KSHB, mund të rezultojnë problematika apo çështje që kërkojnë adresim në instanca edhe më të larta. Në mungesë të kësaj mbikëqyrjeje nga KSHB, është e qartë se raportimi që duhet të bëjë Kryetari i KSHB – së pranë Ministrisë të Drejtësisë rezulton i cunguar, pasi ky detyrim ligjor nuk është përmbushur. Gjithashtu, edhe vet Këshilli Drejtues nuk është informuar nëpërmjet rezultateve të mbikëqyrjes së ushtruar nga KSHB në këto subjekte.

Në mungesë të mbikëqyrjes nuk janë analizuar ndonjëherë në KSHB apo edhe në instanca të tjera nëse këto agjenci kanë shkelur ndonjë nga kërkesat e ligjit⁶⁰, qoftë të ligjit për birësimet apo ligjeve dhe akteve nënligjore të tjera që rregullojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë. Shkelja e kërkesave të ligjit përbën parakusht për revokimin e licencës së këtyre agjencive.

⁵⁸ Neni 13, pika 12, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 'Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit', i ndryshuar

⁵⁹ Përgjigje e KSHB – së, Pyetësori i datës 18.01.2024.

⁶⁰ Neni 35, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2009 'Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit', i ndryshuar.

Agjencitë ndërmjetësuese të huaja të licencuara të cilat ushtrojnë veprimtari në vendin tonë janë organizata jo fitimprurëse. Ato regjistrohen si të tilla në Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pranë Zyrës së Regjistrimit të OJF – ve⁶¹, si edhe pranë organeve tatimore përkatëse. Çdo OJF – që kryen regjistrimin fillestar, ka detyrimin që të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese që depozitohen në regjistrin elektronik/regjistrimin fillestar.⁶²

Në këtë drejtim, në dosjet e agjencive ndërmjetësuese depozituar në KSHB për kryerjen e njohjes, miratimit dhe licencimit të tyre gjenden Vendimet e Gjykatës për themelimin e tyre, të shoqëruara edhe ndryshimet përkatëse në disa raste. Pavarësisht kësaj, KSHB nuk i është drejtuar asnjëherë as Gjykatës së Tiranës e as organeve tatimore për të marrë informacion verifikues ndaj informacioneve të dërguara nga agjencitë mbi përbërjen, funksionimit dhe gjendjes së tyre financiare (nëse këto janë apo jo aktive bazuar edhe në NIPT – et e tyre).

Regjistri i agjencive të licencuara nuk është mbajtur në përputhje me kërkesat e urdhrin të Ministrit të Drejtësisë

Në vijim të njohjes, miratimit dhe licencimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja, të dhënat mbi to dhe licencat e lëshuara për të ushtruar funksionet e ndërmjetësimit në fushën e birësimeve, duhet të hidhen në një regjistër të posaçëm i cili duhet të mbahet dhe të administrohet në Ministrinë e Drejtësisë në përputhje me ligjin për birësimet, VKM nr. 399 (cituar më sipër) dhe urdhrin përkatës të Ministri të Drejtësisë⁶³ ku edhe përcaktohet formati sipas së cilit duhet mbajtur regjistri. Për mbajtjen e këtij regjistri duhet të caktohet një person përgjegjës. Nga përgjigjet e pyetësorëve dhe dokumentacioni i vendosur në dispozicion nuk ka gjurmë të caktimit të personit përgjegjës për regjistrin dhe mbajtjen e tij duke filluar nga viti 2011 kur ka hyrë në fuqi VKM nr. 399, ose të paktën nga viti 2013 kur janë kryer njohjet, miratimet dhe licencimet e para në këtë fushë.

Në praktikën e ndjekur deri më tani ka rezultuar se, nuk është respektuar formati i miratuar me urdhrin e ministrit; regjistri nuk është historik, e nuk pasqyron të gjitha licencimet nga momenti i nisjes së këtij procesi nga Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja; personi përgjegjës i përcaktuar për mbajtjen e regjistrit nuk kishte dijeni për të dhe nuk e ka administruar asnjëherë⁶⁴.

Ministria e Drejtësisë nuk ka mbikëqyrur veprimtarinë e KSHB – së në vite

Komiteti Shqiptar i Birësimeve, si institucion varësie i Ministrisë së Drejtësisë, duhet të jetë mbikëqyrjen e vazhdueshme të kësaj ministrie. Mbikëqyrja nga institucioni epror mund të ketë natyrë të ndryshme. Në rastin konkret, MD ka audituar Komitetin, por vetëm nga këndvështrimi financiar dhe ai i përputhshmërisë, duke mos u marrë me auditimin e aktivitetit kyç për të cilin është krijuar ky institucion, procesi i birësimit. Kjo ministri në marrëdhëniet dypalëshe me KSHB – në është mjaftuar vetëm me raportimet që KSHB duhet të bëjë në zbatim të ligjit për birësimet. Drejtoria e Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të

⁶¹ Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse” (shfuqizuar); Ligji nr. 8789, datë 7.5.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse” (shfuqizuar); Ligji nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

⁶² Neni 17, Ligji nr. 80/2021 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”.

⁶³ Urdhër, nr. 284, datë 28.6.2013 “Për Krijimin e Regjistrit për Depozitimin e të Dhënave për Agjencitë Ndërmjetësuese të Huaja, të Licencuara për Ushtrimin e Veprimtarisë në Fushën e Birësimit”.

⁶⁴ Urdhër nr. 435, datë 29.12.2020 “Për disa ndryshime në Urdhrin n. 7056/3, date 03.12.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për ngritjen e Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja” dhe për disa ndryshime të Urdhrit nr. 299, date 13.05.2019”.

Varësisë, nëpërmjet Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në fushën civile⁶⁵, nuk ka kryer monitorime të veprimtarisë së KSHB – së.

Megjithatë, në vitin 2019, Ministria e Drejtësisë ka kryer nëpërmjet Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit⁶⁶, një hetim administrativ, i cili është iniciuar në bazë të një ankese administruar në MD.

5.2.1 Mbi rastin e të miturës LH(EG), birësuar nga LH dhe rikthyer përsëri në institucionin rezidencial Shtëpia e Foshnjës 0 – 5, Shkodër.

Në zbatim shkresave nr. 762/13, 14, 15, prot., datë 18.06.2024 “Njoftim për shtesë afati të auditimit dhe subjekteve në auditimin e performancës me temë “Procesi i birësimit për mirëritje dhe edukim”, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar auditimin e performancës, pranë Komitetit Shqiptar të Birësimit, Ministrisë së Drejtësisë, Bashkisë Fier dhe Shtëpisë së Foshnjës 0 – 5 vjeç Shkodër, pasi në median audio vizive është pasqyruar gjerësisht rasti i të miturës LH(EG), birësuar nga zonja LH me vendbanim në Fier, e marrë në mbrojtje nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës e Bashkisë Fier dhe rikthyer përsëri në institucionin rezidencial Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 vjeç, Shkodër. Për këtë arsye, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar auditimin e performancës të sipërcituar duke kryer verifikimet përkatëse sa i takon procesit të ndjekur për dhënien në birësim të fëmijës në fjalë, monitorimin e ecurisë pas birësuese si dhe shkaqet dhe problematikat që kanë sjellë marrjen në mbrojtje të fëmijës dhe nisjen përsëri të procesit të deklaramentit të braktisjes së të miturës.

Nisur nga sa më lart, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga subjektet e auditimit dhe përgjigjet e pyetësorëve të dërguar prej tyre është konstatuar sa më poshtë:

Historiku i përmbledhur i ngjarjes

Data	Ngjarja
30.12.2018	Në maternitetin e Shkodrës lind e mitura EG nga nëna biologjike MG
16.01.2019	EG akomodohet në Shtëpinë e Foshnjës 0 – 5 Shkodër (sipas procesverbalit nr. 1, prot., datë 16.01.2019), pasi nëna biologjike e të miturës është diagnostikuar me çrregullime skicofrenie rezistente dhe është vendosur pranë shërbimit komunitar të shëndetit mendor Shkodër.
27.06.2019	Shërbimi Social Shtetëror komisionin sistemimin e përhershëm të fëmijës në institucion me shkresën nr. 1039, pro., datë 27.06.2019.
22.02.2021	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 164 (1073), datë 22.02.2021 i heq nënës biologjike (MG) përgjegjësinë prindërore.
07.12.2021	Vendimin nr. 164 (1073), datë 22.02.2021 merr formën e prerë.
29.12.2021	LH paraqet kërkesën në KSHB për të birësuar një fëmijë të seksit femër mundësisht rreth moshës 8 - 12 vjeç.
28.02.2022	Specialistët e KSHB – së kryejnë vizitën në banesën e aplikantes birësuese për të verifikuar kushtet dhe komfortet familjare (shkresa nr. 50/4, datë 31.03.2022).
16.03.2022	Psikologjia e KSHB – së realizon intervistën mbi të cilën është hartuar Studimi Psikologjik i aplikantes LH (shkresa nr. 50, prot., datë 31.03.2022).
23.03.2022	Specialisti psiko – social i KSHB – së realizon intervistë me aplikanten birësuese (shkresa nr. 50/3, prot., datë 31.03.2022).

⁶⁵ Urdhër nr. 116, date 30.03.2022 “Për Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë”.

⁶⁶ Hetim administrativ ushtruar në zbatim të urdhrit të MD nr. 552 datë 06.12.2019 “Për kryerjen e hetimit administrativ pranë komitetit Shqiptar të Birësimit”.

11.11.2022	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 746 (4713), datë 11.11.2022 shpall braktisjen e fëmijës EG.
30.12.2022	Vendimi i gjykatës për shpalljen e braktisjes merr formën e prerë.
28.04.2022	Këshilli Drejtues diskuton dhënien e përshtatshmërisë aplikantes LH(procesverbali i mbledhjes me nr. 272/3, port., datë 28.04.2022).
28.04.2022	Këshilli Drejtues i KSHB – së jep përshtatshmërinë për birësim znj. LH me Vendimin nr. 32, datë 28.04.2022 (me nr. 278, prot., datë 28.04.2023)
31.05.2023	Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 Shkodër dërgon dosjen e fëmijës në KSHB me shkresën nr. 39, prot., datë 31.05.2023.
29.06.2023	Këshilli Drejtues i KSHB – së diskuton dhënien e pëlqimit për birësim të miturës zonjës LH.
29.06.2023	Këshilli Drejtues i KSHB – së me Vendimin nr. 35, datë 29.06.2023 (me nr. 367, prot., datë 29.06.2023) vendos për dhënien e pëlqimit për birësimin e të miturës EG nga znj. LH, duke përcaktuar periudhën e provës për të verifikuar atashimin prind - fëmijë 2 javë.
05.07.2023 – 12.07.2023	Sipas të dhënave të Shtëpisë së Foshnjës Shkodër nëna birësuese akomodohet në Shkodër dhe nis periudhën e provës/atashimit me fëmijën.
13.07.2023	Psikologjia e KSHB – së harton Relacionin mbi ecurinë e periudhës së provës për përshtatshmërinë e të miturës EG me aplikanten birësuese znj. LH(me shkresën nr. 414, port., datë 13.07.2023). Periudha e provës vlerësohet pozitivisht.
12.07.2023 – 29.09.2023	Nëna birësuese mban kontakte telefonike me video call dhe kontakte jo shumë të shpeshta fizike me të miturën, në pritje të vendimit të gjykatës për birësimin e vajzës.
29.09.2023	Gjykata e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier merr Vendimin nr. 62 – 2003 – 3636 (573), datë 29.09.2023 duke përfunduar procesin e birësimit të së mitur nga nëna birësuese.
17.10.2023	Vendimi merr formë të prerë e nga ky moment fëmija akomodohet tek nëna birësuese
02.11.2023	Komiteti Shqiptar i Birësimeve Nënshkruan Marrëveshjen me Prindin birësuese për periudhën pas birësuese (nr. 448/8, prot., datë 02.11.2023)
28.11.2023	Nëna birësuese nëpërmjet mesazheve audio dhe video drejtuar Drejtoreshës së Shtëpisë së Foshnjës Shkodër referon se po haste probleme në prindërim dhe kërkon të kthejë fëmijën në institucion.
28.11.2023 – 29.04.2023	Nëna birësuese mban kontakte telefonike të vazhdueshme me KSHB – në dhe Shtëpinë e Foshnjës, duke dërguar mesazhe audio dhe video për sjelljen e vajzës.
29.04.2024	KSHB kryen vizitën e parë pas birësuese pranë shtëpisë së nënës birësuese për të parë ecurinë e birësimit.
10.05.2024	Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës së Bashkisë Fier i referohet rasti nga Drejtuesja dhe stafi i kopshtit publik që frekuenton e mitura.
13.05.2024	E mitura merret në mbrojtje me Vendimin nr. 5264, datë 13.05.2024 duke e transferuar përsëri në institucionin rezidencial Shtëpia e Foshnjës Shkodër.

KSHB nuk ka reaguar në kohë për të analizuar ecurinë pas birësuese të së miturës me nënën birësuese.

Këshilli Drejtues i KSHB – së ka vendosur për dhënien e fëmijës EG në birësim znj. LH me Vendimin nr. 35, datë 29.06.2023, duke përcaktuar edhe periudhën 2 javore të provës për të analizuar atashimin prind fëmijë. Në vijim të këtij vendimi, dosja e birësimit ka kaluar në

Gjykatën e Shkallës së parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, e cila ka marrë Vendimin nr. 62 – 2003 – 3636 (573), datë 29.09.2023 duke përfunduar procesin e birësimit të së mitur nga nëna birësuese. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 17.10.2023, e nga ky moment fëmija është bërë ligjërisht fëmijë i nënës birësuese. Në vijim të këtij vendimi fëmijës EG i ndryshohet emri në LH dhe nëna birësuese është tashmë para ligjit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet si një nëne biologjike.

Referuar përgjigjeve të marra nga Drejtoresha e Shtëpisë së Foshnjës Shkodër ka rezultuar se që në fillimet e periudhës pas birësuese nëna ka patur probleme të ndryshme në menaxhimin e situatës. Më konkretisht, kanë kaluar vetëm dy muaj nga momenti i birësimit kur nëna birësuese i ka referuar problemet që po haste në prindërim Drejtoreshës dhe punonjësës sociale të Shtëpisë së Foshnjës Shkodër, nëpërmjet mesazheve me audio/video dhe tekst në whatsapp. Në datë 28.11.2023, nëna birësuese ka dërguar një audio në whatsapp ku ka referuar që për shkak të sjelljeve problematike të së miturës nuk mund të kujdeset më për të dhe kërkon që ta rikthejë në institucion. Përpara kësaj date, nëna birësuese ka shprehur gjatë komunikimeve që po “bezdiset” nga sjelljet e të miturës të tilla si eksplorimi i ambienteve të reja, prekja e orendive të shtëpisë, apo urinimi i pavullnetshëm natën në disa raste. Duke nisur nga ky moment, Drejtoresha e Shtëpisë së Foshnjës ka komunikuar direkt me zonjën L për të kuptuar më shumë dinamikat dhe për të ofruar suport. Gjithashtu ka njoftuar dhe Kryetaren e KSHB – së për situatën, që i ka referuar të ketë marrë kontakte me nënën birësuese.

Nga ky moment, edhe KSHB ka vijuar të ketë komunikime telefonike me zonjën, e cila sipas stafit të KSHB – së shfaqet e paqëndrueshme në reagimet e saj sa i takon marrëdhënies me vajzën. Sipas përgjigjeve të dhëna nga KSHB, gjatë kësaj periudhe kur ka patur vetëm komunikim telefonik me nënën birësuese, ajo ka qenë vazhdimisht e lëkundur në pozicionin e saj ndaj fëmijës. Ajo ka dërguar në adresë të KSHB video dhe mesazhe kontradiktore, një herë video pozitive dhe një herë video me mesazhe negative. Sipas KSHB – së, komunikimet telefonike të Kryetares apo stafit me nënën kanë ndikuar në përmirësimin e situatës dhe në marrëdhënien e nënës me vajzën, por pas disa javësh problemet kanë rinisur. KSHB shprehet se është tentuar gjithmonë këshillimi i nënës për prindërimin dhe rëndësinë që ka komunikimi dhe shfaqja e dashurisë, por edhe takti në komunikimin me fëmijën. Është theksuar se dashuria për vajzën nuk tregohet duke i plotësuar dëshirat materiale por, duke i dhënë dashuri. Kjo ka qenë fryma e bisedave pa fund me nënën birësuese.

Duke nisur nga fundi i nëntorit 2023, kur sipas evidencave, KSHB ka marrë dijeni për situatën me të miturën e birësuar, **nga ky institucion nuk është marrë asnjë masë për të nisur një monitorim të situatës pas birësuese të vajzës në shtëpinë e nënës birësuese. KSHB, gjatë kësaj periudhe është mjaftuar vetëm me komunikimet telefonike, mesazhet dhe videot në whatsapp.**

Sipas Kryetares së KSHB – së, institucioni nuk ka tagrin ligjor për të nisur monitorimin pas birësues pa u mbushur afati 6 muaj nga momenti i birësimit. Lidhur me këtë qëndrim, nga auditimi është konstatuar se Ligji për birësimin përcakton se KSHB ka detyrimin për të kryer mbikëqyrje gjatë fazës pas birësimit për të verifikuar nëse birësimi i **përgjigjet interesit më të lartë të fëmijët** por, pa specifikuar afate për kryerjen e tyre. Në Rregulloren e brendshme të KSHB – së⁶⁷, Kreu IV “Ecuria e Periudhës Pas birësuese”, neni 9 “Ndjekja e Ecurisë Pas birësuese” parashikohet që monitorimi pas birësimit, duhet të kryhet deri në 2 vjet nga struktura përkatëse për çështjet sociale në KSHB sipas aneksit C dhe marrëveshjes së nënshkruar midis KSHB – së dhe prindërve birësues. Në aneksin C të kësaj rregulloreje janë miratuar formatet për 4 raporte monitorimi. Në marrëveshjen e nënshkruar midis KSHB – së dhe nënës birësuese me nr. 448/8, prot., datë 01.11.2023, neni 4, “Dispozita përfundimtare” specifikohet se

⁶⁷ Urdhër i Ministrisë së Drejtësisë nr. 4763/1, datë 08.06.2009 “Për miratimin e rregullores së brendshme të Komitetit Shqiptar të Birësimeve”, i ndryshuar.

marrëveshja do të zgjasë nga momenti kur fëmija ka shkuar në familjen birësuese dhe se në total do të ketë 2 raporte monitorimi pas birësues vitin e parë dhe 2 raporte në vitin e dytë. Në asnjë nga këto dokumente apo qoftë edhe në ligjin për birësimin nuk thuhet që KSHB duhet patjetër të presë 6 muaj për të kryer monitorimin e parë pas birësues. Nga auditimi ka rezultuar se nga momenti i birësimit me vendim gjykate 62 – 2003 – 3636 (573), datë 29.09.2023 (formë e prerë më datë 17.10.2023), KSHB ka kryer vizitën e parë pas birësuese në shtëpinë e nënës birësuese më datë 29.04.2024. KSHB i ka përcjellë rezultatet e monitorimit të kryer Shtëpisë së Foshnjës 0 – 5 Shkodër me shkresën nr. 262, prot., datë 10.05.2024. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion nga punonjësi për mbrojtjen e fëmijës së Bashkisë Fier më datë 10.05.2024 rreth orës 16 është marrë kontakti i parë me nënën dhe fëmijën dhe fëmija është marrë përfundimisht në mbrojtje më Vendimin nr.5264, datë 13.05.2024 duke e transferuar përsëri në institucionin rezidencial nga i cili kishte ardhur.

KSHB nuk ka patur asnjë komunikim me institucionet në nivel vendor për të shkëmbyer informacion mbi gjendjen e fëmijës së birësuar si dhe nuk ka referuar rastin Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës së Bashkisë Fier kur ka marrë dijeni për situatën.

Në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, neni 13, pika 9 “Detyrat e Sekretariatit Ekzekutiv” thuhet se:

Sekretariati ekzekutiv i Komitetit kryen këto detyra:

I kërkon sektorit të shërbimit social pranë njërive të qeverisjes vendore dhe agjencive ndërmjetësuese të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar.

Sa i takon këtij detyrimi që ka Sekretariati Ekzekutiv i KSHB – së, pra të kërkojë pranë sektorit të shërbimit social të bashkive informacion mbi gjendjen e fëmijës së birësuar, duhet theksuar që ky mund të përmbushet nëse nga KSHB dërgohet një njoftim zyrtar me anë të të cilit i bëhet me dije bashkisë përkatëse dhe njësisë përkatëse për shërbimet sociale në të që është kryer një birësim për të cilin do të nis periudha e monitorimit pas birësuese që do të zgjasë, në përputhje me ligjin për birësimet 2 vjet.

Pavarësisht kësaj kërkesë ligjore, KSHB nuk njofton në asnjë rast asnjë Bashki për rastet e birësimeve të kryera, si dhe po kështu nuk kërkon informacion nga ato.

Edhe në rastin në fjalë, i cili është paraqitur problematik që në fillim të periudhës pas birësuese, pavarësisht se KSHB kishte marrë dijeni që më herët për vështirësitë, në asnjë moment nuk ka kontaktuar me Bashkinë Fier për të kërkuar informacion, suport nga ana e tyre apo për të referuar rastin pranë tyre për një trajtim më specifik në territor (suport ndaj nënës edhe fëmijës). Bashkia Fier ka reaguar në rastin e të miturës në fjalë, pasi është vënë në dijeni nga stafi psiko – social dhe drejtuesja e Kopshtit nr. 3 i Bashkisë Fier më datë 10.05.2024 rreth orës 16:46, lidhur me një shqetësim që ato kishin për neglizhencë dhe dhunë psikologjike nga nëna birësuese. Punonjësja për mbrojtjen e fëmijës së Bashkisë Fier ka kontaktuar në celular me Drejtoreshën e Shtëpisë së Foshnjës Shkodër, nga ku ka mësuar për shqetësimet dhe problematikat që kanë ndodhur nga momenti i birësimit deri në referimin e rastit, sidomos sa i takon faktit se nëna ka shprehur se nuk do ta mbajë më fëmijën.

Sikurse mund të vërehet nga sa më sipër, KSHB nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për të marrë informacion mbi gjendjen e fëmijës së birësuar duke bashkëpunuar me njësinë vendore përkatëse, sikurse as nuk ka njoftuar lidhur me faktin se në territorin e kësaj bashkie ka një fëmijë të birësuar.

KSHB nuk ka komunikuar në asnjë moment me Ministrinë e Drejtësisë për rastin e këtij birësimi të dështuar.

Gjatë këtij auditimi, grupi i auditimit zhvilloi më datë 08.07.2024 një takim me z. I.S Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, znj. OTH Drejtoreshë e Drejtorisë së Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë dhe znj. M.G Përgjegjëse e Sektorit

të Mbështetjes dhe Asistencës në Procesin e Negocimit nga ku u konstatua se institucioni epror nuk ishte informuar nga Kryetarja e KSHB – së mbi problematikat e hasura pas birësimit të fëmijës⁶⁸, si dhe me zhvillimet e fundit dhe marrjen në mbrojtje të fëmijës, vendosjen në institucion, nisjen e procesit të braktisjes së fëmijës dhe kallëzimin penal që PMF i Bashkisë Fier ka bërë në drejtim të nënës birësuese.

Në përgjigjet e pyetësorit dërguar nga grupi i auditimit, KSHB – së referon se ka patur komunikim verbal e jo zyrtar mbi këtë çështje.

KSHB nuk ka dokumentuar mbledhjen e Këshillit Drejtues në të cilin është dhënë informacioni mbi dështimin e birësimit të së miturës

Nga auditimi është konstatuar se Këshilli Drejtues i KSHB – së është vënë në dijeni të çështjes, por diskutimet e tij mbi këtë rast nuk janë dokumentuar. Përgjigja zyrtare e institucionit për këtë çështje ka qenë si vijon: *“Po, është vënë në dijeni KD qysh në mbledhjen më të afërt të bordit pas ngjarjes me policinë e Fierit. Këshilli Drejtues u shpreh se në rastin e këtij birësimi e gjithë procedura është bërë në mënyrë korrekte, si edhe në rastet e tjera. Opinioni për znj. H ka qenë shumë i mirë nga të gjitha burimet e informacionit që u jemi drejtuar në kohën kur i kemi dhënë përshtatshmërinë. Po kështu edhe biseda e saj me Bordin ditën e marrjes së vendimit të përshtatshmërisë ishte shumë pozitive. Nuk janë dokumentuar bisedat në Bord, pasi nuk ka qenë pikë më vete e axhendës. Ishte thjesht dhënie informacioni për situatën në fjalë.”*

Nisur nga sa më sipër, evidentohet nga ana e KSHB – së dhe Këshillit Drejtues të këtij institucioni një mungesë përgjegjshmërie institucionale për të trajtuar dhe reflektuar mbi shkaqet e procesit që mund të kenë ndikuar në këtë rezultat: rasti i vetëm i dokumentuar i dështimit të një birësimi që nga krijimi i KSHB – së. Fakti që bisedimet e Këshillit Drejtues mbi rastin në fjalë nuk janë dokumentuar (pasi nuk kanë qenë në axhendën e mbledhjes së ditës), është një justifikim për të shmangur përgjegjësinë institucionale që i takon të gjitha hallkave të këtij procesi. Po kështu, fakti që nuk është gjykuar e arsyeshme përfshirja e këtij rasti në axhendën e mbledhjes është një tregues i indiferencës së treguar nga ky institucion ndaj dëmit të madh që i është shkaktuar një fëmijë të pafajshëm. Duke likuiduar lehtë këtë çështje, KSHB dhe Këshilli Drejtues kanë synuar të zhveshin veten e tyre nga përgjegjësia që u takon me ligj sa i takon vendimmarrjes në të gjithë procesin e birësimit të së miturës nga nëna birësuese, duke nisur nga momenti i dhënies së përshtatshmërisë e deri tek dhënia e pëlqimit për birësim.

Ndikimi i këtij procesi tek një fëmijë i mitur dhe pasojat e post braktisjes kanë një impakt të konsiderueshëm në jetën e fëmijëve, sidomos të fëmijëve që i nënshtrohen procesit të birësimit, pasi birësimi është një etapë e ndërlikuar për një fëmijë të mitur. Ndryshimi i fortë i shkëputjes nga institucioni pas atashimit me një prind potencial dhe adaptimi në një ambient të ri, krijon një çorientim emocional tek i mituri dhe prandaj ky proces quhet delikat dhe kërkon punën e shumë aktorëve që ky rrugëtim të jetë sa më i lehtë për fëmijën. Nga ana tjetër përballja e fëmijës me ambientin e ri ku ushtrohet presion dhe keqtrajtohet, e dëmton atë thellësisht duke i shkaktuar probleme emocionale deri në Stres Post Traumatik, i cili njihet si një çrregullim për t'u adresuar në raste të tilla. Rasti i të miturës e cila, në harkun kohor të më pak së një viti, është përballur me ndryshime të forta të ambientit ku jeton, qytetit, atashimi i krijuar me nënën e re për të përfunduar në refuzim nga ana e saj, është një kambanë alarmi për dëmin e madh të krijuar. Kjo situatë mund ta lërë fëmijën në një gjendje konfuzioni për një kohë të gjatë. Rikthimi i saj në institucion përsëri pas një kalvari disa mujor në procesin e ambientimit më jetën e re ndikon negativisht përsëri në gjendjen e saj emocionale dhe në procesin e zhvillimit të shëndetshëm. Sipas pyetësorit të zhvilluar me Shtëpinë e Foshnjës Shkodër, e mitura pas

⁶⁸ Kthim përgjigje me e-mailin zyrtar të datën 11.07.2024.

rikthimit në institucion ka shfaqur shenja të ndryshme të agresivitetit, dhe reagime që nuk i kishte më përpara. Pikërisht këto janë pasojat e një procesi që ka ndikuar negativisht në gjendjen emocionale dhe zhvillimin e të miturës dhe mbi të gjitha përballja me braktisjen që ajo ndjen se i është bërë nga nëna adoptuese. Fëmijët e braktisur shpesh ndihen të humbur dhe të pashpresë. Ata mund të përjetojnë një ndjenjë të thellë humbjeje dhe të pyesin veten për arsyet e braktisjes, mund të vetë fajësohen, ndihen përgjegjës, nuk ndihen të mirë mjaftueshëm për një familje, duke e dëmtuar gjendjen e brendshme emocionale. Kjo situatë i ndikon në vetëvlerësim dhe në mënyrën si e shohin veten e tyre. Fëmijët që përjetojnë braktisje mund të kenë vështirësi në formimin e lidhjeve të sigurta me të tjerët në të ardhmen. Kjo mund të çojë në çrregullime të atashimit dhe probleme me besimin në periudhën e rritjes; braktisja mund të rrisë rrezikun për çrregullime të shëndetit mendor, siç janë ankthi dhe depresioni. Një fëmijë që kalon mbi këto gjendje dhe situata kërkon një suport dhe ndjekje profesionale të menjëhershme. Rasti i të miturës të braktisur për së dyti dhe nga nëna birësuese duhet adresuar dhe ndjekur me psikolog në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që fëmija të dalë nga gjendja që i është shkaktuar dhe të ketë një vazhdimësi sa më normale të zhvillimit, duke qëndruar gjithmonë nën monitorim.

KSHB dhe Këshilli Drejtues i këtij institucioni kanë bërë vendimmarrje të gabuar si për dhënien e përshtatshmërisë po ashtu edhe për dhënien e fëmijës në birësim znj. LH.

Në një deklaratë të lenë nga nëna birësuese në momentin e dorëzimit të vajzës pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, ajo shprehet se “ ... për arsye të mos përshtatjes prej rreth një viti me vajzën time të adoptuar LH me keqardhje kam marrë vendimin që ta kthej mbrapsht. Edhe pse jam munduar shumë të përshtatemi nuk ja ka vlej fare. L ka vese, sjellje të lindura që nuk mund të rikuperohen dhe mua më ka sjellë vetëm shqetësime, mërzitje, jam ndier e turpëruar shpesh herë nga veprimet e saja në Kopshtet me mësueset dhe shokët, pasi ajo është e dhunshme, gënjeshtare, mashtron dhe merr gjëra fshehurazi nga çantat e shokëve. Nuk ka qenë ditë pa marrë dhe prishur fshehurazi edhe pse nuk i ka munguar gjë. Sigurisht e kam vizituar dhe bërë konsulta të vazhdueshme me psikologë/psikiatër. Premton se do silllet mirë dhe përsëri vazhdon Për këtë kam disa mesazhe e vidio.”

Për sa më sipër, duhet theksuar se shprehjet e përdorura nga nëna birësuese në këtë deklaratë përshkruajnë një fëmijë 5 vjeçar, si të gjithë fëmijët e tjerë të kësaj moshe.

Referuar po kësaj deklarate, vërehet se fjalët që ajo përdor fjalë të pa përshtatshme dhe tregojnë që ajo nuk e ka kuptuar në thelb çfarë do të thotë të birësosh një fëmijë dhe **se vendimi i gjykatës që sanksionon birësimin e një fëmije e bën atë, de jure dhe de facto fëmijë të prindit birësues, pasi vendimi i birësimit është i parevokueshëm.** Znj. LH është de jure nëna e fëmijës LH, dhe do të vijojë të jetë edhe nëse Gjykata kompetente e deklaroi përsëri të braktisur. Vetëm në rast se e mitura birësohet përsëri (në rast se do të deklarohet e braktisur për herë të dytë) atëherë mund të ndryshojë emri i nënës në certifikatën personale të së miturës. Shpjegimi i konceptit ligjor dhe implikimet emocionale, psikologjike dhe shoqërore të birësimit si proces i janë shpjeguar nënës birësuese gjatë seancave të këshillimit që ka zhvilluar në KSHB me specialistët e institucionit.

Fakti që, pavarësisht këtyre këshillimeve si dhe pas një procesi ligjor të gjatë dhe të ndërlikuar që përfundon me një vendim gjykate për birësimin e fëmijës, nëna birësuese ka menduar se mund të kthente mbrapsht fëmijën e birësuar tregon se ajo kurrë nuk ka qenë e aftë për të kuptuar në thelb që një fëmijë që birësohet para ligjit është i barabartë me një fëmijë biologjik. Nëse prindi nuk e do fëmijën, qoftë ai i birësuar apo biologjik, apo nuk mund ta mbajë atë për arsye të ndryshme, ndodh që mund ta braktisë ose të tregojë neglizhencë ndaj tij, por kurrësi nuk ekziston koncepti i kthimit mbrapsht të një fëmije.

Në këtë kontekst, lind natyrshëm pyetja se si është e mundur që një person, i deklaruar i përshtatshëm për të birësuar një fëmijë me vendim të Këshillit Drejtues të KSHB – së, me arsim

të lartë, me një profesion dhe biznes të konsoliduar nuk ka patur qartësinë mendore/intelektuale për të kuptuar që ligjërisht fëmija i birësuar nuk mund të kthehet mbrapsht. Nga dokumentet e konsultuara dhe të vendosura në dispozicion nga subjektet në asnjë moment ajo nuk reflekton mbi sjelljen e saj apo qasjen ndaj vajzës, por vendos theksin vazhdimisht tek fakti që vajza ka probleme të cilat nuk mund të ndreqen. Nisur nga e gjithë ngjarja, duket sikur nëna birësuese ka dashur të provojë mëmësinë nëpërmjet birësimit e kur ajo nuk ka rezultuar sipas pritshmërive të saj ka vendosur që fëmija nuk është i përshtatshëm për të. Po të njëjtën qasje ka treguar edhe Këshilli Drejtues në momentin që ka dhënë pëlqimin për birësim zonzjës LH. Më konkretisht në procesverbalin e mbledhjes përkatëse⁶⁹, kur aplikantes birësuese i komunikohet vendimi pozitiv për birësimin, Këshilli Drejtues shprehet si më poshtë: **“Urime!, Shpresojmë që fëmija të jetë i përshtatshëm për ju, birësimi ju aprovohet!”**. Theksojmë përsëri, që birësimi është një institut i rregulluar me ligj që ka për qëllim të gjejë familje apo prindër të përshtatshëm për fëmijët e braktisur, e jo e kundërta të gjejë fëmijë të përshtatshëm për familje apo prindër që nuk kanë fëmijë.⁷⁰ Nisur pikërisht nga ky koncept, si dhe nga detyrimi për të vepruar në interesin më të lartë të fëmijës, në këtë rast, nga i gjithë dokumentacioni i shqyrtuar nuk del qartë se cili ka qenë kriteri objektiv i përdorur nga KSHB për të propozuar si të përshtatshme për të qenë nëna e fëmijës, aplikanten birësuese në fjalë.

E mitura, EG (me atësi të panjohur), ka ardhur në jetë në Shkodër më datë 30.12.2018, si pasojë e abuzimit ndaj nënës biologjike MG, e cila është e diagnostikuar me skicofreni kronike rezistente. Duhet theksuar këtu se, e mitura e birësuar, sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Shtëpia e Foshnjës 0 – 5 vjeç Shkodër⁷¹, është një fëmijë që ka patur një ecuri zhvillimi normale si të gjithë fëmijët e tjerë në këtë institucion. E mitura është akomoduar në institucion që në momentin e lindjes (30.12.2018)⁷², pasi është braktisur në maternitet nga nëna biologjike, endacake dhe me probleme të shëndetit mendor, si dhe pa mbështetje nga familja. Sipas këtyre dokumenteve E ka qenë gjithmonë një fëmijë aktiv, kurioz dhe i dashur me shokët e institucionit dhe stafin në përgjithësi, si dhe me shokët e kopshtit që frekuentonte në Shkodër para birësimit.

Në vijim të akomodimit të fëmijës në institucion, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 164 (1073), datë 22.02.2021 (ka marrë formën e prerë më datë 07.12.2021) i ka hequr nënës biologjike (MG) përgjegjësinë prindërore. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me Vendimin nr. 746 (4713), datë 11.11.2022 ka shpallur braktisjen e fëmijës EG. Arsyeja kryesore që ka shtyrë institucionet të veprojë duke hequr si fillim përgjegjësinë prindërore nënës biologjike e duke shpallur më pas braktisjen kanë të bëjnë me problemet e shëndetit mendor të nënës si dhe situatën e saj ekonomike dhe mungesën e mbështetjes nga familja. Në vendimin e deklarimit të braktisjes bëhet edhe një përshkrim i shkurtër i marrëdhënies së nënës biologjike znj. MG me fëmijën e mitur, nga ku evidentohet se nëna është paraqitur në institucion për të takuar vajzën, pavarësisht faktit se nuk është në gjendje të kujdeset as për veten e saj. Gjatë takimeve ajo ka vështirësi në komunikim me të miturën, por

⁶⁹ Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Drejtues nr. 362/2, prot., datë 29.06.2023.

⁷⁰ Neni 2, “Qëllimi”, Ligji nr. 9695, datë 19.03.2007 “Për procedurat e birësimit dhe komitetin shqiptar të birësimit”, i ndryshuar: “Ky ligj ka për qëllim: a) mbrojtjen e fëmijës, nëpërmjet vendosjes së përhershme në një familje birësuese; b) marrjen e masave, që birësimet, vendase dhe ndër vendase, të bëhen në interesin më të lartë të fëmijës, i cili është mbizotëruar ndaj çdo interesi tjetër; (...)”.

⁷¹ Raportet për Vlerësimin e Nevojave dhe Ecurisë (RVNE) si dhe Planet e Kujdesit për të gjithë periudhën e qëndrimit të fëmijës në institucion para birësimit nga znj. Luiza Hyka (periudha 2018 -2023).

⁷² Procesverbal me nr., 1, prot., datë 16.01.2019, në të cilin shpjegohet se e mitura Evi Grymshi dorëzohet në Shtëpinë e Foshnjës Shkodër, pasi nëna biologjike e të miturës është diagnostikuar me çrregullime skizofrenie rezistente dhe është vendosur pranë shërbimit komunitar të shëndetit mendor Shkodër. Sistemi i fëmijës në institucion komisionohet edhe nga Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr. 1039, pro., datë 27.06.2019.

përpiqet dhe mundohet ti sjellë edhe ushqime, pavarësisht se janë të pa përshtatshme për moshën e saj. Nga ana e saj fëmija nuk shfaq dëshirë për ta takuar nënën biologjike, duke qarë apo duke u treguar e tërhequr.

Pavarësisht këtij interesimi të nënës biologjike për të miturën, nga vendimi i gjykatës vërehet se ajo nuk është e aftë të kujdeset për të, si dhe as për veten e vet, për shkak të problematikave të shëndetit mendor.

Pra, nga i gjithë dokumentacioni i vendosur në dispozicion lidhur me të miturën e birësuar në asnjë moment nuk flitet për probleme të mundshme në sjellje, psikologjie apo psikiatrike të vajzës që të mund të justifikojnë përshkrimin që nëna birësuese bën për të, duke theksuar këtu që behet fjalë për një fëmijë 5 vjeç e gjysmë (L/E, mbush 6 vjeç më datë 30.12.2024).

Sipas raportit të parë të ecurisë pas birësuese të kryer nga specialistët e komitetit më datë 29.02.2024, nëna birësuese ka treguar pakënaqësitë e saj lidhur me sjelljet e L, kryesisht sa i takon mbajtjes së rregullit në dhomën e saj, pasi sipas saj ajo nuk tregon kujdes për lodrat dhe nuk e ka sensin e rregullit. Sipas këtij raporti, nëna birësuese sillet sikur fëmija të kishte botëkuptimin e një të rrituri e jo të një fëmije, si dhe duket shumë kërkuese në drejtim të çdo veprimi që vajza bën. **Nëna pohon që nuk kanë munguar as dënimet kur i thotë: “do të kthej në institucion në Shkodër”**. Sipas këtij raporti nënës i është këshilluar mos të përdorë këtë metodë dënimi pasi nuk është e duhura. Zonja ka përdorur edhe një metodë tjetër dënimi (por që nuk ka funksionuar) duke e detyruar vajzën të qëndrojë 5 minuta me duar të mblodhura para murit. Zonja ankohet gjithashtu se fëmija nuk ambientohet në kopsht, nuk i le fëmijët e tjerë të qetë, i shtyn e bën zhurmë. Sipas saj, po e njëjta situatë ka ndodhur edhe në rastin e akademisë së kërcimit nga ku vajza është hequr.

Po sipas këtij raporti, kur e pyesin specialistet e KSHB – së për arsyet e kësaj sjelljeje, vajza shprehet se edhe pse i pëlqen shumë të kërcëjë ajo preferon të qëndrojë me mamin. Sipas nënës, fëmija ka problem menaxhimi në sjellje dhe ka bërë regres në këtë drejtim. Ajo shprehet se ka bërë konsulta me psikologë (3 takime në momentin e zhvillimit të këtij monitorimi) dhe **sipas psikologes vajza është ende në fazë përshtatjeje dhe nuk tregon problematika në zhvillim**. Sipas këtij raporti vajza dëshiron të qëndrojë pranë nënës dhe nuk mërzhitet në shoqërinë e saj apo në shtëpi. Në të kundërt nëna birësuese këmbëngul që Sara duhet të frekuentojë kopshtin, pasi ajo e konsideron shumë të rëndësishëm angazhimin në punën e saj. Në vijim të këtij raporti, specialistët e KSHB- së arrijnë në konkluzionin se marrëdhënia e ndërtuar midis L dhe L bazohet mbi një “klimë mbrojtëse, mbizotëruar dukshëm nga tipare mosbesimi të përkatësisë nga zonja L. Ajo shfaqet me pohime kontradiktore (herë vajza ka bërë progres dhe herë ka bërë regres). Në këtë fazë tranzicioni, zonjës i duhet shumë punë dhe durim për ta ndihmuar vogëlushen në rrugëtimin e saj të rritjes dhe ndërtimit të personalitetit”.

Sikurse mund të vërehet edhe nga përshkrimi i sjelljes së nënës birësuese në momentin e vizitës së parë pas birësuese, e cila ka ndodhur rreth 2 javë para se vajza të rikthehej përsëri në Shkodër, ajo rezulton të jetë kontradiktore në sjelljen dhe në pohimet e saj dhe aspak me takt kur kërcënon fëmijën që do ta kthej mbrapsht në institucion. Duhet theksuar që këtë qëndrim të saj in të shprehur para specialisteve të KSHB – së gjatë vizitës, nëna e ka realizuar faktikisht në momentin që ka deklaruar në DVP – Fier që fëmijën dua ta kthej mbrapsht. Në këtë drejtim duket qartë se KSHB nuk është treguar mjaftueshëm i kujdesshëm në analizimin e profilit të përshtatshmërisë së zonjës për të birësuar një fëmijë, si edhe të periudhës së atashimit prind - fëmijë.

Raporti i vlerësimit psiko - social të nënës birësuese znj. LH nuk jep indicie mbi problematikave të shfaqura prej saj menjëherë pas birësimit si dhe nuk është kryer sipas teknikave të intervistimit dhe testeve të standardizuara specifike

Lidhur me sa më sipër, gjatë këtij auditimit është vërejtur se edhe për këtë rast vlerësimi psiko – social është zhvilluar njësoj si për çdo proces birësimi në KSHB, sipas parashikimeve të rregullores së brendshme të institucionit dhe duke ndjekur anekset përkatëse me listën orientuese të pyetjeve të vendosura aty. Në studimin psikologjik të aplikantes birësuese⁷³ të kryer nga psikologia e KSHB – së jepet një panoramë shumë pozitive e nënës birësuese dhe asnjë indicie që të mund të shpjegojë sjelljen pas birësimit të nënës.

Sipas të dhënave dhe intervistimit me psikologun e KSHB - së, për të vlerësuar nënën birësuese gjatë procesit të marrjes së përshtatshmërisë për birësim, është realizuar vetëm një intervistë prej 3 orësh me aplikanten birësuese, kohë kjo e pamjaftueshme për të arritur në konkluzione për një përshtatshmëri të saj për të prindëruar. Nga intervistat dhe studimi i dosjes vihet re se gjatë vlerësimit psikologia ka zhvilluar intervistën vetëm duke u bazuar në anekset e rregullores dhe nuk ka përdorur teste të standardizuara për personalitetin dhe gjendjen psiko – emocionale të aplikantes birësuese.

Ky proces kaq delikat nuk ka arritur të bëjë të mundur vlerësimin e vërtetë të nënës që përpara dhënies së përshtatshmërisë si prind, siç përmendet me sipër asnjë test vlerësimi për çrregullime personaliteti apo probleme të tjera nuk është kryer përpara së ky person të merrte përshtatshmërinë për të birësuar. Duhet theksuar se në këtë fushë, profesionisti ka mundësi për të përdorur testet e ndryshme dhe intervistat klinike të strukturuar⁷⁴ për të evidentuar problematika të ndryshme të shëndetit mendor, sidomos në rastin e prindërve që duan të birësojnë.

Disa nga **Testet e Standardizuara** që përdoren nga psikologët konsistojnë në:

- Inventari shumëfazor i personalitetit të Minesotës (MMPI-2), i cili vlerëson një gamë të gjerë të kushteve psikologjike dhe attributeve të personalitetit. Ky test ndihmon në identifikimin e ndonjë psikopatologjie të rëndësishme që mund të dëmtojë aftësitë prindërore.

- Inventari Klinik Multiaksial Millon (MCMI-III), i cili vlerëson çrregullimet klinike dhe çrregullimet e personalitetit. Ky test ofron një profil të detajuar të shëndetit mendor të prindit të ardhshëm.

- Indeksi i stresit të prindërve (PSI), i cili mat nivelin e stresit brenda sistemit prind - fëmijë. Ky test identifikon fushat e mundshme të stresit që mund të ndikojnë në efektivitetin e prindërimit.

- Testi Tematik i Perceptimit (TAT), i cili vlerëson modelet e mendimit, qëndrimet dhe reagimet emocionale të një personi ndaj imazheve të paqarta. Ai ofron njohuri se si prindi i ardhshëm i percepton marrëdhëniet dhe dinamikën emocionale.

- Testi i njollosjes së bojës Rorschach, i cili vlerëson proceset themelore të menduarit dhe funksionimin emocional. Ky test ofron një kuptim më të thellë të perceptimeve nën ndërgjegjeshëm të prindërve të ardhshëm dhe shëndetit emocional.

- Inventari i personalitetit të NEO (NEO-PI-R), i cili bën vlerësimin e pesë tipareve të personalitetit (Neuroticizmi, Ekstraversioni, Hapja ndaj përvojës, Pajtueshmëria dhe

⁷³ Shkresa Studim psikologjik i aplikantes L H nr. 50/2, prot., datë 31.03.2022 hartuar nga B D, psikologe në KSHB.

⁷⁴ [9780521041669.pdf;jsessionid=F1127F9A42051ECBA9F95FB05B5F8D66 \(who.int\)](https://www.who.int/publications/m/item/9780521041669.pdf;jsessionid=F1127F9A42051ECBA9F95FB05B5F8D66)

[The Minnesota Multiphasic Personality Inventory \(MMPI\) Test \(verywellmind.com\)](https://www.verywellmind.com/the-minnesota-multiphasic-personality-inventory-mmmpi-test-2786187)

LORANGER, A. W., JANCA, A., & SARTORIUS, N. (1997). Assessment and Diagnosis of Personality Disorders: The ICD -10 International Personality Disorder Examination (IPDE). Cambridge University Press.

MILLON, T., GROSSMAN, S., MILLON, C., MEAGHER, S., & RAMNATH, R. (2015). Millon Clinical Multiaxial Inventory-IV (MCMI-IV). Pearson.

MURRAY, H. A. (1943). Thematic Apperception Test. Harvard University Press

ABIDIN, R. R. (2012). Parenting Stress Index (4th ed.). PAR.

Child Welfare Information Gateway. (2018). The Adoption Home Study Process. U.S. Department of Health and Human Services, Children's Bureau.

Ndërgjegjshmëria). Ky test ofron një profil gjithëpërfshirës të strukturës së personalitetit të prindit të ardhshëm.

Intervistat klinike të strukturuar:

Në këtë kategori përfshihen intervistat e thelluara të kryera nga psikologët për të mbledhur informacion të plotë rreth historisë dhe personalitetit të shëndetit mendor të prindit të ardhshëm. Këto intervista ofrojnë kontekst të detajuar dhe njohuri personale përtej testeve të standardizuara, si për shembull

- Ekzaminimi Ndërkombëtar i Çrregullimeve të Personalitetit (IPDE) është një intervistë e strukturuar klinike e krijuar për të vlerësuar dhe diagnostikuar çrregullimet e personalitetit. Ajo është zhvilluar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) për të ofruar një metodë të standardizuar për vlerësimin e çrregullimeve të personalitetit në kultura dhe mjedise të ndryshme. IPDE është një intervistë gjysmë e strukturuar që vlerëson çrregullimet e personalitetit bazuar në kriteret e DSM (Manuali Diagnostik dhe Statistikor i Çrregullimeve Mendore) dhe ICD (Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve), duke lejuar një vlerësim gjithëpërfshirës.

Birësimi i një fëmije është një proces gjithëpërfshirës që përfshin hapa të shumtë dhe vlerësime rigoroze për të siguruar që fëmija të vendoset në një mjedis të sigurt dhe mbështetës. Vlerësimi psikologjik i prindërve të ardhshëm birësues është një pjesë thelbësore e këtij procesi. Këto vlerësime ndihmojnë në identifikimin e çdo problemi të mundshëm që mund të ndikojë në mirëqenien e fëmijës ose për mënyrën si do reagojnë prindërit në momente ngarkese apo dhe stresi me fëmijën. Gjithashtu vlerësimi nuk konsiston vetëm në teste të standardizuara që përdoren në mbarë botën nga psikologët klinike, por edhe takimet e shpeshta biseda me psikologun në kohë e etapa të ndryshme, në këtë rast do të kishin bërë më të qartë panoramën e situatës dhe identifikimin e saktë për rastin konkret apo raste të tjera nëse do të ishin realizuar.

Asnjë e dhënë mbi intervistimin dhe bisedat me nënën nuk është dokumentuar përveç plotësisht të një interviste bazuar mbi Aneksat A dhe B të Rregullores së Brendshme të KSHB – së që aktualisht institucioni përdor si modele të standardizuara për të vlerësuar prindërit birësues.

Këto vlerësime, të kombinuara me vizitat në shtëpi, kontrollat e historikut të jetës dhe intervistat e njëpasnjëshme me psikolog klinik, ndihmojnë për të siguruar që fëmija të vendoset në një mjedis të sigurt. Kjo është arsyeja pse përdorimi i instrumenteve kaq specifike dhe testeve të standardizuara është një pikë kyçe në këtë proces. **Mungesa e këtyre hapave në procesin që zhvillohet në KSHB për të vlerësuar në detaj situatën kanë sjellë një vendimmarrje jo të duhur duke humbur qëllimin dhe misionin kryesor i këtij institucioni, garantimi i interesit më të lartë të fëmijës.**

KSHB nuk i ka dedikuar vëmendjen e duhur periudhës 2 javore të atashimit midis znj. LH me të miturën

Në vijim të marrjes së vendimit për dhënien e pëlqimit për birësimin e të miturës⁷⁵, është caktuar një periudhë dy javore për të verifikuar vendosjen e atashimit midis nënës birësuese dhe fëmijës. Sipas informacionit të vendosur në dispozicion nga Shtëpia e Foshnjës Shkodër, takimet janë asistuar nga punonjësjë sociale kur ato janë zhvilluar jashtë institucionit. Kur takimet janë realizuar në ambientet e institucionit ato janë asistuar edhe nga drejtuesja apo kujdestaret e shërbimit. Takimet konkretet kanë qenë si vijon: 1 takim pranë Liqenit Shkodër (Shirok); 1 takim pranë Bar Shqiponja (buzë Lumit Drin), 1 takim pranë Piazza Park (Qendër Qyteti). Ndërsa takimet e tjera janë realizuar në ambientet e institucionit. Shtëpia e Foshnjës së bashku me nënën birësuese kishin planifikuar që të shoqëronim të miturën edhe në plazh ose pishina por nuk u realizua. Nga data 29.06.2023, koha më e gjatë që zonja ka qëndruar në

⁷⁵ Vendim i Këshillit Drejtues nr. 35 (nr. 367, prot., date 29.06.2023), date 29.06.2023.

Shkodër ka qenë 1 javë konkretisht nga data 5 - 12 Korrik 2023. Për pjesën tjetër të takimeve nëna birësuese ka bërë vajtje ardhje nga Fieri. Frekuenca e takimeve ka qenë 1 takim në 15 dite më e afërta.

Në kushtet kur procesi gjyqësor u caktua në Shtator 2023, pritsshmëria nga ana e institucionit, referuar dhe rasteve të tjera, ishte që takimet të ishin më të shpeshta. **Sipas tyre, ka pasur edhe periudha të gjata pa realizuar takime, por vetëm video call. Kjo gjë i është referuar edhe vetë verbalisht nënës birësuese si edhe KSHB – së, për arsye se birësimi i një moshe më të rritur kërkon më shumë kohë në atashim e përshtatje dhe koha e kaluar së bashku duhet të jetë më e gjatë dhe më cilësore. Sipas Shtëpisë së Foshnjës, nëna ka referuar se e ka të pamundur të shkëputet më gjatë nga puna. Duhet patur parasysh se qëllimi i periudhës së provës/atashimit është që prindi birësues të takohet sa më shumë me fëmijën me qëllim konsolidimin e marrëdhënies. Kjo është një periudhë gjatë të cilës prioritetin kryesor e merr fëmija, sikundër edhe duhet të ndodh edhe pas finalizimit të birësimit.**

Lidhur me rezultatet e periudhës së atashimit midis nënës birësuese, KSHB në relacionin përkatës shprehet pozitivisht për përshtatshmërinë me fëmijën, duke u shprehur se aplikantja është e vendosur për të vijuar me finalizimin e këtij birësimi. Nga dokumentet e vendosura në dispozicion për këtë qëllim nga KSHB nuk ka gjurmë që të evidentojnë në çfarë mënyre KSHB ka kryer vlerësimin e atashimit prind fëmijë; sa herë specialistët e KSHB – së kanë qenë prezent në këto takime; nuk shpjegohet nëse nëna birësuese është intervistuar përsëri apo nëse është rivlerësuar profili i saj në vijim të kontakteve të vazhdueshme me fëmijën etj.

Nga ana tjetër, periudha e atashimit 2 javore e vendosur nga Këshilli Drejtues i KSHB – së nuk ka lejuar që të përfshiheshin në relacionin e periudhës së provës, shqetësimet e shprehura verbalisht nga Shtëpia e Foshnjës Shkodër lidhur me faktin se nëna nuk ishte e gatshme të sakrifikoje punën e saj për të mbajtur takime më të shpeshta me fëmijën në pritje të vendimit të gjykatës, duke konsideruar edhe që fëmija është në gjendje të kuptojë dhe të menaxhojë emocionet e saj më së miri. Një periudhë dy javore atashimi për një fëmijë i cili tashmë është i rritur mjaftueshëm për të kuptuar mjaftueshëm faktin se do të birësohet, nuk është e mjaftueshme për të konsoliduar marrëdhënien midis palëve.

Kërkesës për informacion gjatë këtij auditimi mbi prezencën e specialistëve të KSHB – së gjatë periudhës 2 javore të atashimit prind fëmijë; frekuencës së vizitave të tyre, si dhe frekuencën e vizitave të nënës birësuese me vajzën, KSHB i është përgjigjur pa vendosur në dispozicion dokumentacion mbështetës/verifikues për kryerjen në mënyrë korrekte të këtij procesi, si vijon: “Specialistet e KSHB kanë qenë prezent dhe kanë parë nga afër marrëdhënien nënë birësuese - vajze gjatë periudhës së provës/atashimit. Ka qenë një marrëdhënie më se normale, e filluar mire qysh nga fillimi. Nëna e emocionuar nga ky ndryshim në jetën e saj ka dërguar shumë foto ku na tregonte sa e lumtur ishte për këtë ngjarje që e kish pritur më padurim. Raporti i prodhuar nga psikologja e KSHB gjendet në dosjen e dorëzuar pranë KLSH.” Në relacionin prej 2 faqesh për periudhën e provës nuk ka asnjë referencë të numrit të vizitave, datave të kryerjes së tyre, prezencës së palëve të ndryshme të përfshira për të vëzhguar dhe vlerësuar marrëdhënien prind birësues fëmijë. **Ky relacion paraqitet edhe në gjykatë së bashku me dosjen e të gjithë procesit, për vendimmarrjen përfundimtare dhe dhënien e fëmijës për birësim.**

Për këtë arsye, vlerësimi mbi ecurinë e periudhës së provës sa i takon krijimit të lidhjes midis fëmijës dhe prindit birësues është thelbësor. Të gjitha palët e angazhuara në këtë fazë duhet të vëzhgojnë dhe të studiojnë sjelljen dhe marrëdhënien që prindi birësues krijon me fëmijën, për të parë nëse duhet vijuar më tej me përcjelljen e dosjes së birësimit në gjykatë. Vetëm në këtë moment ekziston mundësia që Këshilli Drejtues i KSHB – së të tërheqë vendimin për dhënien e fëmijës në birësim, nëse vërehet se atashimi nuk ka ndodhur siç duhet. Në rastin në fjalë, në kushtet kur palët nuk kanë dokumentuar siç duhet vizitat e nënës, qasjen e saj, përkushtimin, si dhe nuk kanë shprehur zyrtarisht rezervat dhe shqetësimet për sjelljen e çuditshme të nënës birësuese, çdo gjë ka vijuar sikur atashimi midis vajzës dhe nënës të kishte ndodhur. Në këtë

mënyrë janë kryer hapat e procesit të birësimit në mënyrë mekanike dhe rutinë, pa patur në vëmendjen maksimale interesin më të lartë të fëmijës.

Gjetje dhe Rekomandime

1. Gjetje nga auditimi: Struktura e Komitetit Shqiptar të Birësimeve nuk është e plotë, pasi sekretariati Ekzekutiv i Komitetit nuk është ngritur sikurse përcaktohet nga ligji për birësimet. Ky fakt sjell pasoja të rëndësishme, sepse detyrat specifike që ligji për birësimet dhe rregullorja e brendshme e KSHB – së ia ngarkon kësaj strukture kryen, sipas rastit, nga punonjësit e KSHB – së, pavarësisht se nuk i kanë në përshkrimet e tyre të punës.

2. Gjetje nga auditimi: Ndërmjet Komitetit Shqiptar të Birësimeve dhe institucioneve rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë është evidentuar mungesë bashkëpunimi e ndërsjellët në drejtim të përmbushjes efektive të detyrimeve që ligji vendos mbi palët e përfshira në procesin e raportimit dhe kontrollit, pasi IPSH – të publike dhe jo publike nuk kanë respektuar gjithmonë detyrimin ligjor për raportim 3 muaj pranë Komitetit. Nga ana e tij, Komiteti nuk ka unifikuar formatin e raportimit për të gjitha IPSH – të. Gjithashtu, kontrollet në IPSH – të publike dhe jo publike janë zhvilluar pa planifikim dhe pa metodologji të miratuar. Komiteti ka kontrolluar IPSH - të publike dhe vetëm 2 nga 18 IPSH jo publike.

3. Gjetje nga auditimi: Procesi i vlerësimit psiko – social të aplikantëve birësues nuk është gjithëpërfshirës. Ai kryet nëpërmjet intervistimit të aplikantëve nga punonjësi social dhe psikologu, sipas dy formateve të miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit. Në këto dy formate parashikohet intervistimi vetëm për aplikantët birësues çift e jo për ato beqar, gjë kjo e cila nuk është në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes. Gjithashtu, pyetjet eksploruese për të mbështetur arsyet e zgjedhjes së birësimit kanë të bëjnë vetëm me fenomenin e sterilitetit, duke përjashtuar arsye të tjera që mund të shtyjnë individët për të nisur këtë proces. Kjo situatë reflektohet akoma më qartë në rastin e birësimit të dështuar në vitin 2024, ku edhe është konstatuar se raporti i vlerësimit psiko - social të nënës birësuese nuk ka qenë i thelluar mjaftueshëm për të paraprirë dhe shmangur problematikat e shfaqura prej saj menjëherë pas birësimit, si dhe nuk është kryer sipas teknikave të intervistimit dhe testimeve të standardizuara specifike.

4. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Brendshme e KSHB – së nuk parashikon pjesëmarrjen aktive të psikologut dhe punonjësit social të tij në periudhën e provës kur kryhet atashimi prind – fëmijë. Në të nuk ka udhëzime dhe praktika të sakta për mënyrën se si duhet bërë periudha e përshtatshmërisë për grup moshë të tjera me të mëdha ndryshe nga grup moshë 0 – 5 vjeç, sidomos kur jemi në prezencë të fëmijëve me problematika të shëndetit mendor apo fizik, të cilët nuk mund të shprehin qartësisht pëlqimin e tyre për birësim. Psikologu dhe/ose punonjësi social në KSHB nuk është gjithmonë prezent gjatë kryerjes së periudhës së provës, kjo pasi KSHB nuk planifikohen një numër minimale vizitash që duhet të kryhen me prezencën e detyrueshme të këtyre figurave profesionale. Komunikimet me stafin psiko – social të IPSH – ve janë kryesisht informale. Gjithashtu nuk parashikohet që specialistët e KSHB – së të kryejnë intervista apo takime të tjera të programuara (shitesë) me aplikantët birësues, apo edhe me fëmijët pavarësisht moshës së tyre.

Për sa më sipër, këto mangësi kanë sjellë pasoja edhe në rastin e birësimit të dështuar, ku është konstatuar se KSHB nuk i ka dedikuar vëmendjen e duhur periudhës dy javore të atashimit. Relacioni mbi atashimin prind fëmijë është hartuar duke u bazuar në një vizitë të vetme të kryer nga KSHB gjatë periudhës së provës. Referuar këtij fakti, ç' ka është parashtruar përgjatë këtij raporti lidhur me kohëzgjatjen dhe mbikëqyrjen nga ana e institucioneve të periudhës së provës për vendosjen e atashimit prind – fëmijë merr akoma edhe më tepër kuptim, sepse kuptohet

qartë që një vizitë e vetme nuk mund të tregojë nivelin e atashimit dhe 2 javë takimesh “të mbikëqyrura” janë të pamjaftueshme për të kuptuar krijimin e lidhjes prind – fëmijë. Po kështu, vërehet se asnjë nga palët e përfshira në mbikëqyrjen e periudhës së atashimit nuk ka dokumentuar me shkrim shqetësimet shprehura verbalisht mbi sjelljen e nënës.

5. Gjetje nga auditimi: Mbledhjet e Këshilli Drejtues në KSHB nuk diskutojnë në detaj plotësimin e kriterëve të përshtatshmërisë për birësim dhe dhënies së pëlqimit për birësim. Diskutimet e kryera në këtë këshill nuk analizojnë në detaj plotësimin e kriterëve të përshtatshmërisë nga aplikantët birësues, por përgjithësisht komentohet ngjashmëria e fëmijës me prindërit birësues. Rezultojnë raste kur është dhënë përshtatshmëria për aplikantët birësues e në vijim po në të njëjtën mbledhje është marrë edhe vendimi për dhënie pëlqimi për birësim. Në disa raste të tjera, në një mbledhje jepet përshtatshmëria për aplikantët birësues e në mbledhjen në vijim (me diferencë një muaj midis mbledhjeve) është dhënë pëlqimi për birësim, pa gjurmë të tjera që fëmijët e birësuar t'i jenë propozuar aplikantëve të tjerë prezent në listat e KSHB – së.

Kjo situatë reflektohet më së miri në rastin konkret të trajtuar gjatë auditimit nga ku është konstatuar se KSHB ka bërë një vendimmarrje të gabuar si për dhënien e përshtatshmërisë po ashtu edhe për dhënien e fëmijës për birësim. Në mbledhjet e Këshillit Drejtues nuk dokumentohet në detaj se si KSHB dhe anëtarët e këshillit kanë verifikuar figurën e aplikantes birësuese për të arritur në përfundimin që ajo është e përshtatshme për të birësuar dhe e përshtatshme për fëmijën e propozuar. Gjithmonë qasja ka qenë në mbrojtje të interesit të aplikantit birësues.

6. Gjetje nga auditimi: Kuadri ligjor dhe rregullator aktualisht në fuqi parashikon se nga momenti kur fëmija ka shkuar në familjen birësuese familja do të monitorohet për dy vite; në total do të ketë 2 raporte monitorimi pas birësues vitin e parë dhe 2 raporte në vitin e dytë. Në asnjë nga këto dokumente apo qoftë edhe në ligjin për birësimin nuk thuhet që KSHB duhet patjetër të presë 6 muaj për të kryer monitorimin e parë pas birësues. KSHB nuk ka reaguar në kohë për të analizuar ecurinë pas birësuese e të miturës L.H/E.G me nënën birësuese L.H, birësuar në qytetin e Fierit. Gjatë auditimit është kontaktuar se problemet e nënës kanë filluar menjëherë pas birësimit, në datë 17.10.2023. KSHB ka marrë njoftim për vështirësitë që po haste nëna birësuese si fillim nëpërmjet shtëpisë së foshnjës Shkodër në fund të nëntorit, 28.11.2023, e në vijim duke komunikuar vetë nëpërmjet telefonit. Pavarësisht kësaj ky institucion nuk është marrë asnjë masë për të nisur një monitorim të situatës pas birësuese të vajzës në shtëpinë e nënës birësuese. KSHB, gjatë kësaj periudhe është mjaftuar vetëm me komunikimet telefonike, mesazhet dhe videot në whatsapp, me argumentin se institucioni nuk ka tagrin ligjor për të nisur monitorimin pas birësues pa u mbushur afati 6 mujor nga momenti i birësimit.

7. Gjetje nga auditimi: Në ligjin për birësimet thuhet se KSHB (Sekretariati ekzekutiv) i kërkon sektorit të shërbimit social pranë njësive të qeverisjes vendore dhe agjencive ndërmjetësuese të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar. Sa i takon këtij detyrimi, duhet theksuar që ky mund të përmbushet nëse nga KSHB dërgohet një njoftim zyrtar me anë të të cilit i bëhet me dije bashkisë përkatëse dhe njësisë përkatëse për shërbimet sociale në të që është kryer një birësim për të cilin do të nis periudha e monitorimit pas birësuese që do të zgjasë, në përputhje me ligjin për birësimet 2 vjet. Pavarësisht kësaj kërkese ligjore, KSHB nuk njofton në asnjë rast asnjë Bashki për rastet e birësimeve të kryera, si dhe po kështu nuk kërkon informacion nga ato. KSHB edhe në rastin e birësimit të dështuar, të ndodhur në qytetin e Fierit, nuk ka patur asnjë komunikim me institucionet në nivel vendor për të shkëmbyer

informacion mbi gjendjen e fëmijës së birësuar si dhe kur ka marrë dijëni për situatën nuk ka referuar rastin të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës së Bashkisë Fier.

8. Gjetje nga auditimi: KSHB nuk ka komunikuar zyrtarisht në asnjë moment me Ministrinë e Drejtësisë për rastin e birësimit të dështuar, por referuar pohimeve të kryetares së KSHB-së, rasti është prezantuar verbalisht në këshillin drejtues në dy mbledhje në të cilat nuk është dokumentuar diskutimi mbi këtë rast. Me tej sipas kryetares së KSHB-së, ministri është bërë me dije nëpërmjet anëtarit të MD në këshillin drejtues. Duhet theksuar se KSHB, sipas ligjit për birësimin⁷⁶ ka detyrimin të informojë ministrin mbi veprimtarinë e Komitetit, ndërsa Këshilli Drejtues dhe anëtarët e tij nuk kanë asnjë detyrim për të informuar/raportuar për veprimtarinë e komitetit⁷⁷.

9. Gjetje nga auditimi: Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve nuk ka nënshkruar marrëveshje me autoritetet qendrore dhe me agjencitë ndërmjetësuese të huaja. Më konkretisht, nuk kanë rezultuar marrëveshje të nënshkuara me autoritetet qendrore me të cilat KSHB ka bashkëpunuar më parë e me ato që bashkëpunon aktualisht, si për shembull në rastin e Autoritetit Qendror Francez, Grek, dhe atij të Maqedonisë së Veriut. Ndërsa, ka rezultuar se KSHB ka nënshkruar disa marrëveshje me agjenci ndërmjetësuese të huaja para hyrjes në fuqi të vendimit për përbërjen dhe funksionimin e Komisionit të Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja në vitin 2011, i cili në vijim u ngarkua me kryerjen e procesit të njohjes e miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja mbështetur në ligjin për licencat, autorizimet dhe lejet dhe ligjit për birësimin. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk rezultojnë të jenë nënshkruar më marrëveshje midis agjencive ndërmjetësuese të huaja dhe KSHB – së, pavarësisht detyrimit për ta bërë këtë.

10. Gjetje nga auditimi: Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja nuk është mbledhur në Ministrinë e Drejtësisë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi. Komisioni duhet të ishte mbledhur, me kërkesë të Kryetarit të tij, sa herë informohet nga Sekretari, për paraqitjen pranë MD – së të maksimumi 5 kërkesave të reja për licencim në fushën e birësimit, brenda 10 ditëve nga ardhja e kërkesës. Në përfundim të periudhës 5 vjeçare të vlefshmërisë së licencimit, agjencitë ndërmjetësuese të huaja e kanë paraqitur kërkesën e tyre për licencim mesatarisht mbas një viti nga përfundimi i saj, me përjashtim të agjencisë Ai.Bi e cila e ka paraqitur pas një muaji. Në vijim të licencimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja, të dhënat mbi to dhe licencat e lëshuara për të ushtruar funksionet e ndërmjetësimit në fushën e birësimeve, duhet të hidhen në një regjistër të posaçëm i cili duhet të mbahet dhe të administrohet në Ministrinë e Drejtësisë sipas formatit të miratuar. Në praktikë, nuk është respektuar formati i miratuar me urdhrin e ministrit; regjistri nuk është historik, e nuk pasqyron të gjitha licencimet nga momenti i nisjes së këtij procesi nga Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja; personi përgjegjës i përcaktuar për mbajtjen e regjistrit nuk kishte dijëni për të dhe nuk e ka administruar asnjëherë. Gjithashtu ka rezultuar se nuk janë bërë publikimet përkatëse në faqen e QKB - s, “Licenca të lëshuara jashtë QKB – së”.

11. Gjetje nga auditimi: KSHB ka vijuar të kryejë procedura birësimi me agjencitë ndërmjetësuese të huaja edhe pas përfundimit të vlefshmërisë së licencave të tyre, pavarësisht përcaktimeve ligjore, duke u lejuar atyre ushtrimin e veprimtarisë së birësimit në vendin tonë pa licencë dhe kryer birësimin ndërventas të 9 (nëntë) fëmijëve. Nga ana tjetër, KSHB nuk ka

⁷⁶ Neni 11, pika (dh)

⁷⁷ Neni 9, Detyrat e Këshillit Drejtues të Komitetit

ushtruar asnjëherë mbikëqyrje të veprimtarisë së këtyre agjencive në vendin tonë, sa i takon përbërjes, funksionimit dhe gjendjes së tyre financiare, sikurse kërkohet nga ligji për birësimet.

12. Gjetje nga auditimi: Ministria e Drejtësisë nuk ka mbikëqyrur veprimtarinë e KSHB – së në vite, por është mjaftuar vetëm me raportimet që KSHB duhet të bëjë në zbatim të ligjit për birësimet. Drejtoria e Çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, nëpërmjet Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në fushën civile, nuk ka kryer monitorime të veprimtarisë së KSHB – së, përveçse një hetimi administrativ të kryer në vitin 2019, i cili është iniciuar në bazë të një ankese administruar në MD. Procesi i birësimit, aktiviteti kyç i këtij institucioni, nuk është audituar asnjëherë nga kjo ministri.

Konkluzione:

1. Mangësitë e evidentuara në drejtim të ngritjes së strukturave, raportimit, monitorimit të veprimtarisë së IPSH – ve, vendimmarrjes për përshtatshmërinë dhe pëlqimin për birësim, monitorimit të periudhës së atashimit prind fëmijë dhe asaj pas birësuese, procesit të njohjes dhe miratimit të agjencive ndërmjetësuese të huaja si dhe vet KSHB – së, etj. kanë cenuar procesin e birësimit në tërësi, duke mos garantuar plotësisht respektimin e **interesit më të lartë të fëmijës.**

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Komitetin Shqiptar të Birësimeve, të marrë masa për të rishikuar strukturën organike të Komitetit sipas përcaktimeve të ligjit, duke e plotësuar atë me Sekretariatit Ekzekutiv, si dhe duke vlerësuar nevojat faktike të tij për staf shtesë.

Brenda 31.12.2024

2.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve të hartojë dhe miratojë formularin tip të raportimit për institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë, publike dhe jo publike, si dhe hartojë metodologjinë e planifikimit e raportimit të kontrolleve të ushtruara në to.

Brenda 31.12.2024

3.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve të rishikojë Rregulloren e Brendshme të institucionit dhe formatet e punës, në drejtim të dokumentimit të qartë dhe të saktë të ngjarjeve dhe proceseve përgjatë të gjitha fazave nëpër të cilat kalon procesi i birësimit.

Brenda 31.12.2024

3.2 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë dhe Komiteti Shqiptar i Birësimeve të marrin masa për të përmirësuar e standardizuar testet dhe teknikat e intervistimit që duhet të përdoren nga shërbimi psikosocial i KSHB-së gjatë gjithë fazave ku kalon procesi i birësimit.

Brenda 31.12.2024

4.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues në Komitetin Shqiptar të Birësimeve të dokumentojë qartë dhe saktë analizimin e respektimin e kritereve për dhënien e përshtatshmërisë aplikantëve birësues, si dhe atë të dhënies së pëlqimit për birësim, duke patur në vëmendje gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.2 Rekomandimi: Institucionet Rezidenciale të Përkujdesit për Fëmijë në rastin e fëmijëve të cilët janë në proces birësimi, të dokumentojnë në mënyrë të detajuar, çdo vizitë gjatë periudhës së atashimit si dhe gjatë periudhës në pritje të zhvillimit të procesit gjyqësor për birësimin,

duke patur si prioritet interesin më të lartë të fëmijës e duke dhënë informacion sa më të saktë për atashimin prind fëmijë.

Menjëherë dhe në vijimësi

5.1 Rekomandimi: Në drejtim të analizimit të profileve të aplikantëve birësues dhe të dhënies së pëlqimit për birësim, Këshilli Drejtues nëpërmjet anëtarëve të tij, të cilët janë përfaqësues të disa nga institucionet qendrore në vend, të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar në mënyrë të detajuar verifikimin e informacionit të sjellë nga aplikantët në dosjet e tyre, si dhe të përshtatshmërisë që ata kanë për të birësuar fëmijët në listat e KSHB – së.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve të rrisë frekuencën dhe numrin e monitorimeve pas birësuese në bazë të situatave dhe specifikave të rasteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

7.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve të komunikojë me të gjitha autoritetet në nivel vendor në lidhje me mbarëvajtjen e procesit të birësimit, si në fazën e verifikimit të informacionit për dhënien e përshtatshmërisë ashtu edhe në fazën e monitorimit pas birësues.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.1 Rekomandimi: Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve të njoftojë zyrtarisht ministrin e drejtësisë mbi rastin e birësimit të dështuar të ndodhur në datë 10.05.2024.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në funksion të realizimit të proceseve të birësimit, të marrë masa për hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të përbashkëta me autoritetet qendrore dhe agjencitë e huaja ndërmjetësuese, të licencuara.

Brenda 31.12.2024

10.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja, të marrë masa për të shqyrtuar në kohë kërkesat e agjencive ndërmjetësuese të huaja për njohje, miratim, licencim, si dhe t'i publikojë ato menjëherë pranë organeve përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

11.1 Rekomandimi: Komiteti Shqiptar i Birësimeve, me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, të planifikojë e të kryejë mbikëqyrjen e veprimtarisë së agjencive ndërmjetësuese të huaja në vendin tonë, sa i takon përbërjes, funksionimit dhe gjendjes së tyre financiare.

Brenda 31.12.2024

12.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të auditojë Komitetin Shqiptar të Birësimeve nga këndvështrimi i procesit të birësimit në tërësinë e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

12.2 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë të ngrejë një grup punë për të analizuar mangësitë dhe problematikat e evidentuara nga ky auditim, veçanërisht në drejtim të aktivitetit të agjencive ndërmjetësuese në vite duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse, si dhe të rastit të birësimit të dështuar.

Brenda 31.12.2024

6. TRAJTIMI I OBSERVACIONEVE

Në vijim të procesit auditues, subjektet nën auditimit kanë paraqitur komentet e tyre mbi gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e këtij auditimi si më poshtë:

KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

Me shkresën nr. 207/1, prot., datë 10.05.2024 protokolluar në KLSH me nr. 762/9, prot., datë 13.05.2024, Komiteti Shqiptar i Birësimeve ka dërguar observacione mbi projekt raportin e auditimit të dërguar në subjekt.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi “mungesën e kritereve të qarta dhe të plota në legjislacioni në fuqi në fushën e birësimeve sa i takon: kufirit maksimal të moshës së birësuesit/birësuesve; qëndrueshmërisë e sigurisë së lidhjes martesore në kohë për aplikantët birësues të martuar; kriterit ekonomik për aplikantët birësues apo edhe faktit se përshtatshmëria ekonomiko financiare e aplikantëve birësues gjykohet pa patur një kriter të saktë reference”, subjekti shprehet se do të shikohet mundësia në të ardhmen për të rishikuar kuadrin rregullator duke u bazuar edhe në praktika të tjera më të mira ndërkombëtare, krahas atyre cituar në material nga grupi i auditimit.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi “faktin se ligji për birësimet nuk parashikon mandat për anëtarët e Këshillit Drejtues. Nga auditimi ka rezultuar se anëtarët e Këshillit Drejtues kanë ndryshuar shumë pak në vite. Parashikimi i një mandati të caktuar ndihmon në shmangien e familjarizimit të anëtarëve të KD me njëri-tjetrin, si edhe me aplikantët në listë pritje, fakt i cili mund të ndikojë në objektivitetin e tyre në vendimmarrje”, subjekti shprehet se do të shikohet mundësia në të ardhmen për të rishikuar kuadrin rregullator.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi “faktin se në ligjin për birësimet parashikohet se, shtetasit shqiptarë rezident jashtë vendit dhe që duan të birësojnë mund t’i drejtohen direkt Komitetit për të kryer këtë proces, me kusht që vendimi gjyqësor shqiptar i birësimit të sjellë pasoja juridike në vendin e tyre të rezidencës. KSHB, në këtë drejtim, nuk ka zbatuar ligjin gjithmonë në mënyrë uniforme, duke detyruar shtetasit shqiptarë të aplikojnë përmes agjencive ndërmjetësuese të huaja ku, ata detyrohen të paguajnë tarifa shumë të larta krahasuar me tarifën që duhet të paguajnë në rast se aplikojnë direkt në Komitet”, subjekti shprehet se do të shikohet mundësia në të ardhmen për të rishikuar kuadrin rregullator.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi mos ngritjen e Sekretariatit Ekzekutiv ku citohet se “në këto kushte veprimtaria e Komitetit rezulton në disa aspekte e cunguar, pasi disa nga detyrat që i janë ngarkuar këtij Sekretariati nga ligji nuk kryhen, sikurse është në rastin e detyrës për t’u kërkuar sektorëve të shërbimit social pranë njërive të vetëqeverisjes vendore të dhëna për gjendjen e fëmijëve të birësuar, aspekt ky shumë i rëndësishëm për t’i dhënë kontekst dhe informacione shtesë procesit pasbirësues dhe ecurisë totale të tij”, subjekti shprehet se këto vitet e fundit, tre specialistë të Komitetit (Specialistë Punonjës Social dhe Specialistë Shkenca Sociale) monitorojnë me kujdes afatet dhe mbledhin të gjithë informacionin e detajuar për familjet dhe fëmijët, ndaj dhe nuk ka qenë e nevojshme marrja e këtij informacioni nga specialistë të Shërbimit Social apo Qeverisjes Vendore.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër, sikundër është trajtuar edhe gjerësisht në material, veprimtaria e subjektit në mungesë të Sekretariatit Ekzekutiv ka rezultuar e cunguar pikërisht sepse çështjet që ligji ja ngarkon kësaj strukture nuk arrihet të kryen të gjitha nga stafi aktual i KSHB – së sikundër kërkohet. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi mangësitë në planifikimin e aktivitetit kontrollues të IPSH - ve nga Komitetit si pasojë e mungesës së Sekretariatit Ekzekutiv, subjekti shprehet se pavarësisht mungesës së planifikimit, KSHB mban marrëdhënie të ngushta me institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Sa i takon pretendimit të më sipërm, duhet theksuar përsëri se është detyrë shumë e rëndësishme e KSHB – së monitorimi i institucioneve institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror për fëmijë publike dhe private me qëllim evidentimin e të gjithë atyre fëmijëve të të gjitha grupmoshave, për të cilët nuk ka interesim thelbësor nga prindi, që mund të kenë shansin për tu birësuar dhe për të gjetur ngrohtësi pranë një familjeje birësuese. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes - “Procesi i vlerësimit psiko – social të aplikantëve birësues nuk është gjithëpërfshirës. Ai kryet nëpërmjet intervistimit të aplikantëve nga punonjësi social dhe psikologu, sipas dy formateve të miratuara në rregulloren e brendshme të institucionit. Në këto dy formate parashikohet intervistimi vetëm për aplikantët birësues çift e jo për ato beqar, gjë kjo e cila nuk është në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes. Gjithashtu, pyetjet eksploruese për të mbështetur arsyet e zgjedhjes së birësimit kanë të bëjnë vetëm me fenomenin e sterilitetit, duke përjashtuar arsye të tjera që mund të shtyjnë individët për të nisur këtë proces.” – subjekti shprehet se edhe pse në dukje pyetjet e këtyre pyetësorëve (Anekset A dhe B) mund të jenë përshtatur më mirë për një çift aplikantësh, specialistët përkatës i përshtatin këto pyetje edhe për aplikantët beqar sepse për ta është e rëndësishme të njohin dhe të kaluarën e tyre (e cila ka qenë edhe çift për një periudhë të caktuar të jetës së tyre, pohuar kjo nga vetë ato).

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër duhet theksuar përsëri se intervistimi i aplikantëve birësues çift apo beqar duhet të saktësohet dhe shtjellohet në mënyrë me të qartë e të saktë. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes mbi faktin se mbledhjet e KD në KSHB nuk diskutojnë në detaj plotësimin e kriterëve të përshtatshmërisë për birësim, subjekti sqaron perri se si kryhen mbledhjet e KD dhe si arrihet në vendim marrje.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër, sqarojmë se gjetja i referohet faktit se është evidentuar në praktikë mangësi në detajimin e kriterëve të përshtatshmërisë për birësim, në të dy momentet vendimmarrëse të KD-së, kjo bazuar në procesverbalet e mbledhjeve. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes ku shprehem se “Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve nuk ka nënshkruar marrëveshje me Autoritetet Qendrore dhe me agjencitë ndërmjetësuese të huaja” subjekti pretendon se Kryetari i KSHB-së që prej vitit 2013 nuk nënshkruan më marrëveshje me agjencitë ndërmjetësuese sepse VKM nr. 399 e ka përcaktuar mënyrën se si veprohet për procesin e licencimit duke shmangur nënshkrimin e marrëveshjeve dhe nga ana tjetër duke qenë se Shqipëria ka nënshkruar Konventën e Hagës e cila është konventa “Për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për Birësimet Jashtë Vendlindit” është vendosur që shtetet e ndryshme që e kanë ratifikuar këtë Konventë nuk është e nevojshme të nënshkruajnë marrëveshje mes tyre. Pra, qenia palë në këtë Konventë e shmang detyrimin për nënshkrim të marrëveshjeve mes Autoriteteve Qendrore. Gjithashtu, VKM nr. 399 për licencimin e agjencive ndërmjetësuese nuk lejon me nënshkrim marrëveshjesh me këto të fundit. I njëjti diskutim bëhet edhe në rastin e vendimmarrjes për birësimet. Kryetari paraqet propozimin duke renditur arsyet e zgjedhjes së një çifti për një fëmijë të gatshëm për birësim, ardhur me vendimin e gjykatës së formës së prerë nga shtëpia e foshnjës.

Çdo anëtar i KD ka të drejtën të drejtojë pyetje me detaje pse dhe si është bërë kjo përzgjedhje. Dosja e çiftit dhe e fëmijës merret në shqyrtim nga secili anëtar i KD. Pra sigurohet një transparencë e plotë dhe pjesëmarrje aktive në procesin e vendimmarrjes për çdo anëtar të KD. Kujtojmë se në një mbledhje këshilli kalojnë jo më shumë se 5 (pesë) vendime përshtatshmërie dhe birësimi së bashku, dhe koha në dispozicion është më se e mjaftueshme për diskutime dhe informime të detajuara.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër, sqarojmë se me hyrjen në fuqi të VKM-së së sipërcituar, nuk është shuar detyrimi i cili buron nga ligji për birësimet ku thuhet se kryetari i KSHB-së duhet të nënshkruaj marrëveshje me agjencitë ndërmjetësuese të huaja. Ri sqarojmë se procesi i licencimit ka të bëjë me dhënien e mundësisë së këtyre agjencive për të vepruar brenda kontekstit ligjor shqiptar, ndërsa marrëveshja përcakton në detaje mënyrën e ndërveprimit midis autoritetit shqiptar dhe këtyre agjencive, brenda thelbit dhe fushës së zbatimit të ligjit të birësimeve. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

MINISTRIA E DREJTËSISË

Me shkresën nr. 2058/3, prot., datë 10.05.2024 protokolluar në KLSH me nr. 762/10, prot., datë 13.05.2024, MD ka dërguar observacione mbi projekt raportin e auditimit të dërguar në subjekt.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjeve tuaja ku shpreheni se komisioni i miratimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja nuk është mbledhur në Ministrisë e Drejtësisë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi ju bëjmë me dije se Komisioni është mbledhur sapo janë paraqitur kërkesat e Agjencive, administruar nga KSHB dhe protokolluar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Brenda 2 (dy) ditëve është miratuar Urdhri për ngritjen e Komisionit sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe menjëherë është mbledhur Komisioni me anëtarët përkatës (sipas dokumentacionit vënë në dispozicion në janar dhe tani bashkëlidhur). Në raport evidentohet si gjetje se Komisioni është mbledhur vetëm 2 (dy) herë, por nga raportet dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion theksojmë se Komisioni është mbledhur për të shqyrtuar dosjet dhe dokumentacionin në mënyrë të shpeshtë dhe çdo ditë të javës derisa janë mbyllur të gjitha procedurat. Vetëm në proces-verbal janë pasqyruar 4 (katër) mbledhje në të cilat ka pasur dhe vendimmarrje. Referuar si më poshtë: *historiku i mbledhjeve të Komisionit të Licencimit të Agjencive Ndërmjetësuese të Huaja janë zhvilluar 4 (katër) mbledhje. Mbledhja e parë u zhvillua më datë 31.12.2020, mbledhje e cila konsistoi në shqyrtimin e listës së agjencive të cilat kishin shprehur interes për marrjen e licencës dhe u bë njohja me dokumentacionin përkatës të tyre. Pasi u bë shqyrtimi i dosjeve, Komisioni vuri re se kishte mungesë në dokumentacion dhe agjencive iu la një afat 15 ditor për plotësimin e tyre. Mbledhja e dytë u zhvillua më datë 18.01.2021 për të shqyrtuar plotësimin e dokumentacionit përcjellë nga Agjencitë Ndërmjetësuese pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve. Me kërkesë të vetë agjencive u kërkua një shtyrje afati, për shkak se e kishin të pamundur plotësimin e dokumentacionit në dosjet e tyre, përkatësisht dokumentet me vulat apostile, për arsye të situatës botërore dhe masave kufizuese të Covid, ku pjesa më e madhe e zyrave shtetërore ishin të mbyllura ose punonin me orare të reduktuara.*

Në këto kushte, Komisioni rivendosi një afat tjetër (afat ky maksimal parashikuar nga legjislacioni në fuqi) për plotësimin e dokumentacionit me vulat apostile deri më date 28.01.2021. Në datën 28.01.2021, Komisioni u mbledh për të administruar dokumentet që Agjencitë Ndërmjetësuese të Huaja kishin depozituar pranë KSHB-së. Më pas Komisioni u tërhoq për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar dhe verifikuar përmbushjen e kriterëve të parashikuara në ligj, për të dhënë vendimin mbi miratimin e licencimit të agjencive.

Në raportin e auditimit gjithashtu evidentohet se Agjencisë B i është refuzuar rinovimi apo licencimi. Saktësojmë siç edhe e kemi pasqyruar në dokumentacion, që Agjencia B

nuk ishte subjekt për t'u trajtuar në Komision por fakti se kishte depozituar kërkesën u trajtua dhe u adresua më pas në procedurë përkatëse.

Në dosjen dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion në Janar 2024, kanë qenë të pasqyruara licencat e agjencive përkatëse të rinovuara, sipas formatit të mëparshëm që disponohej nga KSHB. Licencat origjinale janë marrë nga vetë Agjencitë dhe një fotokopje është mbajtur nga Komisioni. Sa i përket referimit tuaj faqe, 31 se nuk gjenden licencat dhe numrat e tyre, lutem i gjeni bashkëlidhur siç iu janë vënë në dispozicion edhe në Janar 2024. E vetmja licencë e cila nuk gjendet në dosje është e Agjencisë Nightlight pasi i është dhënë licenca origjinale dhe nuk është mbajtur kopje për në protokoll.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër sqarojmë se Komisioni duhet të ishte mbledhur që në momentin e paraqitjes së kërkesës së parë e cila ka ardhur nga agjencia AIBI në datën 28.06.2018. Në vijim kanë ardhur kërkesa nga agjencitë e tjera si më poshtë:

1. A W ka paraqitur kërkesën në datën 26.05.2020
2. SPAI ka paraqitur kërkesën në datën 02.06.2020
3. C S E ka paraqitur kërkesën në datën 21.02.2020
4. N ka paraqitur kërkesën në datën 01.06.2021
5. B ka paraqitur kërkesën në datën 20.06.2019.

Komisioni është mbledhur për herë të parë më datë 31.12.2020, pra nuk është respektuar afati 10 ditor që parashikon VKM nr. 399, pasi paraqitet një kërkesë për licencim. Po të ishte kryer procesi i mbledhjes dhe funksionimit të këtij Komisioni sipas përcaktimeve ligjore agjencitë ndërmjetësuese të huaja nuk do të kishin vijuar të mbanin marrëdhënie me institucionet shtetërore pa licencë. Çka do të thotë që 9 birësime ndërvendase të kryera ose nuk do të ishin kryer fare ose do të kishin vijuar në përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor të zbatueshëm në këtë fushë. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes ku grupi i auditimit shprehet se “Regjistri i posaçëm duhet të mbahet dhe administrohet në MD sipas formatit të miratuar me urdhrin e Ministrit”, në përgjigjen e tij subjekti shprehet se KSHB dhe MB do të marrin masat përkatëse për të pasqyruar edhe vendimet e mëparshme në të.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër sqarojmë se MD në mbajtjen e regjistrit të agjencive duhet të zbatohet VKM nr. 399, datë 01.06.2011, Kreu IV, pika 4 ku thuhet se; “Ministri i Drejtësisë, brenda dy javëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, cakton personin e autorizuar përgjegjës për të pasur akses në sistem dhe për të publikuar të dhënat e nevojshme për licencat sipas këtij vendimi, në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave.” Për atë kohë sa ministri i drejtësisë ka përcaktuar me urdher personin përgjegjës për këtë qëllim, është detyrë e këtij personi e jo e KSHB – së të merret me administrimin e këtij regjistri. Sqarojmë se në tërësi ka nevojë për një koordinim më të mirë të brendshëm në MD midis strukturave dhe personave përgjegjës për të siguruar rrjedhshmërinë e proceseve dhe mbarëvajtjen e punës. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes ku grupi i auditimit shprehet se regjistri i posaçëm është administruar nga Komisioni dhe është mbajtur në Ministrinë e Drejtësisë po nga Komisioni. Këtë informacion e kemi sqaruar dhe dokumentuar më parë. Regjistri nuk është historik por janë pasqyruar të gjitha vendimet për rinovimin e licencave të kryera nga Komisioni. KSHB dhe MD do të marrin masat përkatëse për të pasqyruar edhe vendimet e mëparshme në regjistrë. Gjithashtu ju bëjmë me dije se në lidhje me veprimtarinë e agjencisë ndërmjetësuese të huaja sipas ligjit të birësimeve, ato licencohen për një periudhë 5 vjeçare dhe me pas thjesht rinovojnë licencat e tyre, sipas procedurës në fuqi. Në këtë mënyrë në pritje të rinovimit të licencës nga MD, ku dokumentacioni nga agjencitë është depozituar për rinovim, ka trajtuar rastet e fëmijëve me probleme shëndetësore dhe shumë të rënda shëndetësore (si

fëmijë të lindur të gjymtuar, apo fëmijë me ishemi cerebrale etj.) duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijëve dhe duke mos cenuar akoma me shume problematikat shëndetësore të cilat lidhen me shëndetin direkt të fëmijëve apo më rëndë akoma me jetën e tyre.

Referuar QKB, ju bëjmë me dije se me anë të shkresës nr. 5103 prot. datë 14.10.2021 dhe shkresës nr. 1835 prot. datë 29.03.2021 janë dërguar shkresat me informacionin përkatës QKB për botimin në regjistrin e lejeve dhe licencave, duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi dhe në zbatim të nenit 3 ligjit 131/2015, dhe pas kërkesës së QKB për të vënë në dispozicion NUIS përkatës, të cilat ia kemi nisur me shkresë zyrtare, nuk jemi informuar më mbi kërkesën tonë, gjë që e kemi marrë të miratuar si kërkesë për aq kohë sa nuk është dërguar shkresë tjetër nga ana e tyre. Grupi i punës që do të ngrihet do të ndjekë dhe zbatojë me përpikmëri edhe këtë proces nëse ka mbetur i pa mbyllur.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Sikurse është sqaruar më gjerë në material por edhe në komentet më sipër, pasja e një licence brenda afateve të ligjshmërisë nga ana e agjencive është parakusht i pashmangshëm për të vepruar juridikisht në vendin tonë në marrëdhënie me institucionet e tjera. Parashikimi i procesit të licencimit në ligjin për birësimet është vendosur në mbrojtje dhe garanci të interesit më të lartë të fëmijës, pasi legjislatori ka menduar dhe gjykuar të përshtatshme që këto subjekte të nënshtrohen një filtri verifikues, nga i cili nuk mund të shmanget askush dhe që synon të shqyrtojë nëse qëllimet dhe veprimtaria e tyre përputhen me ato çka kërkon rendi ligjor në Shqipëri. Më konkretisht legjislatori ka parashikuar filtra për të mbrojtur interesin më të lartë të fëmijës për birësimet ndërvendase: filtri i parë është

licencimi; filtri i dytë nënshkrimi i marrëveshjes me KSHB – në, filtri i tretë monitorimi i aktivitetit pasbirësues dhe filtri i fundit është kontrolli i veprimtarisë duke përfshirë anën ekonomiko – financiare, pa përjashtuar këtu edhe ndëshkrimi në rast shkelje të legjislacionit. Asnjë nga këto filtra nuk duhet në asnjë moment të neglizhohet nga institucionet e ngarkuara, aq më tepër në situata emergjence, si ajo e Covid – 19, gjatë të cilave gjasat për shkeljen e të drejtave janë edhe më të larta se sa në kushte normaliteti.

Pra, për të shmangur situatën e krijuar, në atë kohë nuk duhet të ishte vijuar me birësimet në kushtet e mungesës së ligjshmërisë, por Komisioni i Licencimit duhet të ishte mbledhur për të shqyrtuar kërkesat për licencim. Gjithashtu, edhe KSHB më bashkëpunim dhe me MD, në momentin që konstatuan përfundimin e vlefshmërisë së licencave, në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës, duhet tu ishin drejtuar vetë agjencive për ti nxitur ato për të paraqitur kërkesat për licencim sa më shpejt në të kundërt marrëdhëniet me Shtetin Shqiptar duhet të ishin ndërprerë. Në këtë drejtim, ka patur pasivitet nga të gjitha hallkat e këtij procesi. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes ku shprehemi se Ministria e Drejtësisë të auditojë Komitetin Shqiptar të Birësimeve nga këndvështrimi i procesit të birësimeve në tërësinë e tij. Në lidhje me auditimin në këndvështrimi i procesit të birësimeve në tërësinë e tij që kërkon KLSH, në opinionin e auditimit të brendshëm MD, mendojmë se të dhënat e birësimeve janë shumë sensitive dhe kanë informacion të klasifikuar e si e tillë punonjësit tanë duhet të jenë të pajisur më certifikata të sigurimit të personelit nga DSIK.

Duke shpresuar në mirëkuptim dhe bashkëpunimin e audituesve të KLSH ju informojmë se: Komiteti Shqiptar i Birësimit është krijuar dhe e ushtron aktivitetin e tij si institucion buxhetor bazuar në Ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar me Ligjin nr.10358 datë 16.12.2010 dhe me Ligjin nr.69/2019 nr.69/2019. Misioni që ligji i jep Komitetit Shqiptar të Birësimit është garantimi i interesit më të lartë për fëmijët e braktisur që i janë nënshtruar procedurës së birësimit.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Në lidhje me opinionin e strukturës së auditimit të brendshëm të MD – së, ku thuhet se “të dhënat e birësimeve janë shumë sensitive dhe kanë informacion të klasifikuar e si të tillë punonjësit e AB – së duhet të jenë të pajisur me certifikata të sigurimit

të personelit nga DSIK”, sqarojmë se, as vet punonjësit dhe strukturat e KSHB – së (Kryetar dhe Këshill Drejtues) nuk janë të pajisur me certifikatë nga DSIK, për më tepër që dokumentacioni i birësimeve që administrohet në KSHB nuk ka qenë i klasifikuar sipas ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror”, i ndryshuar, tashmë i shfuqizuar dhe as nuk është aktualisht i klasifikuar sipas ligjit nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”. Gjithashtu, në praktikën e punës, është konstatuar se i gjithë stafi i KSHB – së, përfshirë edhe anëtarët e Këshillit Drejtues, kanë nënshkruar deklarata të brendshme konfidencialiteti për të mos shpërndarë informacionet që administrojnë gjatë procesit të birësimeve. Referuar nenit 36, pika 4 të ligji për birësimet, të gjithë punonjësit publikë dhe privatë që, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, vihen në dijeni për të dhënat e përpunuara dhe kanë informacion për birësim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të detyrës. Këto të dhëna nuk mund të përhapen apo bëhen të ditura, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Pra, edhe punonjësit e strukturës së auditimit të brendshëm të MD – së duhet të zbatojnë këtë dispozitë gjatë kryerjes së auditimit pranë KSHB – së, për më tepër që në këtë rast nuk ka problematikë të shpërndarjes së të dhënave personale për aq kohë sa raportet e auditimit të brendshëm janë për titullarin e MD – së e jo për përdorim të jashtëm. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE TË DREJTËSISË DHE MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË pranë Ministrisë së Drejtësisë ka paraqitur me e-mailin e datës 10.05.2024 observacionin si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: Referuar gjetjes ku shprehem se Ministria e Drejtësisë nuk ka mbikëqyrur veprimtarinë e KSHB –së në vite. Referuar gjetjeve të auditimit lidhur me rolin e Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, ju bëjmë me dije se në bazë të rregullimit ligjor aktual KSHB funksionon si organ kolegjal që është Institucion në varësi të Drejtorisë së çështjeve të Drejtësisë dhe Monitorimit të Institucioneve të Varësisë në Ministrinë e Drejtësisë, por që nuk raporton pranë kësaj strukture dhe që nuk rezulton të jetë e lidhur drejtpërdrejt me të për shkak të mungesës së parashikimit të detyrave ligjore monitoruese apo mbikëqyrëse të saj lidhur me veprimtarinë e KSHB. Për këtë arsye nuk e gjejmë me vend gjetjen se kjo Drejtori nuk ka kryer monitorime. Është e drejtë dhe e saktë të vlerësohet që Sektori i Monitorimit të Institucioneve të varësisë, nuk ka tagër ligjor apo nënligjor apo metodologji aktualisht, që ti mundësojë drejtpërdrejt të drejtën për të mbikëqyrur apo t’i përcaktojë detyrat për të monitoruar veprimtarinë e KSHB, e cila më së shumti funksionon si organ kolegjal.

Për sa më sipër, vlerësojmë që nuk është objektive gjetja që Ministria e Drejtësisë nuk ka monitoruar KSHB, për sa kohë që kjo Ministri në zbatim të kuadrit ligjor aktual ka ndjekur ato ankesa që i janë adresuar pranë saj nëpërmjet Sektorit të Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, ka administruar raportet dhe analizat e punës që i paraqiten Titullarit të Institucionit nga KSHB-së dhe ka bashkëpunuar nëpërmjet zyrtarëve përfaqësues të saj në përputhje me detyrat e tyre të përcaktuara. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se Kryetari i Komitetit Shqiptar të Birësimeve, referuar Nenit 11, pika dh) e ligjit Nr. 9695, date 19.03.2007 "Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit" i ndryshuar, raporton për veprimtarinë e sekretariatit ekzekutiv përpara këshillit drejtues dhe për veprimtarinë e Komitetit përpara Ministrisë së Drejtësisë dhe saktësojmë se as Ligji Nr. 9695, datë 19.3.2007, “Për Procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar dhe as aktet nënligjore, nuk përcaktojnë si detyrim dërgimin e raporteve apo analizave në Ministrinë e Drejtësisë, pranë Drejtorisë së Monitorimit të Institucioneve të Varësisë, që kjo e fundit t’i monitorojë, por në mënyrë eksplicite është përcaktuar se raporton përpara Ministrisë së Drejtësisë.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër sqarojmë, se pavarësisht faktit se Kryetari i KSHB – së, sipas ligjit për birësimet raporton “për veprimtarinë e sekretariatit ekzekutiv

përpara këshillit drejtues dhe për veprimtarinë e Komitetit përpara Ministrit të Drejtësisë”, kjo nuk do të thotë që ndaj këtij institucioni ushtrohet mbikëqyrje nga institucioni epror, qoftë kjo nëpërmjet monitorimit apo auditimit.

Gjithashtu, fakti që në zbatim të ligjit për birësimet, MD emëron një përfaqësues pranë Këshillit Drejtues të KSHB – së, nuk do të thotë që ky përfaqësues ushtron funksione mbikëqyrjeje ndaj institucionit. Kompetencat Këshillit Drejtues të KSHB – së dhe anëtarëve të tij janë të specifikuara qartësisht në ligjin për birësimet dhe nuk i referohen mbikëqyrjes së jashtme të institucionit. Në thelb, Këshilli Drejtues, së bashku me anëtarët e tij, kanë kompetenca vendimmarrjeje në lidhje me birësimet. E pikërisht, kjo hallkë e procesit, së bashku me të gjitha hallkat e tjera që shoqërojnë këtë vendimmarrjeje duhet të monitorohet/mbikëqyret nga organi epror, konkretisht Ministria e Drejtësisë nëpërmjet strukturave të saj, në mënyrën më të përshtatshme për institucionit (monitorim/auditim/vet raportim apo qoftë edhe me grup pune me urdhër ministri).

Nga ana tjetër vetë Drejtoria e Drejtoria e Monitorimit të Institucioneve të Varësisë realizon monitorimin e institucioneve, ndër të tjera, edhe nëpërmjet vlerësimeve të problematikave të parashtruara ose konstatuara kur ka paqartësi për zbatueshmërinë e legjislacionit të fushës së përgjegjësisë nga strukturat e varësisë. Ky funksion është i rëndësishëm pikërisht, nisur edhe nga fakti se gjatë këtij auditimit janë evidentuar qartë problematika që kanë të bëjnë me paqartësi për zbatueshmërinë e legjislacionit për birësimet nga stafi i KSHB – së, por edhe nga vet strukturat e brendshme të MD – së.

Nga ana jonë, edhe pse dakordësojmë me faktin se Sektori i Monitorimit të Institucioneve të varësisë, nuk ka metodologji aktualisht, që ti mundësojë mbikëqyrje/monitorim të veprimtarisë së KSHB, gjykojmë se MD si institucion duhet të zgjidh këtë ngërç. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Në vijim të procesit auditues, subjektet nën auditimit kanë paraqitur komentet e tyre mbi Aktkonstatimin nr. 3, datë 25.07.2024, protokolluar në KSHB me nr. 433, prot., datë 25.07.2024, me shkresat nr. 433/1, 2, 3 prot., datë 31.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 762/16, prot., datë 01.08.2024, si më poshtë:

1. Këshilli Drejtues i Komitetit Shqiptar të Birësimeve

Pretendimi i subjektit: Referuar konstatimit “*KSHB nuk ka dokumentuar mbledhjen e Këshillit Drejtues në të cilën është dhënë informacioni mbi dështimin e birësimit të së miturës.*”, sqarojmë se rasti është trajtuar nga anëtarët e Këshillit Drejtues në dy mbledhje, përkatësisht në mbledhjen e datës 28.03.2024 dhe në mbledhjen e datës 09.05.2024. Kryetarja ka informuar të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues me hollësi për rastin dhe ka përcjellë të gjithë shqetësimin e saj mbi specifikën e rastit, lidhur me destabilitetin emocional të nënës. Këshilli Drejtues bazuar në dokumentacionin dhe vlerësimet mbi të cilat ka dhënë përshtatshmërinë ka pasur besimin se situata do të normalizohej, duke konsideruar dhe vështirësitë e fillimit. Në mbledhjen tjetër të datës 30.05.2024, Këshilli Drejtues është vënë në dijeni nga Kryetarja e KSHB, se për fat të keq situata ishte përkeqësuar dhe rasti ishte denoncuar në polici. Duke parë interesin më të lartë të fëmijës, si dhe duke e konsideruar këtë si një rast të izoluar, të gjithë ne, kemi mbajtur qëndrimin se në çdo vendimmarrje duhet të prevalojë interesi më i lartë i fëmijës.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër, sqarojmë se më shpjegimin e dhënë, subjekti nuk hedh poshtë konstatimin cituar më sipër, pasi përsëri nuk është vendosur në dispozicion dokumentimi i referimit dhe diskutimit të rastit specifik në dy mbledhjet e cituara në observacion. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Referuar konstatimit “*KSHB dhe Këshilli Drejtues i këtij institucioni kanë bërë vendimmarrje të gabuar si për dhënien e përshtatshmërisë po ashtu edhe për dhënien e fëmijës në birësim znj. LH.*”, sqarojmë se në të dy vendimet e marra në mbledhjen e datës 28.04.2022, si dhe në mbledhjen e datës 29.06.2023, Këshilli Drejtues ka shqyrtuar me imtësi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Juristi i KSHB me të gjitha raportet e prodhuara nga sektori psiko - social si dhe ka biseduar hollësisht me zonjën HJ, e cila ka qenë prezent në të dyja mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe konfirmojmë se nuk është konstatuar asnjë problem psiko - social apo problematika të tjera personaliteti që mund të konstatoheshin gjatë 2 mbledhjeve.

Sqarojmë se parimi bazë mbi të cilin mbështetet vendimmarrja e KD, në çdo rast dhe këtë rast objekt konstatimi i KLSH-së, është ai i interesit më të lartë të fëmijës. Si dhe duhet të konsiderohet se ky është një rast unik dhe i izoluar. KD në çdo vendimmarrje, konsideron se moshë e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë si dhe të bindur se familja është njësi bazë e shoqërisë dhe mjedisi natyror për rritjen dhe mirëqenien e fëmijës, jemi investuar për t'i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës duke e bashkuar me një familje që plotëson të gjithë kriteret ligjore dhe kushtet psiko - sociale.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Për sa më sipër, sqarojmë se ky birësim ka rezultuar i dështuar (i pari i dokumentuar në vendin tonë), si dhe nga procesverbali i mbledhjes gjatë së cilës u vendos për dhënien e fëmijës në birësim znj. H, qartësisht është shkruar se po mbrohej interesi më i lartë i aplikantes birësuese e jo ai i fëmijës. Po kështu, edhe në zhvillimet e marrëdhënies midis nënës birësuese dhe fëmijës, pasi fëmija shkoi në shtëpinë e saj të re, kanë reflektuar gjithmonë paaftësinë e nënës birësuese për të prindëruar dhe për tu përshtatur me fëmijën. Në asnjë moment nuk flitet për mospërshtatjen e fëmijës me nënën. Sikundër është vendosur në dukje edhe në dokumentet e administruara gjatë auditimit, fëmija është joshur lehtë nga të mirat materiale (tablet, biçikletë etj.) që zonja ka ofruar në fillim për të fituar interesin e saj dhe ka pranuar nënën birësuese. Aftësia për të prindëruar e aplikantit

birësues është në thelb ajo që vlerësohet gjatë gjithë këtij procesi, pra aftësia për të qenë prind i një fëmijë, e jo aftësia e fëmijës për të qenë fëmija i duhur për prindin. Në këtë drejtim KSHB dhe KD kanë bërë vendimmarrje të gabuar. Për këto arsye observacioni nuk pranohet.

2. Kryetarja e Komitetit Shqiptar të Birësimeve

Pretendimi i subjektit: Tek historiku i përmbledhjes së ngjarjes

Vizita për kushtet e banimit është kryer me 28.02.2022 (jo ne 2023)

Tek lista e anëtarëve të KD sqarojmë se ND dhe AS nuk janë anëtarë të KD. Janë Sekretariat Teknik. Dranga ka qenë prezent në mbledhjen e KD kur është marrë vendimi i përshtatshmërisë dhe Skënderi ka marrë pjesë në mbledhjen e KD kur është marrë vendimi për birësim.

Zj Ketrin Zeno është përmendur dy herë tek lista e anëtarëve të KD

Sqarojmë se një pjesë e anëtarëve të KD të listuar si: ZP dhe I M nuk janë me anëtare të KD dhe janë larguar nga Shqipëria në misionë diplomatike. Nuk disponojmë asnjë kontakt të tyre. A Th gjithashtu nuk është me anëtare e KD prej tetorit 2022. Në këto kushte raporti i akt konstatimit ju dërgua anëtarëve të tjerë të KD që vazhdojnë të jenë anëtare aktive.

Qëndrimi i grupi të auditimit: Është reflektuar në material ndryshimi i datës së vizitës për kushtet e banimit. Citimi në aktkonstatim të ND dhe AS, dy anëtarët e KSHB pjesë e Sekretariatit teknik ka qenë lapsus, pasi emrat e tyre rezultojnë në të dy proceset. Grupi i auditimit e ka të qartë që personat e sipërcituar nuk kanë fuqi vendimmarrje në të dy hallkat e procesit. Për këto dy aspekte pretendimi i subjektit qëndron dhe pranohet.

Sa i takon ish anëtarëve të Këshillit Drejtues ATH, ZP dhe IM, sikurse specifikohet edhe në aktkonstatim, KSHB ka detyrimin të njoftojë qoftë edhe në mënyrë elektronike me qëllim që personat e cituar të bëhen me dije dhe të kenë mundësi që të paraqesin komentet e tyre mbi aktin e mbajtur. Për këtë aspekt pretendimi i subjektit nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “KSHB nuk ka reaguar në kohë për të analizuar ecurinë pas birësuese të së miturës me nënën birësuese”, subjekti sqaron sa më poshtë: Sipas ligjit dhe në zbatim të Rregullores së Brendshme KSHB ka detyrim ligjor të monitorojë ecurinë pas birësuese deri në dy vjet pas birësimit, duke prodhuar 4 raporte pas birësuese (1 në çdo 6 muaj). Fëmija EG është birësuar në nëntor 2023 dhe raporti i parë duhet të kryhej brenda muajit prill 2024. Sinjalet e para që morëm nga nëna birësuese ishin mjaft pozitive, por me pas konstatuam që nëna kishte një sjellje të çuditshme me vajzën dhe ankohej për të meta e çrregullime në sjelljen e saj që i kishin shkaktuar nënës ngarkesë të madhe psikologjike. Në praktikën e punës sonë ne jemi ndeshur edhe me raste të tjera të ngjashme, kur periudha e përshtatjes shoqërohet me vështirësi të ndryshme. Ekspertët psiko - sociale menduan që kemi të bëjmë me situatën tipike post partum të nënës. Këto oshilacione në sjelljen e nënës konfirmohen nga videot kontraktore që ajo ka dërguar në adresë të KSHB. U vlerësua nga ekspertët e KSHB dhe KD që bëhej fjalë për një situatë kalimtare që do menaxhohej e kapërcehej siç kish ndodhur edhe në disa raste të tjera. Për këtë arsye vizita pas birësuese u la të kryhet në kohën e planifikuar, pra në muajin prill 2024. Ndërkohë kontaktet me nënën ishin të shpeshta dhe konsistonin në këshillime e rekomandime nga ana jonë se si ta kapërcente ajo sa më mirë e më lehtë këtë situatë. Këtë fakt e ka pranuar/dëshmuar edhe vetë nëna birësuese në seancat gjyqësore të zhvilluara gjatë procesit gjyqësor për heqjen e kujdestarisë dhe kthimin e të miturës në institucion. Për shkak të privatësisë dhe konfidencialitetit që implikon procesi i birësimit, KSHB e ka patur të pamundur koordinimin dhe bashkëveprimin me aktorë të tjerë vendorë në këtë rast. Kjo ka qenë praktika shumëvjeçare në këtë institucion, për sa kohë që birësimi konsiderohet çështje private dhe ligji por edhe familjet birësuese kërkojnë të ruhet konfidencialiteti.

KSHB duke marrë shkas nga ky rast do të rishikojë Rregulloren e Brendshme, konkretisht frekuencën e raporteve pas birësuese duke mos caktuar kufij strikte por duke lënë si afat kohor dy vjet dhe frekuencën e vizitave të hapur në varësi të ecurisë pas birësuese dhe problematikës së shfaqur rast pas rasti.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me sa më sipër, duke nisur edhe nga fakti se nëna birësuese po e përjetonte periudhën pas birësuese më tepër se sa në raste të tjera, se në marrëveshjen e nënshkruar për periudhën pas birësuese KSHB kishte marrë angazhimin për ti ofruar suport nënës, si dhe nisur nga fakti se ka detyrimin ligjor për të monitoruar këtë periudhë, KSHB duhet të kishte vepruar më herët, duke monitoruar më herët ecurinë e marrëdhënies së nënës me fëmijët për të eksploruar mundësi për të shmangur dëmtimin emocional dhe psikologjik të fëmijës dhe të mos mjaftohej me telefonatat drejtuar nënës. Sa i takon bashkëpunimit me institucionet vendore dhe çështjes së konfidencialitetit të birësimit, duhet sqaruar se në ligjin për birësimet flitet për konfidencialitetin vetëm në paragrafin 4 të nenit 36 “Mbrojtja e të dhënave personale” ku thuhet se: *“Punonjësit publikë dhe privatë që, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, vihen në dijeni për të dhënat e përpunuara dhe kanë informacion për birësim, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të detyrës. Këto të dhëna nuk mund të përhapen apo bëhen të ditura, përveç rasteve të parashikuara me ligj.”* Gjithashtu po në këtë ligj në paragrafi 4 të nenit 2 “Qëllimi” thuhet se: *“Ky ligj ka për qëllim: ç) sigurimin e bashkëpunimit me autoritetet vendore, autoritetet qendrore të vendeve të tjera apo organizatave të miratuara prej tyre, për mbarëvajtjen e periudhës pas birësuese.”* Po kështu edhe në paragrafin 9 të nenit 13 “Detyrat e Sekretariatit Ekzekutiv” thuhet se: *“Sekretariati ekzekutiv i Komitetit kryen këto detyra: 9. I kërkon sektorit të shërbimit social pranë njërive të qeverisjes vendore dhe agjencive ndërmjetësuese të dhëna për gjendjen e fëmijës së birësuar.”* Nga leximi i kombinuar i këtyre dispozitave rrjedh qartë se në kuadër të qëllimit të ligjit për birësimet për të siguruar bashkëpunim, ndër të tjera, edhe me autoritetet vendore, si dhe faktit që KSHB duhet të ndërveprojë me NJVQV – të, problemi i konfidencialitetit nuk qëndron pasi, sikurse thotë ligji punonjësit publikë apo privatë që vihen në dijeni të informacioneve për birësimin duhet të ruajnë konfidencialitetin. Fakti që prindërit birësues preferojnë të ruajnë një farë konfidencialiteti është i kuptueshëm dhe duhet të jetë në mbrojtje të interesit më të lartë të fëmijës, por kjo nuk do të thotë që për këtë arsye autoritetet lokale që kanë mundësi të japin informacion dhe suport nuk duhet të njoftohen, për më tepër që personat që birësojnë fëmijë janë të detyruar që të ndërmarrin veprime specifike administrative për të bërë fëmijën pjesë të familjes së tyre (certifikata familjare). Në këtë drejtim birësimi i ka të kufizuara mundësitë për të ruajtur atë lloj konfidencialiteti që pretendohet nga KSHB. **Gjithashtu, kjo qasje “konfidenciale” thjesht ushqen edhe më tepër mentalitetin e turpit nga pamundësia për të patur fëmijë biologjik. Një institucion si KSHB duhet të luftojë këto koncepte dhe të bëhet promotor i pranimin të birësimit si një mënyrë tjetër për të krijuar familje. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.**

Pretendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “KSHB nuk ka patur asnjë komunikim me institucionet në nivel vendor për të shkëmbyer informacion mbi gjendjen e fëmijës së birësuar si dhe nuk ka referuar rastin tek Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë Fier kur ka marrë njoftim për situatën.”, komenti ynë për rastin në fjalë është:

Ndër vite KSHB ka respektuar privatësinë e procesit të birësimeve si një proces shumë sensitiv për të miturit dhe familjet birësuese. Privatësia e prindërve birësues dhe fëmijës ruhet me shumë kujdes dhe për këtë arsye informacioni për palët e treta është tejet i kufizuar. KSHB në asnjë rast nuk mund të mos respektojë detyrimin që ka ndaj familjeve birësuese dhe fëmijës.

Koordinimi dhe bashkëpunimi me aktoret vendore mund të bëhen të domosdoshme në të ardhmen edhe për shkak të dinamikave të reja që përjeton shoqëria shqiptare në tërësi, por bashkëpunimet do të aplikohen me shumë kujdes dhe vetëm në ato raste kur ndeshemi me problematika të llojit në shqyrtim.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, sipas shpjegimit dhënë më sipër.

Prendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “*KSHB nuk ka komunikuar në asnjë moment me Ministrinë e Drejtësisë për rastin e këtij birësimi të dështuar.*” Lidhur me këtë konstatim sqarohjmë se: Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoresha që përmenden në Akt Konstatim nuk janë njoftuar për rastin, pasi në kohe reale për çdo zhvillim është vënë në dijeni Ministri i Drejtësisë, Z. M nëpërmjet Shefes së Kabinetit nj E N (njëkohësisht edhe anëtare e KD).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër pretendimi nuk pranohet, pasi nuk është dokumentuar i gjithë procesi i njoftimit qoftë në Këshillin Drejtues e qoftë përfaqësueses së MD – së në Këshill.

Prendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “*KSHB nuk ka dokumentuar mbledhjen e KD në të cilën është dhënë informacioni mbi dështimin e birësimit të së miturës*”, Konstatimi juaj është i drejtë. Nuk është dokumentuar procesi i dhënies së informacionit në Bord por është po kaq e vërtetë se është diskutuar rasti në fjalë në disa mbledhje radhazi dhe është kërkuar mendim nga anëtarët e KD rreth mundësive tona për të ndihmuar procesin. Janë parë videot dhe janë kërkuar opinione. Në çdo rast është konsideruar si një rast i vështirë por jo i pakapërcyeshëm, për shkak të natyrës shumë kontradiktore të situatave të krijuara në atë familje. Kur rasti në fjale u bë mediatik, u diskutua përsëri në KD dhe ramë dakord të gjithë se duhet bërë kujdes me birësimet nga nënat e vetme, pasi janë situata komplekse dhe duan studim edhe më të thelluar, duke shtuar disa filtra. Mbledhjet e KD në të cilat është diskutuar ky problem janë: 1) Mbledhja e datës 28.03.2024 2) Mbledhja e datës 09.05.2024 dhe 3) Mbledhja e datës 30.05.2024.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron përsëri, nisur edhe nga konstatimet e gjithë këtij auditimi, se në vendimmarrjen për përshtatshmërinë për të birësuar dhe për dhënien e pëlqimit për birësim **duhet kushtuar rëndësi maksimale e kujdes i duhur për të gjithë kategoritë e aplikantëve birësues, qofshin ata të martuar apo beqar. Theksojmë përsëri se në rastin specifik, birësimi ka dështuar jo sepse nëna birësuese ka qenë beqare, por sepse ajo nuk ka qenë e papërshtatshme për të prindëruar.** Si rezultat i këtij rasti, KSHB duhet të ndryshojë qasje dhe të vlerësoj në mënyrë objektive çdo aplikant birësues, në të kundërt kjo situatë mund të ri përsëritet, ose më keq akoma fëmijët mund të vendosen në familje të pa përshtatshme për ta dhe askush mos ta marrë vesh. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

Prendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “*KSHB dhe KD kanë bërë vendimmarrje të gabuar si për dhënien e përshtatshmërisë po ashtu edhe për dhënien e fëmijës për birësim znj. LHj*”. Nuk kemi dakord me këtë konstatim pasi në të dy rastet janë zbatuar të gjitha hapat procedurale sipas Ligjit të Birësimeve. Dokumentacioni i dorëzuar nga zonja HJ, performanca e saj në seancat e këshillimit psiko social në grup dhe individual, statusi social i zonjës nuk lanë vend për dyshimin më të vogël se mund të kishim të bënim me një rast problematik. Pra, proceduralisht KSHB dhe KD kanë vepruar përputhje të plotë me Ligjin. Pranojmë se procesi post birësues mund të ishte menaxhuar më mirë, por ky rast do shërbejë për përmirësimin e teknikave të monitorimit pas birësues në vazhdimësi. Duhet theksuar se menjëherë pas birësimit mund të ndodhin situata të ndryshme në familjet birësuese si:

divorce, fatkeqësi në familje, humbje e nënës apo babait, etj, evente që patjetër lënë gjurmë tek fëmija i birësuar. KSHB nuk mund të ndërhyjë për të marrë masa për revokim birësimi në këto raste. Pra pas birësimit fëmija vazhdon jetën njëlloj si në familje biologjike duke përbërë gjithçka që fëmijët e tjerë përjetojnë dhe përballen gjatë jetës.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk qëndron dhe nuk pranohet, pasi në rastin në fjalë nëna birësuese nuk e donte më fëmijën dhe ka dashur që prej fillimit ta kthejë mbrapsht në institucion, pra këtu nuk jemi në rastin e një fëmije të integruar në gjirin e familjes dhe që rrjedha e jetës e përballë me situata të ndryshme.

Pretendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “*KSHB nuk i ka dedikuar vëmendjen e duhur periudhës dy javore të atashimit midis znj LH dhe të miturës.*”, psikologja e KSHB ka kryer të gjithë shërbimin e saj vlerësues të situatës së atashimit mes nënës birësuese dhe fëmijës, njëlloj si në të gjitha rastet e tjera. Vizita monitoruese/vlerësuese është kryer dy javë pasi nëna kish marrë miratimin e birësimit nga KD, në korrik 2023. Në atë fazë çdo gjë ka shkuar shumë mirë. Vajza ka qenë e lumtur dhe po kështu edhe nëna birësuese. Në këtë rast është ndjekur e njëjta procedurë si për të gjitha vlerësimet standarde të atashimit në çdo proces birësimi. Theksojmë se raporti i psikologes së Shtëpisë së Foshnjës që është prodhuar edhe më vonë, në shtator 2023 është gjithashtu pozitiv. Kjo dëshmon se nuk ka pasur probleme gjatë kohës që vajza ka qenë ende në Shtëpinë e Foshnjës dhe vizitohej periodikisht apo komunikonin të dyja çdo ditë me video call. Në përfundim sqarojmë se: Raporti i psikologes së KSHB datë 13.07.2023, raporti i psikologes së Shtëpisë së Foshnjës datë 14.09.2023 dhe raporti i ekspertës psikologe të gjykatës dorëzuar gjatë seancës së gjykimit janë të tre pozitive. Theksojmë se tre raportet janë kryer nga tre psikologe të certifikuar dhe të pavarur nga njëri tjetri. Të tre këto raporte shprehen pozitivisht për këtë marrëdhënie. Kjo tregon se problemet kanë lindur pas marrjes së vajzës në shtëpi nga nëna birësuese dhe nuk lidhen me vëmendjen e pamjaftueshme të KSHB gjatë vlerësimit të periudhës së atashimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa i takon pretendimit shprehur më sipër, sqarojmë se të gjitha hallkat e procesit janë krijuar për të shmangur ngjarjen, pra dështimin e birësimit, por edhe për të patur një orientim të qartë se si do të ecë jeta e fëmijës pas birësimit, pasi në thelb këto institucione janë përfshirë në këtë proces për të mbrojtur interesin e atij që është ende i vogël për ta mbrojtur vetë, pra fëmijën. Minimalisht, palët e përfshira në këtë proces kanë detyrimin ligjor dhe moral të analizojnë veprimet e tyre dhe të mbajnë përgjegjësi për dëmin që i është shkaktuar një fëmije që vet nuk mund të mbrohet. Për këto arsye pretendimi nuk pranohet.

3. Sektori Psiko – Social, Komiteti Shqiptar i Birësimeve

Pretendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimeve:

- “*KSHB nuk ka pasur asnjë komunikim me institucionet në nivel vendor për të shkëmbyer informacion mbi gjendjen e fëmijës së birësuar.*”

“*KSHB dhe KD kanë bërë vendimmarrje të gabuar si për dhënien e përshtatshmërisë po ashtu edhe për dhënien e fëmijës në birësim Zj LHj.*”

Subjekti shprehet se KSHB nuk ka detyrim të njoftojë NJMF Fier, por ato duhet të menaxhojnë rastin si çdo rast tjetër në territorin e bashkisë dhe sektori psiko-social nuk ka konstatuar asnjë arsye për të mos prodhuar një relacion pozitiv për KD për dhënien e përshtatshmërisë Znj Hj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për këto pretendime për referencë shpjegimet më sipër. Pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit “*KSHB nuk është treguar mjaftueshëm i kujdesshëm në analizimin e profilit të përshtatshmërisë së zonjës për të birësuar një fëmijë,*

si dhe të periudhës së atashimit prind-fëmijë”, subjekti sqaron se për të vlerësuar nënën birësuese gjatë procesit të marrjes së përshtatshmërisë për birësim, vlerësimi i aplikantes kryhet për kushtet aktuale në të cilat ndodhet aplikantja në momentin e vlerësimit. Për vlerësimin e aplikantit nuk realizohet vetëm intervista prej 3 orësh nga psikologu, por ka procese të caktuara që ndiqen, të cilat përfshijnë:

1. Realizimi i seancës së parë të këshillimit realizuar me specialist shkenca -sociale sipas urdhrorit të brendshëm nr. 13, datë 01.02.2024 ”Për fillimin e seancave të këshillimit”, e cila ka zgjatur 3 orë (dokumenti bashkangjitur).

2. Realizimi i seancës së dytë të këshillimit realizuar me psikolog, sipas urdhrorit të brendshëm nr. 13, datë 01.02.2024 ”Për fillimin e seancave të këshillimit”, e cila ka zgjatur 3 orë (dokumenti bashkangjitur).

3. Studim psikologjik (ANEKSI A) i aplikantes birësuese LH realizuar nga Psikologu (Studim nr. 50/2, datë 31.03.2022, i cili ka zgjatur 3 orë (dokumenti bashkangjitur).

4. Studim Social (ANEKSI B) i aplikantes birësuese LH realizuar nga Punonjësi social (Studim nr. 50/3, datë 31.03.2022, i cili ka zgjatur 3 orë (dokumenti bashkangjitur).

5. Formular i verifikimit të kushteve dhe komforteve familjare, realizuar nga Specialist Shkenca - sociale; nr. 50/4, datë 31.03.2024, i cili ka zgjatur 4 orë (dokumenti bashkangjitur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Referuar sqarimit të më sipër, seancat e këshillimit zhvillohen në grup, studimi psikologjik zgjat 3 orë sipas aneksit përkatës, studimi psiko – social zgjat po tre orë. Pavarësisht kësaj, fakti ka treguar së në rastin në fjalë kandidatja për të birësuar fëmijën ka rezultuar e papërshtatshme *ab initio*, pra nuk duhet të kishte marrë përshtatshmërinë, pasi nuk ka qenë e aftë për të prindëruar, sepse ajo nuk ka kuptuar asnjëherë që një fëmijë (i birësuar apo biologjik) nuk mund të kthehet mbrapsht, por duhet të rrijë me prindin. Për këto arsye pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Për sa i takon konstatimit që ka të bëjë me *mundësinë për të përdorur testet e ndryshme të dhe intervistat klinike të strukturuar për të evidentuar problematika të ndryshme të shëndetit mendor, sidomos në rastin e prindërve që duan të birësojnë*, subjekti sqaron se: - testet e standardizuara nuk mund të përdoren për sa kohë sa nuk janë pjesë e protokollit të KSHB-së por më e rëndësishmja është se testet nuk janë të validuara dhe të testuara në popullatën shqiptare, (sidomos kur flitet për fushën e birësimeve) pasi mund të prodhojnë efekt të kundërt. - përdorimi i testeve në KSHB duhet të jetë i integruar në protokollin e procedurave të birësimit. - në raportin e vlerësimit psikologjik të paraqitur nga znj. R. B, psikologe klinike e caktuar nga Gjykata, për kryerjen e raportit të vlerësimit psikologjik të aplikantes birësuese LH, janë përdorur testi QOL Inventory - Inventari i kualitetit të jetës dhe testi i standardizuar CORE - OM, i cili i referohet katër dimensioneve: mirëqenies dhe shëndetit psikologjik, problemet psikologjike, funksionimi social dhe rreziku ndaj vetes dhe të tjerëve. Edhe në këtë raport, edhe pse janë përdorur instrumente shtesë (teste) arrihet në të njëjtin konkluzion ku për aplikanten birësuese LH rezulton vlerësim pozitiv dhe pa problematika të caktuara. (Raport psikologjik datë 25.09.2023, nga psikologe R.B, bashkëlidhur).

- raport vlerësimi psikologjik i cili mban datën 21.06.2024 i hartuar nga psikologe EP, ku ndër të tjera është paraqitur vlerësim i përgjithshëm për znj. LH dhe rezulton se zonja në momentin e vlerësimit nuk paraqet problematika të caktuara të shëndetit mendor, të marrëdhënieve nder personale, të punësimit apo kushteve social - ekonomike, të gjendjes dhe stabilitetit psiko - emocional apo të funksionimit kognitiv dhe sjelljes joverbale (raport vlerësimi psikologjik datë 21.06.2024 nga psikologe E. P bashkëlidhur).

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me sa më sipër, të gjitha këto hallka procesesh dhe institucionesh të përfshira kanë detyrimin të sigurojnë që fëmija do të shkojë të jetojë në një familje që e do dhe e trajton siç meriton. Kush mund ti përgjigjet pyetjes përse nëna birësuese

që nga fillimi ka kërkuar të kthejë fëmijën në institucion? Çfarë ndodh pas raportit pas birësues kur konstaton që nëna nuk e do më fëmijën e që nuk është sipas pritshmërive të saj? Kush mund t’u përgjigjet këtyre pyetjeve? Pretendimi nuk pranohet.

Pretendimi i subjektit: Sa i takon konstatimit “KSHB-ja, nuk i ka dedikuar vëmendjen e duhur periudhës 2-javore të atashimit midis znj. LH me të miturën.”, sqarojmë se periudha e provës në vetvete synon vlerësimin e atashimit prind - fëmijë për periudhën kohore dy javore. Për monitorimin e ecurisë së periudhës së provës për LH dhe të miturën EG është realizuar vizitë në Shtëpinë e Foshnjës, Shkodër më datë 11.07.2023 (sipas autorizimit nr. 400, prot, datë 10.07.2023 të KSHB, i cili gjendet bashkëlidhur). Bazuar në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e Birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, i ndryshuar, neni 25 “Periudha e provës”, pika 2, “në përfundim të Periudhës së provës, sekretariati ekzekutiv përgatit raportin për përshtatshmërinë e aplikantëve birësues me fëmijën dhe dokumentacionin e përgatitur ia dërgon gjykatës”, psikologu i KSHB-së ka përgatitur relacionin përkatës nr. 414 prot, datë 13.07.2023 (i cili gjendet bashkëngjitur). Ky vlerësim është kryer për kushtet aktuale në kohën e realizimit të tij, për aplikanten birësuese dhe të miturën që birësohej. Për këtë rast, nga psikologu është bërë vlerësimi i periudhës së provës për periudhën 2 - javore, duke realizuar vizitë në Shtëpinë e Foshnjës, Shkodër ku është vëzhguar nga afër marrëdhënia prind - fëmijë. Për ecurinë e atashimit prind - fëmijë është prodhuar relacioni përkatës, i cili ka rezultuar pozitiv.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Nga sa më sipër relacioni mbi atashimin prind fëmijë është hartuar duke u bazuar në një vizitë të vetme të kryer nga KSHB gjatë periudhës së provës. Referuar këtij fakti, çka kemi parashtruar përgjatë këtij raporti lidhur me kohëzgjatjen dhe mbikëqyrjen nga ana e institucioneve të periudhës së provës për vendosjen e atashimit prind – fëmijë merr akoma edhe më tepër kuptim, sepse kuptohet qartë që një vizitë e vetme nuk mund të tregojë nivelin e atashimin dhe 2 javë takimesh “të mbikëqyrura” janë të pamjaftueshme për të kuptuar krijimin e lidhjes prind – fëmijë. Për këtë arsye pretendimi nuk pranohet.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

8. ANEKSET

Tabelat e Birësimit nr.1

Kërkesa për birësim të regjistruar			
Viti 2019	Kërkesa vendase me pëlqim	5	
	Kërkesa vendase për birësim nga institucioni	15	
	Kërkesa ndërvendase	6	
	Totali	26	
	Birësime të Realizuara		
	Fëmijë të birësuar me pëlqim	5	
	Fëmijë të braktisur të birësuar nga institucioni	16	
	Fëmijë të braktisur të birësuar jashtë vendit	5	
Totali i birësimeve	26		
Kërkesa për birësim të regjistruar			
Viti 2020	Kërkesa vendase me pëlqim	5	
	Kërkesa vendase për birësim nga institucioni	25	
	Kërkesa ndërvendase	10	
	Totali	40	
	Birësime të Realizuara		
	Fëmijë të birësuar me pëlqim	7	
	Fëmijë të braktisur të birësuar nga institucioni	11	
	Fëmijë të braktisur të birësuar jashtë vendit	8	
Totali i birësimeve	26		
Kërkesa për birësim të regjistruar			
Viti 2021	Kërkesa vendase me pëlqim	3	
	Kërkesa vendase për birësim nga institucioni	28	
	Kërkesa ndërvendase	9	
	Totali	40	
	Birësime të Realizuara		
	Fëmijë të birësuar me pëlqim	3	
	Fëmijë të braktisur të birësuar nga institucioni	8	
	Fëmijë të braktisur të birësuar jashtë vendit	8	
Totali i birësimeve	19		
Kërkesa për birësim të regjistruar			
Viti 2022	Kërkesa vendase me pëlqim	5	
	Kërkesa vendase për birësim nga institucioni	27	
	Kërkesa ndërvendase	14	
	Totali	46	
	Birësime të Realizuara		
	Fëmijë të birësuar me pëlqim	5	
	Fëmijë të braktisur të birësuar nga institucioni	20	
	Fëmijë të braktisur të birësuar jashtë vendit	10	
Totali i birësimeve	35		
Kërkesa për birësim të regjistruar			
Viti 2023	Kërkesa vendase me pëlqim	1	
	Kërkesa vendase për birësim nga institucioni	16	
	Kërkesa ndërvendase	19	
	Totali	36	
	Birësime të Realizuara		
	Fëmijë të birësuar me pëlqim	3	
	Fëmijë të braktisur të birësuar nga institucioni	13	
	Fëmijë të braktisur të birësuar jashtë vendit	6	
Totali i birësimeve	22		

Burimi: KSHB/përpunoi Grupi i Auditimit

Tabelat nr. 2

Prindërit Birësues		
Moshë mesatare	Viti 2019	
	Nëna	Babai
	42,0	45,6
	Viti 2020	
	Nëna	Babai
	41,7	44
	Viti 2021	
	Nëna	Babai
	42,1	44,9
	Viti 2022	
	Nëna	Babai
	45,1	47,4
	Viti 2023	
	Nëna	Babai
	44,2	47,1

Burimi: KSHB/përpunoi Grupi i Auditimit

Tabelat nr. 3 për Treguesit E Përkujdesit Social

Treguesit ⁷⁸	Viti				
	2019 Vlera/muaj	2020 Vlera/muaj	2021 Vlera/muaj	2022 Vlera/muaj	2023 Vlera/muaj
Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fëmija shpallet “i braktisur” deri në momentin kur fillojnë procedurat e birësimit.	6,08 Muaj	1,97 Muaj	0,87 Muaj	1,44 Muaj	1,47 Muaj
Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fillojnë procedurat e birësimit deri në birësimin e fëmijës.	2,08 Muaj	1,62 Muaj	2,52 Muaj	1,71 Muaj	1,88 Muaj
Kohëzgjatja mesatare që nga momenti kur fëmija shpallet “i braktisur” deri në momentin kur birësohet.	7,99 Muaj	3,62 Muaj	3,52 Muaj	3,89 Muaj	3,35 muaj

Burimi: KSHB/përpunoi Grupi i Auditimit

Tabelat nr.4 për Statistikat Përmbledhëse

Viti	Kërkesa për birësim me pëlqim	Kërkesa për birësim vendas	Kërkesa për birësim ndërvendas	Birësime të realizuara me pëlqim	Birësime të realizuara nga Institucioni	Birësime të realizuara nga Agjencitë Ndërmjetësuese	Kërkesa në total	Birësime në total
2019	5	15	6	5	16	5	26	26
2020	5	25	10	7	11	8	40	26
2021	3	28	9	3	8	8	40	19
2022	5	14	27	4	20	11	46	35
2023	1	19	16	1	13	8	36	22

Burimi: KSHB/përpunoi Grupi i Auditimit

Tabelat nr.5

Viti	Dosje çiftesh të regjistruara	Dosje fëmijësh të regjistruara	Birësime të realizuara
2019	26	29	26
2020	40	23	26
2021	40	26	19
2022	44	32	35
2023	15	23	22

Burimi: KSHB/përpunoi Grupi i Auditimit

⁷⁸ Për llogaritjen e treguesit 1 dhe 3, në rastin e birësimeve me pëlqim, si datë e deklarimit të braktisjes, është llogaritur data kur ka marrë formë të prerë vendimi gjyqësor për dhënien e pëlqimit për birësim të të miturit nga familja biologjike.

Tabelat nr.6 e vendimeve për Agjencitë

Agjencia Ndërmjetësuese	Nr. Birësimeve	Datë e vendimit (dhënie pëlqimi për birësim)
AIDI	1	22.12.2018
A	5	09.11.2028; 20.12.2018; 25.10.2019; 06.11.2019; 24.12.2020
<u>CSE</u>	1	20.09.2020
<u>SPAI</u>	1	12.03.2019
<u>NA</u>	1	25.06.2020
<u>TOTAL</u>	9	